Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 TETOR 2026

SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 26. OKTOBRA 2026. GODINE

TETOR - OKTOBAR
2026

Rendi i ditës

1. Vrasja e fundit në Vitomiricë të Pejës, rastet tjera të vrasjes së grave, dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve, përgjegjësia institucionale, parandalimi i dhunës në baza gjinore dhe mbrojtja e jetës së grave.

Dnevni red

1. Poslednje ubistvo u Vitomirici kod Pećи, ostali slučajevi ubistava žena; nasilje u porodici nad ženama i decom; institucionalna odgovornost, sprečavanje rodno zasnovanog nasilja i zaštita života žena.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Të dashur qytetarë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e thirrur me kërkesë të 41 deputetëve të Kuvendit, me këtë rend dite:

1. Vrasja e fundit në Vitomiricë të Pejës, raste të tjera të vrasjes së grave, dhuna në familje, dhuna ndaj grave, dhuna ndaj fëmijëve, përgjegjësia institucionale, parandalimi i dhunës në baza gjinore dhe mbrojtja e jetës së grave

Të nderuar deputetë,
Në bazë të nenit 69, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 68, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit, 41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për të debatuar lidhur me vrasjen në Vitomiricë të Pejës, raste të tjera të vrasjes së grave dhe përgjegjësinë institucionale për parandalimin e tyre.

Para se t'ia kaloj fjalën shefes së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zonjës Arbërie Nagavci, më lejoni që t'ju thërras të mbajmë një minutë heshtje në nderim të gruas që u vra dje, si dhe të gjitha grave që kanë humbur jetën nga partnerët e tyre, por edhe nga anëtarë të tjerë të familjes. Kjo është një shprehje e respektit dhe solidaritetit tonë me viktimat dhe familjet e tyre, por edhe një kujtesë e dhimbshme se kemi përgjegjësi të përbashkët për t'u angazhuar në parandalimin e këtyre tragjedive. Ju ftoj, pra që të mbajmë një minutë heshtje.

Faleminderit! U prehtë në paqe!

E nderuar zonja Nagavci, urdhëroni. Ju lutem!

ARBËRIE NAGAVCI: E nderuar kryetare e Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë,
Më lejoni që fillimisht të shpreh ngushëllimet më të sinqerta për vrasjen e Arlinda Zekajt të gjithë familjarëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të saj.

Vrasja e Arlinda Zekajt në Vitomiricë të Pejës, e cila vetëm pak ditë para se të vritej kishte paralajmëruar institucionet për rrezikun ndaj jetës së saj, është një tragjedi që kërkon drejtësi, përgjegjësi dhe llogaridhënie institucionale. Sot nuk jemi këtu vetëm për të dënuar një krim të

rëndë. Jemi këtu për të kërkuar përgjigje nga institucionet që kanë pasur përgjegjësi ligjore të veprojnë për mbrojtjen e saj, sepse kjo grua kishte kërkuar ndihmë, kishte paralajmëruar rrezikun, kishte besuar se institucionet e Republikës së Kosovës do ta dëgjonin dhe do të vepronin.

Më 22 tetor, vetëm pak ditë para se të vritej, ajo i ishte drejtuar me një letër urgjente Prokurorisë Themelore në Pejë, duke kërkuar veprime të menjëhershme, ekzekutimin e një urdhri gjyqësor dhe hetimin e zyrtarëve që sipas saj kishin dështuar në përmbushjen e detyrave të tyre. Në fund të asaj letre gjendet një fjali që sot na rëndon në ndërgjegjen e secilit prej nesh, veçanërisht atyre që kanë përgjegjësi për zbatimin e ligjit. Ajo shkruante: "Uroj që të mos vijë dita kur ju dhe institucionet përgjegjëse të detyroheni të jepni llogari vetëm pasi të jetë marrë jeta ime".

Sa e dhimbshme dhe tronditëse është që sot po diskutojmë pikërisht për atë që ajo kishte paralajmëruar. Prandaj, sot kemi edhe të drejtë, edhe detyrim të pyesim: Çfarë ndodhi me letrën e saj? Kush e shqyrtoi? Çfarë veprimesh ndërmori prokuroria? A u vlerësua seriozisht rreziku që ajo kishte paralajmëruar? A u ekzekutua urdhri gjyqësor që ajo përmendte? Dhe nëse jo, kush ishte përgjegjës për moszbatimin e tij? Këto pyetje kërkojnë përgjigje konkrete dhe jo arsyetime të përgjithshme.

Të nderuar deputetë,
Prokuroria nuk mund të jetë vetëm institucion që vepron pasi krimi të ketë ndodhur. Ajo ka përgjegjësi të veprojë me urgjencë kur ekzistojnë paralajmërime konkrete për rrezikun ndaj jetës. Po kështu, gjykatat duhet t'i trajtojnë rastet e dhunës ndaj grave me seriozitetin që e kërkojnë rrethanat. Vendimet gjyqësore nuk mund të mbeten vetëm në letër. Ato duhet të zbatohen dhe institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë që masat mbrojtëse të jenë efektive.

Çfarë kuptimi ka një urdhër gjyqësor nëse ai nuk zbatohet? Çfarë kuptimi ka një denoncim nëse nuk pasohet nga veprimet e nevojshme? Drejtësia nuk mund të kufizohet vetëm në ndëshkimin e autorit pasi të jetë kryer krimi. Duhet të jetë edhe mekanizëm mbrojtës që ndërhyn në kohë për të parandaluar humbjen e jetëve njerëzore. Pavarësia e sistemit të drejtësisë është parimi themelor i shtetit demokratik, por pavarësia nuk nënkupton mungesë përgjegjësie. Përkundrazi, ajo kërkon standarde edhe më të larta profesionalizmi dhe llogaridhënie.

Të nderuar kolegë,
Republika e Kosovës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm me forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e grave nga dhuna. Konventa e Stambollit, të cilën në këtë Kuvend e kemi përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përbën një zotim të qartë shtetëror për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave. Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma dhe janë avancuar mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e grave, përfshirë përpjekjet për funksionalizimin e mbikëqyrjes elektronike të personave ndaj të cilëve janë caktuar masa të caktuara gjyqësore. Por,

sot duhet ta themi qartë: miratimi i ligjeve nuk mjafton nëse ato nuk zbatohen. Reformat nuk e përmbushin qëllimin e tyre nëse nuk përkthehen në siguri konkrete për qytetarët.

Përgjegjësia jonë nuk përfundon me miratimin e ligjeve, me zotimet apo me ndarjen e mjeteve financiare. Ne duhet të sigurohemi që mekanizmat mbrojtës të funksionojnë dhe që secili institucion të përmbushë detyrimet e veta. Por, përtej ligjeve, ekziston edhe një problem i thellë shoqëror dhe institucional. Dhuna në familje ende vazhdon të trajtohet në mjaft raste si çështje private, si konflikt mes bashkëshortëve apo si problem që duhet të zgjidhet brenda mureve të shtëpisë. Por, dhuna ndaj grave nuk është çështje private; është shkelje e të drejtave të njeriut, është çështje e sigurisë publike dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e shtetit.

Asnjë paralajmërim për dhunë nuk duhet të nënvlerësohet. Asnjë grua nuk duhet të detyrohet të dëshmojë vazhdimisht se jeta e saj është në rrezik për t'u marrë seriozisht nga institucionet. Kjo kërkon ndryshim të qasjes institucionale që nga zyrtari i parë që pranon denoncimin, te hetuesi policor, te prokurori, gjyqtari dhe te secili institucion që ka përgjegjësi për mbrojtjen e viktimës. Duhet të ndërtojmë një kulturë institucionale ku mbrojtja e jetës së grave të mos varet nga ndjeshmëria individuale e një zyrtari, por të jetë një detyrim i panegociueshëm ligjor dhe profesional.

Të nderuar deputetë,
Në rastin e Arlindës është e domosdoshme të shqyrtohet i gjithë zinxhiri institucional, nga momenti i parë kur ajo ka kërkuar mbrojtje deri te veprimet e fundit të ndërmarra apo të mosndërmarra para vrasjes së saj. Duhet të dimë nëse ka pasur neglizhencë, vonesa të pajustifikueshme, moszbatim të vendimeve gjyqësore apo dështim të koordinimit ndërmjet institucioneve. Nëse konstatohen dhe kur konstatohen shkeljet, përgjegjësia duhet të jetë individuale dhe institucionale në përputhje të plotë me ligjin.

Si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje kemi kërkuar mbajtjen e kësaj seance të jashtëzakonshme dhe kemi iniciuar themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për të shqyrtuar gjithë zinxhirin e përgjegjësisë institucionale. Ky komision, nuk synon të zëvendësojë hetimin penal apo kompetencat e organeve të drejtësisë. Përmes mbikëqyrjes parlamentare synojmë të identifikojmë dështimet eventuale dhe të kërkojmë masa konkrete që raste të tilla të mos na përsëriten, sepse nuk mjafton që pas çdo vrasjeje të shprehim dhimbje dhe të kërkojmë drejtësi. Duhet të kuptojmë dhe të japim përgjigje pse mekanizmat që ekzistojnë për mbrojtjen e viktimave nuk arrijnë të përmbushin gjithmonë qëllimin e tyre.

Të nderuar kolegë,
Letra e Arlindës nuk duhet të mbetet vetëm një dëshmi tronditëse e ditëve të fundit të jetës së saj. Ajo duhet të na shërbejë si thirrje për përgjegjësi dhe për një shqyrtim serioz të mënyrës se si funksionojnë institucionet tona. Ne nuk mund ta kthejmë jetën e saj, por kemi detyrimin të

kërkojmë të vërtetën, të identifikojmë përgjegjësitë dhe të bëjmë gjithçka që është në kompetencën tonë që përgjegjësit të marrin dënimin e caktuar e që asnjë grua tjetër të mos përballet me të njëjtin fat. Drejtësia që vjen vetëm pas tragjedisë nuk mjafton. Na duhet një drejtësi që vepron në kohë, që mbron jetën dhe që nuk i lë paralajmërimet pa përgjigje.

Andaj, ju bëj thirrje që bashkërisht ta miratojmë rezolutën në fund të kësaj seance dhe po ashtu të mbështesim komisionin hetimor parlamentar që duhet të shqyrtojë secilën hallkë të institucioneve që dështuan në përmbushjen e misionit të tyre.
Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar zonja Nagavci! Tani është radha e grupeve parlamentare, dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje do ta marr fjalën unë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuara media,
Më 22 tetor, Arlinda Zekaj iu drejtua Prokurorisë Themelore në Pejë me një kërkesë urgjente dhe në fund të letrës së saj ajo shkroi: "Uroj që të mos vijë dita kur ju dhe institucionet përgjegjëse të detyroheni të jepni llogari vetëm pasi të jetë marrë jeta ime".

Tri ditë më vonë, më 25 tetor, Arlinda u vra në shtëpinë e saj në Vitomiricë të Pejës. Fjalët e saj sot tingëllojnë si paralajmërim tragjik që nuk arritëm ta parandalonim. Një grua ka humbur jetën, një djalë ka humbur nënën e një nënë ka humbur të bijën. Në emrin tim dhe në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Arlindës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Në maj të vitit 2011 Diana Kastrati u vra pasi kishte kërkuar mbrojtje nga gjykata. Hamide Magashi u vra në oborrin e Klinikës së Gjinekologjisë pak ditë para se të sillte në jetë fëmijën e saj. Erona Cokli u vra brenda Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj. Arlinda Zekaj u vra pak pasi ishte kthyer nga stacioni policor, ku kishte raportuar dhunën në familje.

Mes tyre janë edhe Igballe Llalloshi, Gjyla Gashi, Antigona Morina, Donjeta Pajazitaj, Zejnepe Berisha, Dafina Zhubi, Flora Omuri, Feride Tahiri, Sevdije Berisha, Albesa Rudi, Feride Prokshi, Arjanita Zahiti, Emine Abazaj, Valbona Marku Ndrecaj dhe vajza e saj nëntëvjeçare Klara Ndrecaj, Hatije Dinaj, Armenda Aliu, Sabile Mavrovçani, Makfire Zuka, Sebahate Morina Sopi, Marigona Osmani, Liria Qerimaj, Besiana Rama, Shqiponja Isufi, Sadie Godeni, Hyrije Broqi Hyseni, Maria Klara, Urda Nguraj, Liridona Ademaj, Gjyljeta Ukella, Nexhmie Haradini,

Nafie Bugujevci. Kjo nuk është lista e plotë. Janë 97 gra që janë vrarë ose nga burrat e tyre ose nga familjarë të tjerë burra që nga paslufta në Kosovë - 97 gra.

I përmenda sot disa prej tyre, sepse këto vrasje nuk mund t'i trajtojmë si tragjedi të shkëputura nga njëra-tjetra. Është femicid, forma më e skajshme e dhunës ndaj grave. Femicidit i paraprijnë kërcënimet, kontrolli, frikësimi dhe dhuna e përsëritur, por në rrënjë të tij qëndron mendësia që gruan e sheh si pronë, që përpiqet t'ia kontrollojë jetën dhe zgjedhjet, që xhelozinë e arsyeton si dashuri dhe dhunën vazhdon ta trajtojë si çështje private. E, kundër kësaj mendësie duhet të angazhohemi të gjithë si shoqëri, e në veçanti burrat, edhe burrat e këtij Kuvendi, ngase nuk mund të presim që vetëm gratë të flasin kundër dhunës që ushtrohet ndaj tyre. Edhe sot në këtë Kuvend, si kryetare e Kuvendit, pres që edhe burrat të flasin kundrejt vrasjes së grave e vajzave në vendin tonë. Burrat duhet të jenë pjesë e ndryshimit në familje, në shkollë, në institucionet që drejtojnë, por po ashtu edhe në shoqëri.

Por përballja me këtë mendësi, sado e domosdoshme, nuk na çliron nga detyrimet që kemi si institucione. Një grua që e denoncon dhunën ka të drejtë të presë që rreziku të vlerësohet me seriozitet, që vendimet të zbatohen dhe që institucionet të bashkërendojnë veprimet e tyre. Dhe pikërisht këtu duhet ta përqendrojmë sot debatin: A po arrijmë ta përmbushim këtë detyrim dhe çfarë duhet të ndryshojmë aty ku mbrojtja nuk funksionon? Kjo përgjegjësi na përket të gjithëve, pavarësisht bindjeve politike apo funksioneve që sot i ushtrojmë, sepse siguria e grave është çështje e përgjegjësisë publike dhe e funksionimit të shtetit. Si institucione kemi bërë përparime në infrastrukturën ligjore, u përmendën ato edhe nga zonja Nagavci. Në vitin 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës përfshiu Konventën e Stambollit në Kushtetutën tonë. Miratuam Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe lista e veprimeve që ne i kemi ndërmarrë është e gjatë. Mirëpo, natyrisht që nuk do të merrem sot me të njëjtat.

Asnjëra prej të gjitha këtyre veprimeve që ne i kemi ndërmarrë nuk po mjafton. Nuk po mjafton për sa kohë kemi ende zyrtarë në institucionet e Republikës së Kosovës: në polici, në prokurori, në gjykata, në Qendrën për Punë Sociale apo kudo tjetër që e vendosin në diskrecionin e tyre a duhet ta ndërmarrin një veprim apo jo. Pikërisht për këto arsye sot do të flasim si Kuvend i Republikës së Kosovës. Çfarë kuptimi ka një ligj që miratohet në këtë Kuvend në qoftë se atje një prokurore, një gjyqtare, një polic nuk e zbaton si të tillë?

Prandaj, ky është vendi ku ne duhet të flasim me zë të lartë, sepse një grua që kërkon mbrojtje, nuk ka nevojë të dijë vetëm se ekziston një dispozitë ligjore që ia njeh një të drejtë; ajo ka nevojë të ndiejë mbrojtjen e institucionit pikërisht atëherë kur rreziku është më i madh. Dhe çfarë faji ka ministrja Gërvalla ose ministri Sveçla nëse Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme i kanë adresuar legjislacionin dhe mekanizmat që kanë në dispozicion? Cila është përgjegjësia që ka ministrja e Drejtësisë këtu apo ministri i Punëve të Brendshme?

Nuk mund të flasim, ju lutem që të keni durimin derisa ta mbaroj fjalën, sepse do të kemi mundësi të flasim gjerë e gjatë. Pra, për këtë arsye, mënyra se si vlerësohet rreziku, si shkëmbehen informacionet ndërmjet institucioneve dhe si ndiqet zbatimi i masave mbrojtëse duhet të jenë në qendër të vëmendjes sonë. Në rastin e Arlindës kërkojmë që të hetohen pa vonesa dhe pa asnjë përjashtim veprimet dhe mosveprimet e secilit institucion që ka qenë i përfshirë: qoftë nga policia, nga prokuroria, nga gjykatat, nga Qendrat për Punë Sociale, por edhe nga institucione të tjera kompetente. Sa kanë vepruar, kur kanë vepruar, si kanë vepruar, të gjitha, çdo detaj deri në fund.

Nuk mjaftojnë raportet që konstatojnë mangësi dhe pastaj përfundojnë në sirtar. Kërkojmë hetim të pavarur, përgjegjësi të përcaktuara qartë dhe masa ligjore ndaj kujtdo që rezulton se ka shkelur detyrën. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë se shteti nuk është vetëm një nocion abstrakt. Pas çdo institucioni, janë njerëz që marrin vendime, që kanë detyrime dhe që duhet të japin llogari. Sepse, kur dështimin ia atribuojmë vetëm shtetit, rrezikojmë t'i lirojmë nga përgjegjësia pikërisht ata që kanë pasur detyrimin të veprojnë.

Të nderuar deputetë,
Këtu në këtë sallë, e përmenda edhe më herët, kemi bindje të ndryshme politike. Debati dhe mospajtimi janë pjesë e demokracisë, por mbrojtja e jetës dhe e dinjitetit të grave duhet të na bashkojë përtej këtyre dallimeve. Nuk kërkoj që ta shmangim debatin për përgjegjësitë, përkundrazi, kërkoj që ai të jetë i bazuar në fakte dhe të na çojë drejt zgjidhjeve. Bashkimi ynë përballë femicidit nuk do të thotë se duhet t'i mbyllim sytë para lëshimeve apo t'i shmangim përgjegjësitë, asnjëherë. Përgjegjësia individuale duhet të përcaktohet nga organet kompetente, ndërsa përgjegjësia jonë si ligjvënës është që të sigurohemi që mangësitë e konstatuara të korrigjohen dhe që mekanizmat e mbrojtjes të funksionojnë.

Si kryetare e Kuvendit e konsideroj të domosdoshme që komisionet përkatëse parlamentare të ndjekin zbatimin e legjislacionit kundër dhunës ndaj grave, të kërkojnë raportim nga institucionet brenda kompetencave të tyre dhe të identifikojnë masat që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme. Në fillim të kësaj fjale unë i shqiptova emrat e disa prej grave që janë vrarë gjatë këtyre viteve prej përfundimit të luftës. Do të ishte e rëndë nëse kjo seancë do të mbahej mend si seanca ku kemi lexuar emrin e një gruaje të vrarë dhe kemi shtuar një fjalim në procesverbalet e Kuvendit. Kuptimi i kësaj seance do të përcaktohet nga ajo që do të bëjmë pas saj, nga mënyra se si do të trajtohet denoncimi i radhës, si do të vlerësohet rreziku dhe sa në kohë do të veprojnë institucionet përgjegjëse.

Derisa ne flasim këtu, ka gra e vajza që jetojnë nën kërcënim të përditshëm. Ka gra që mund të jenë duke mbledhur guximin për të kërkuar ndihmë, që ende nuk e dinë nëse do të gjejnë mbrojtje apo nëse do të duhet të përballen të vetme me frikën e tyre. Do të punojmë që përgjigjja e shtetit të mos varet nga rastësia, nga vullneti i një zyrtari apo nga institucioni në derën e të cilit

troket një grua. Andaj, le të bëjmë gjithçka që është në përgjegjësinë tonë që emrat e grave, të cilat nesër do të kërkojnë mbrojtjen e institucioneve të mos na vijnë një ditë në këtë foltore si emra që do t'i përkujtojmë. Ju faleminderit!

Tani është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së. Kush e dëshiron fjalën? Zonja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: E nderuar kryetare e Kuvendit,
I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë!
Sot nuk dua të flas si deputete, por para së gjithash si një grua, si një grua që sot ndien dhimbje, pikëllim, zemërim dhe turp për një shtet që nuk arriti të mbrojë një grua që kërkoi ndihmë.

Arlinda Zekaj, para se të mbyllte sytë përgjithmonë, i kishte shkruar Prokurorisë Themelore në Pejë. Kishte treguar për frikën e saj, për dhunën dhe për rrezikun që i kanosej. Ajo kishte thënë se shpresa e saj e fundit për mbrojtje ishte shteti. A mund ta imagjinoni se çfarë do të thotë kjo?

Të jetosh me frikë, të kërkosh ndihmë, të mbledhësh guximin për t'ju drejtuar shtetit, t'i besosh shtetit se më në fund dikush mund ta mbrojë, dhe në fund të mos jesh më gjallë! Arlinda i besoi shtetit, por shteti nuk arriti ta mbrojë atë! Sot ajo grua nuk është më, një familje është shkatërruar dhe ne kemi edhe një emër tjetër që na kujton se çfarë ndodh kur thirrjet për ndihmë nuk dëgjohen me kohë, kur shteti nuk vepron dhe kur neglizhenca institucionale shndërrohet në dhunë institucionale dhe merr jetë.

Arlinda sot, Liridona dje, Marigona, Donjeta, Gjyljeta, Liria, Hamidja, Erona, Sebahatja, Sabilja, Makfirja e shumë të tjera janë vargu i grave që sot nuk janë si pasojë e si shkak i neglizhencës dhe mosveprimit të duhur institucional. Edhe sa gra të tjera nuk duhet të jenë me ne, duhet të vriten që institucionet tona të kuptojnë se dhuna ndaj grave nuk është çështje private, por është alarm shtetëror. Ne kemi ligje, u fol për këto këtu, kemi urdhra mbrojtës, polici, prokurori, institucione që kanë detyrë të mbrojnë jetën, por ligjet që nuk zbatohen duket se nuk i shpëtojnë gratë.

Paralajmërimet që neglizhohen, mund të bëhen fjala e fundit e viktimës. Prandaj, sot nuk mjaftojnë as ngushëllimet, nuk mjafton dënimi i krimit. As fjalimet tona këtu nuk mjaftojnë. Duhet të ketë hetim, transparencë, përgjegjësi për çdo neglizhencë dhe mosveprim institucional që ka kontribuar në këtë tragjedi.

Arlinda sot nuk mund të flasë, por letra e saj flet shumë. Frika e saj, shpresa e saj e fundit na akuzon të gjithëve që kemi përgjegjësi për ta mbrojtur jetën. Kjo letër do të mbetet gjallë në ndërgjegjen tonë kolektive. E një varg i saj thotë, u tha tri herë këtu: "Uroj të mos vijë dita kur ju

dhe institucionet përgjegjëse të detyroheni të jepni llogari vetëm pasi të më jetë marrë jeta ime". Dhe, sot, fatkeqësisht, është kjo ditë. Kjo ditë është pasqyra jonë. Kjo ditë është pasqyra institucionale, por edhe morale.

Asnjë grua nuk duhet të vdesë duke pritur ta shpëtojë shteti. Fillimisht, familja duhet të jetë foleja e parë e sigurisë dhe ngrohtësisë, e shteti duhet të jetë streha e fundit, e jo zhgënjimi i fundit i një gruaje. Për Arlindën e për të gjitha gratë e vrara, për ato që sot jetojnë me frikë dhe ende shpresojnë se dikush do t'i dëgjojë e do t'i mbrojë: mos lejoni që letra e Arlindës të bëhet edhe një dokument tjetër në dosje. Ajo duhet të jetë zilja jonë për zgjim moral, shoqëror dhe institucional, për edukim të ri dhe për veprim.

Ne kemi folur boll, kemi protestuar me mijëra herë, kemi hartuar ligje, strategji e rezoluta që rrinë në sirtar e nuk gjejnë zbatim, por boll më! Këto janë veç veprime reaktive. Kërkojmë përgjegjësi, llogaridhënie në zinxhirin institucional, veprime konkrete në zbatimin e ligjeve dhe politikave për dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore. Kërkojmë ndjekje penale për përgjegjësit në zinxhirin institucional dhe, më së shumti, po ashtu kërkojmë përgjegjësi morale. Përgjegjësi morale, e cila vjen po ashtu me përgjegjësinë institucionale. Nuk mund të amnistohet shteti në raste të këtilla.

Do e mbyll duke cituar edhe një herë letrën e Arlindës, e dhimbshme deri në asht: "As pas vrasjes sime nuk pres t'i përgjigjeni, por pres të mos flini më". Sa për sqarim, ky do të jetë fjalimi ynë i vetëm si Grup Parlamentar në këtë seancë të jashtëzakonshme, sepse nuk mendojmë se fjalimet tona mund t'i kontribuojnë gjendjes në fjalë, por presim veprime konkrete. Gjithsesi, do ta mbështetim themelimin e komisionit hetimor dhe punën e tij.

Ngushëllime edhe një herë familjes Zekaj dhe të gjithë atyre që e njohën Arlindën.

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar deputete Hoxha! Tani është radha e Grupit Parlamentar të LDK-së. E ftoj deputeten Vjosa Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Të nderuar deputetë!
Zoti kryeministër,
Anëtarë të Qeverisë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!
Prindër të kësaj Republike që zgjoheni me dhimbjen dhe frikën se po i rritni fëmijët në një shoqëri që arsyeton vrasësit, që nxit dhunë ndaj grave dhe që e përqesh vazhdimisht dhimbjen e tyre.

Qytetarë të kësaj shoqërie, e cila duhet të presë vrasjen e grave dhe letrën e Arlindës për ta kuptuar se diçka është thellësisht gabim me të. Letra e Arlindës duhet të shndërrohet në

testament për këtë shoqëri. Ajo na e dëshmon për të satën herë radhazi se dhuna nuk fillon në ditën kur një grua vritet. Ajo fillon shumë më herët. Fillon kur një burrë mendon se mund t'ia kontrollojë jetën një gruaje, kur refuzimin e saj e përjeton si fyerje, kur largimin e saj e sheh si sfidë ndaj autoritetit të vet, kur bindet se ka të drejtë të vendosë për jetën e saj, kur e sheh që shteti nuk e merr në përgjegjësi kur ai përdor dhunë ndaj saj, kur e sheh argëtimin e masës me shtypjen e tij ndaj saj, duartrokitjet e mendjeve primitive, të cilat fajësojnë viktimën e assesi burrin e dhunshëm e të shfrenuar.

Dhuna ndaj grave asnjëherë nuk është vetëm ajo që ndodh në çastin e sulmit, është edhe ajo që e përgatit terrenin për të. Vrasja është akti i fundit. Ajo nuk fillon gjithmonë me një goditje, as me sëpatë e as me plumb. Fillon me një fjalë që të poshtëron, me një kërcënim që relativizohet, me një fyerje që duartrokitet dhe me një sulm publik që shndërrohet në argëtim për turmën. Kur gjuha e urrejtjes ndaj grave përsëritet pa pasoja, ajo pushon së perceptuari si alarm dhe fillon të trajtohet si diçka e zakonshme. Kështu ndërtohet pak nga pak një klimë ku poshtërimi i gruas nuk shkakton më indinjatë, ku cenimi i dinjitetit të saj nuk konsiderohet më shkelje dhe ku agresori mëson se mund të shkojë edhe më tej, deri në vrasje.

Dhe bëhet edhe më e rrezikshme kur kjo mendësi nuk has në kundërshtimin e prerë nga shoqëria, por justifikohet, relativizohet, fshihet pas dyerve të shtëpisë apo trajtohet si çështje private, kur poshtërimi i një gruaje shndërrohet në argëtim publik, kur kërcënimet ndaj saj trajtohen si teprim emocional, kur një grua sulmohet pikërisht, sepse guxon të flasë, të vendosë, të kundërshtojë apo të largohet nga dhuna, e pastaj ndodh vrasja. E, çfarë bën turma? "Me siguri e ka merituar". "Kush e di se çfarë ka bërë", duartrokasin të tjerët. "Burri nuk e ka vrarë pa arsye", arsyetojnë disa, teksa të tjerët argëtohen me thashetheme, të cilat sa çel e mbyll sytë përhapen kundër gruas, e assesi kundër vrasësit. E, më tragjikja në këtë mes që disa prej atyre që gjykojnë e arsyetojnë janë edhe vetë gra, madje edhe në prokurori.

Merreni me mend, sipas studimeve ndërkombëtare të para disa viteve, 2/3 e shoqërisë kosovare mendojnë se gruaja e ka merituar dhunën nëse bashkëshorti e përdor atë ndaj saj. E kjo logjikë është thellë e rrënjosur edhe në polici, edhe në prokurori, edhe në gjyqësor, edhe në politikë. Prandaj, ne nuk mund të flasim për liri nëse lirinë e gjysmës së shoqërisë e kushtëzojmë me frikën e gjysmës tjetër. Përballë kësaj mendësie, shteti asnjëherë nuk guxon të qëndrojë si spektator, dhe kjo përgjegjësi asnjëherë nuk guxon të matet me numrin e seancave tona, me forcën e deklaratave apo me solemnitetin e homazheve.

Aq më pak duhet të matet me luftën e paskrupullt në komisionin hetimor, i cili do të bëhet mes partive se kujt do t'i mbetet fajit. Ajo do të matet vetëm me sigurinë e vërtetë që u ofrojmë grave në jetën e përditshme. Do të matet me gatishmërinë e secilit për t'u nisur nga vetvetja, me gatishmërinë për të pyetur, edhe nëse duhet të paguajë çmim personal, se ku është shteti në raport

me premtimet që i ka dhënë vetë për vite me radhë për ta luftuar këtë dukuri, duke filluar nga premtimi për ta çrrënjosur këtë dukuri deri në zbritjen e rasteve me fatalitet në 100%.

Do të matet edhe me gatishmërinë për të pyetur se çfarë ndodhi me Ligjin për armët dhe revokimin e përhershëm të lejes së posedimit të armëve për ata që përdorin dhunë. Do të matet me pyetjen pse nuk është amendamentuar Kodi Penal që të parashohë edhe femicidin si vepër të veçantë penale, si dhe dhunën në hapësirën dixhitale. Do të matet me pyetjen pse brenda policisë akoma nuk është rritur numri i njerëzve që merren me këto raste dhe në të njëjtën kohë nuk është rritur numri i punëtorëve në Qendrat Sociale aq sa është nevoja? Ku janë fushatat e vetëdijesimit që të mos normalizohet dhuna askund, madje as këtu ku jepet shembulli.

Përgjegjësia e vërtetë e këtij Kuvendi do të matet me gatishmërinë për të marrë në përgjegjësi pa arsyetuar askënd. Askënd! Pavarësisht a i takon partisë sonë apo jo.

Vepra e dhunës në familje dhe dhunës mbi bazë gjinore në fakt do të duhej ta kishte dënimin e njëjtë si terrorizmi, sepse gratë që përjetojnë dhunën përjetojnë terror çdo ditë. Dënimet aktuale janë tepër të lehta, aq të lehta sa e nxisin dhunën, dhe madje aq të lehta sa janë, as ato nuk shqiptohen nga gjykatat tona. Merreni me mend, sipas vlerësimeve brenda vetë institucionit të drejtësisë, në shumicën dërmuese të rasteve jepen dënime edhe më të lehta sesa ato të parapara me ligj. Ligji thotë edhe burg, edhe gjobë; ata japin vetëm gjobë. 300 euro! 300 euro, kaq është vlera e një gruaje dhe e jetës së saj në sistemin tonë të drejtësisë.

E, njëkohësisht ne duhet ta kuptojmë se shteti nuk mund ta bëjë i vetëm këtë ndryshim. Kjo është një emergjencë kombëtare që kërkon veprimin e secilit prej nesh. Veprimi fillon në shtet, por pastaj vazhdon edhe në familje, ku djemtë duhet të mësojnë se forca nuk është e drejta për të sunduar, në shkolla, ku respekti nuk duhet të mbetet vetëm fjalë në libra, në media, ku dinjiteti i një gruaje nuk duhet të sakrifikohet për vëmendje dhe klikime, në hapësirën digjitale, ku secili që përdor gjuhë të dhunshme e kërcënuese ndaj grave duhet të përgjigjet para ligjit para se të bëhet vonë, e në shoqërinë tonë, ku asnjë grua nuk duhet të mbetet vetëm veç pse ka vendosur t'i thotë jo dhunës.

Dhe fillon te secili prej nesh, kur vendosim të mos heshtim përballë një kërcënimi, të mos qeshim me një poshtërim, te burrat të cilët nuk ulin kokën, por reagojnë sa herë që para tyre poshtërohet apo sulmohet një grua.

Nuk kemi nevojë për një shoqëri që vetëm qan më fort pas çdo tragjedie. Kemi nevojë për një shoqëri që e kundërshton më herët atë që mund të shkaktojë tragjedinë. Sepse, ajo që duhet të na shqetësojë, përveç vrasjes së grave, është edhe fakti se kjo shoqëri po mësohet me lajmin se një grua është kërcënuar, dhunuar apo vrarë. Tronditja po shndërrohet në rutinë, e zemërimi po zgjat vetëm derisa të vijë lajmi tjetër. Momenti kur fillojmë ta pranojmë dhunën si pjesë të zakonshme

të jetës, është momenti kur duhet të shqetësohemi më së shumti për shoqërinë në të cilën jemi duke u shndërruar.

Por, nuk duhet ta pranojmë! Nuk duhet të pranojmë që vajzat tona të rriten duke mësuar se liria ka një çmim që duhet të jenë të gatshme ta paguajnë. Vajzat e këtij shteti duhet të rriten pa pasur frikën për jetën e tyre. Por, kush do t'u mbrojë jetën? Kush? Ky shtet? Jo! Ky shtet ka dështuar, dhe vulën e këtij dështimi e gjeni në letrën e Arlindës.

Dhe në fund, kjo është çështja që kemi përpara, jo vetëm si t'i mbrojmë gratë nga dhuna, por se çfarë shoqërie duam të jemi. Një shoqëri ku frika e grave e vajzave tona nuk bëhet përgjegjësi vetëm e saj, apo një shoqëri e seancave, e rezolutave shumë, e veprave hiç?

Përgjigjja nuk mund të mbetet vetëm në këtë sallë, sepse në fund, mënyra se si i trajtojmë gratë nuk tregon vetëm se çfarë mendojmë për to, por tregon se sa e kuptojmë lirinë.

Arlinda, para se të bëhej viktima e radhës e femicidit në Kosovë, ishte vajza e vogël me ëndrra të mëdha. Vajza e babit, drita e syve të nënës, motra, shoqja, e mbi të gjitha, nëna e një djali të vogël. E si mund të ndahet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ju lutem, regjia, edhe një minutë zonjës Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: E, si mund të ndahet një nënë nga fëmija? Pyeti sot vajza e axhës së Arlindës. E këtu qëndron krimi i shumëfishtë i shtetit tonë, i atij shteti që fëmijën e lejon te familjarët që ushtrojnë dhunë, që e detyrojnë nënën të rrezikojë edhe jetën për ta marrë përsëri nën kujdes fëmijën e vet, e derisa e merrte nën kujdes, përfundon me fatalitet në atë përpjekje.

Me Arlindën, sikurse edhe me shumë gra para saj, do të varroset ndërgjegjja e munguar e kësaj shoqërie që akoma nuk u mësua se jeta e një gruaje është e barabartë me atë të burrit. Por, nuk duhet assesi të lejojmë që të varroset edhe përgjegjësia.

Prandaj, jo vetëm shkarkim i menjëhershëm, por edhe përgjegjësi penale për tërë zinxhirin komandues dhe për secilën e secilin që duke toleruar, injoruar, përqeshur e lejuar dhunën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Osmani-Sadriu! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të Aleancës. Zoti Tahiri, a jeni në emër të Grupit? Urdhëroni!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuara media,
Qytetarë të Republikës së Kosovës.
Më lejoni që në këtë ditë zie e dhimbje për secilin shqiptar, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Arlinda Zekajt, të afërmve të saj, të gjithë atyre që e kanë njohur e që janë prekur, si dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

Një humbje e rëndë, e cila pa asnjë dyshim na ka prekur shumë. Pa asnjë dyshim, vrasja e Arlindës është një tragjedi që na ka tronditur të gjithëve, por nuk është një rast i veçuar, fatkeqësisht është duke u bërë një fenomen i cili në Kosovë na obligon, sidomos neve që jemi të zgjedhur në Kuvend, mirëpo edhe institucioneve përgjegjëse, të reflektojmë dhe mbi të gjitha të kërkojmë përgjegjësi. Nuk mjafton vetëm të shprehim ngushëllime. Nuk mjafton vetëm të dënojmë rastin. Nuk mjafton të vazhdojmë të flasim vetëm atëherë kur ndodhin tragjeditë.

Sot do të duhej të kishte reflektim, do të duhej të kishte dorëheqje, do të duhej të kishte shkarkime, nëse asgjë tjetër, si veprim etik ndaj një ngjarjeje, e cila u shkaktoi dhimbje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhuna ndaj grave nuk duhet të trajtohet si një varg apo si një veprim i izoluar. E që besa, jo vetëm edhe si femicid duhet të trajtohet, por edhe prej perspektivës së përgjegjësisë dhe pyetjes së thjeshtë: ku ka qenë dhe ku është shteti në këtë rast dhe në rastet e kaluara?

Unë e kuptoj se në këto momente duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos i shfrytëzojmë për një garë politike e për ngritjen e gishtit ndaj dikujt. Mirëpo, është e papranueshme që dikush që ka përgjegjësi shtetërore e institucionale mbi gjysmë dekade të mos ketë veprime të cilat së paku e përçojnë një mesazh etik. Për ne është jashtëzakonisht e rëndësishme që prej këtu, nga Kuvendi, prej kësaj rezolute të adresohen tri çështje që janë burimore dhe reflektim i këtij momenti:

Çështja e parë lidhet me kërkesën për një hetim të plotë dhe një identifikim të përgjegjësisë institucionale. Çfarë nënkupton kjo? Ne si Kuvend kërkojmë nga të gjitha institucionet kompetente që të bëjnë një hetim të hierarkisë institucionale, horizontale dhe vertikale, dhe të shohim pse nuk është vepruar, apo në qoftë se është vepruar gabim, pse ka ndodhur ajo?

Me këtë rast nuk kërkojmë vetëm shkarkimin e personave zyrtarë, por kërkojmë hetim penal për një rast, i cili është kriminal e barbar. Të gjithë ata që kanë përgjegjësi eventuale do të duhej të trajtohen në përputhje me ligjin, duke garantuar dhe duke u siguruar në një llogaridhënie, e cila është transparente në të gjitha nivelet.

Çështja e dytë që duhet të ndërmerret, e cila është pjesë edhe e kësaj rezolute, është themelimi i komisionit hetimor parlamentar, i cili do të ketë mandat për të shqyrtuar në detaje reagimin dhe veprimet e institucioneve përgjegjëse, për të identifikuar mangësitë sistematike dhe për të propozuar masa konkrete në funksion të parandalimit të rasteve, si rasti në fjalë. Këto masa duhet të përfshijnë, në radhë të parë, përmirësimin e kornizës ligjore, e së dyti, forcimin e mekanizmave institucionalë në mbrojtje të secilës grua në këtë vend.

Çështja e tretë ndërlidhet me propozimin e masave për parandalimin e dhunës, e cila është në rritje e sipër në shoqërinë tonë.

Të nderuar deputetë,
Nuk guxojmë ne si të zgjedhur, por as institucionet, as të heshtim e as të mos e trajtojmë asnjë rast të vetëm për të cilin vihemi në dijeni. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që këto masa, të cilat ndërlidhen me vetëdijen shoqërore, të jenë të fuqizuara në mënyrë që i gjithë zinxhiri institucional të ketë qasjen dhe rangimin e vet.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është duke e trajtuar këtë çështje edhe nga këndvështrimi i mbrojtjes së jetës dhe dinjitetit të qytetarëve dhe duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur që në këtë kërkesë për hetim dhe llogaridhënie institucionale të shqyrtohen të gjitha masat konkrete për të parandaluar këtë akt.

Edhe një herë, ngushëllime familjes, ngushëllime gjithë Kosovës!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar Multietnik. Urdhëroni, zoti Asllani, në emër të grupit.

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!
E nderuara kryetare,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuara media,
Të dashur kosovarë!
Sot nga kjo foltore unë, si deputet i këtij Kuvendi, dua të flas së pari si prind, si prind i tre djemve të mi të cilët i rris në shtëpinë time. Edhe sot dua të diskutoj që fokusi ynë duhet të vendoset se a jemi të interesuar për parandalim apo jemi të interesuar që këtij lloj seancash të mbajmë çdo muaj apo edhe më shpesh, sikurse kemi mbajtur pas vrasjes tragjike të Arlindës dhe jo vetëm.

E dimë të gjithë që një jetë është humbur, një familje është goditur rëndë nga kjo tragjedi. Po natyrisht, drejtësia duhet të thotë fjalën e saj dhe institucionet duhet të marrin përgjegjësi dhe duhet ta sqarojnë çdo rrethanë, çdo veprim dhe çdo mosveprim të mundshëm. Por, unë sot dua që këtë temë ta trajtoj pak më ndryshe. Dua ta bëj një pyetje se ku fillon e vërteta e përgjegjësisë sonë si shoqëri? A fillon në stacion policor, në prokurori, në gjykatë, apo kjo fillon shumë më herët se kaq, brenda familjeve tona, aty ku lindim, rritemi dhe formohemi si njerëz?

Askush prej nesh nuk ka lindur deputet, ministër, polic, prokuror, gjyqtar apo punëtor social. Ne të gjithë fillimisht kemi qenë fëmijë. Rritemi duke dëgjuar, duke vëzhguar dhe duke imituar njerëzit që na rrethojnë. Mësojmë si trajtohet gruaja, si respektohet tjetri, si zgjidhet një konflikt dhe si mbahet përgjegjësia. Prandaj, unë shpeshherë e pyes veten: Kur fëmija im gabon, a e mësoj ta pranojë gabimin apo e mësoj ta fshehë atë? Kur fëmija im dëmton dikë tjetër, a e mësoj të kërkojë falje apo e arsyetoj vetëm se është fëmija im? E, kur një anëtar i familjes sonë e dëmton tjetrin ose i bën padrejtësi, a kemi guxim t'i themi drejtë që "ti je gabim"? Apo e mbrojmë atë me çdo kusht vetëm se është anëtar i familjes sonë?

Dhe pastaj, kur këta fëmijët e mi të rriten dhe të marrin përgjegjësi publike, të bëhen policë, prokurorë, punëtorë socialë dhe gjykatës, pse duhet të habitem unë kur këta përballen me manipulim, kur këta e fshehin një të vërtetë dhe kur këta kanë mungesë të përgjegjësisë? Se unë jam i bindur që nëse sot ne fëmijët tanë i mësojmë se lidhja familjare është më e rëndësishme se e vërteta, nesër rrezikojmë të kemi një zyrtar që ka për të vendosur interesin personal mbi interesin publik.

Nëse sot unë e mësoj se i forti ka gjithmonë të drejtë, nesër mund të kem një njeri, i cili pushtetin e kupton si të drejtë për të sunduar mbi tjetrin. Dhe nëse sot djali im mëson se burrëria duhet të dominojë, nesër rrezikojmë ta kemi një burrë që dhunën e konsideron si mjet për të ushtruar kontroll mbi gjininë tjetër, mbi gruan.

Të dashur kosovarë, nuk është turp për mua nëse unë e pranoj që fëmija im gabon. Është turp për mua ta mësoj atë që të mbajë përgjegjësi për atë gabim që ka bërë. Sepse nesër, kur të marrë përgjegjësi institucionale, ai do të veprojë drejt dhe nuk do të ndikohet nga ajo se si është rritur.

E, ne shumë flasim për reforma rreth institucioneve, për ligje të reja, për mekanizma të mbikëqyrjes dhe për drejtësi më të drejtë.

Por, mbi të gjitha duhet ta kuptojmë një gjë: institucionet, objektet, ndërtesat dhe ligjet janë më shumë, por njerëzit të cilët punojnë në ato institucione bartin përgjegjësinë për të implementuar të gjithë ata mekanizma. Dhe fillimisht këta njerëz ndërtohen në familjet e tyre dhe në shoqërinë e rrethin ku ata jetojnë.

E, kjo që e thashë nuk e zvogëlon aspak përgjegjësinë e institucioneve. Shteti ka detyrim t'i mbrojë me jetë qytetarët dhe askush nuk mund të fshihet pas një edukimi apo pas një mentaliteti që unë ceka më herët. Por, gjithmonë duhet të punohet që kjo do të ndikojë për t'i shmangur përgjegjësive ligjore. Por nëse duam një ndryshim më afatgjatë, atëherë duhet të flasim më drejt, prej nga po vjen ky problem, jo vetëm pse ka ardhur ky problem. Një familje që ruan nderin, nuk e ruan nderin duke e fshehur përgjegjësinë, por e ruan nderin duke mos e lejuar fare të ndodhë ajo, të mos arrihet fare te veprimi i institucioneve.

Të nderuar kolegë,
Ne, grupi ynë do ta mbështesë rezolutën dhe komisionin hetimor, por nëse duam që raste si të Arlindës të mos kemi më, unë nga kjo foltore dua t'u drejtoj edhe tri mesazhe familjeve tona dhe shkollave:

Është shumë e rëndësishme t'i edukojmë fëmijët me dashuri, por dhe me përgjegjësi, dhe t'i mësojmë ata që ta pranojnë gabimin, ta respektojnë njëri-tjetrin dhe të konsiderojnë se dhuna nuk është mjet dashurie apo force. Sepse, edukimi që u japim sot, është karakteri me të cilin do ta drejtojmë shoqërinë dhe do të marrim përgjegjësi publike nesër.

E për mediat, është shumë e rëndësishme që të mos transmetojnë vetëm tragjeditë, por të bëhemi edhe zë i edukimit, i ndërgjegjësimit dhe i parandalimit. Sepse shoqëria jonë nuk ka nevojë vetëm të informohet, por ka nevojë të mësohet se si të mos ndodhin këto fenomene dhe si të mos përsëriten. Dhe institucione, mos e shihni përgjegjësinë vetëm si përmbushje të procedurave, letrave dhe asaj që e kemi kryer si procedurë. Sepse, pas çdo një ankesë fshihet një jetë njeriu, fshihet një njeri, dhe pas çdo dosjeje ka një jetë. Edhe çdo veprim, të cilin nuk e kryejmë si duhet, atëherë e presim edhe një tragjedi tjetër.

Është shumë e rëndësishme t'i mbështesim këto familje. Ngushëllime për familjen e Arlindës dhe të gjitha viktimave që kemi pasur deri tash. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Qeverisë ftoj zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme, zonjën Donika Gërvalla-Schwarz.

MINISTRJA DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Shumë të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Vrasja e Arlinda Zekajt e ka tronditur thellë Kosovën dhe disi ta vërteton shprehjen që veç një burrë i lig e ngre dorën dhe vret ose rreh një grua. Vret një nënë, një motër e një vajzë tonën pa fije mëshire, duke ia marrë jetën mizorisht asaj dhe duke ua ndryshuar përgjithmonë rrjedhën e jetës më të afërmve të saj, vetëm një burrë i lig.

Në cilësinë time si Koordinatore Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, më lejoni të shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për familjen, të afërmit dhe të gjithë ata që janë prekur nga kjo humbje tragjike. Ngushëllimet, sado të sinqerta, nuk mjaftojnë. Përgjegjësia jonë është të veprojmë, aq më tepër që vrasësi ende është në arrati. Krimi brutal i mbrëmshëm, vrasja e një tjetër gruaje, na rikthen doemos te pyetja më thelbësore rreth drejtësisë: A po bëjmë gjithçka që dhuna të parandalohet dhe jeta të mbrohet?

Të nderuar deputetë,
Kur një grua humb jetën pasi ka kërkuar ndihmë dhe mbrojtje, ne kemi detyrimin të shqyrtojmë jo vetëm krimin që u krye, por edhe të gjitha rrethanat që i paraprijnë atij. Kjo nuk do të thotë të paragjykojmë përgjegjësinë e askujt, do të thotë të kërkojmë fakte, hetim dhe veprime të matshme, ndërsa dështimet institucionale, nëse ka pasur të tilla, duhet të kenë pasoja. Shumë fuqishëm e mbështes kërkesën e Kuvendit për një hetim parlamentar, duke ju siguruar që Zyra e Koordinatores Kombëtar dhe Ministria e Drejtësisë do të bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin kudo që një gjë e tillë do të kërkohet nga ne. Para së gjithash, duhet të kuptojmë se çfarë ka ndodhur, çfarë informacioni kanë pasur institucionet, si është vlerësuar rreziku, cilat masa janë ndërmarrë dhe nëse janë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së viktimës. Këto pyetje kërkojnë përgjigje të bazuara në fakte, dokumentacion dhe përgjegjësi institucionale.

Pikërisht për këtë arsye, reagimi ynë nuk duhet të jetë i kufizuar në deklarata publike. Menjëherë pas rastit, në cilësinë time si Koordinatore Kombëtare kam kërkuar informacion zyrtar nga Policia e Kosovës me qëllim të sqarimit të rrethanave të rastit dhe të veprimeve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse, përfshirë trajtimin e mundshëm të raportimeve të mëparshme. Po ashtu, në një takim të jashtëzakonshëm ndërinstitucional, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Xhelal Sveçla dhe ministrin për Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare, zotin Andin Hoti, kemi takuar përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të Qendrave për Punë Sociale, të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe të Zyrës së Kryeministrit, dhe kemi kërkuar që urgjentisht secili në fushëveprimin e vet të verifikojë faktet dhe detajet.

Të them të drejtën, nuk dolëm nga ky takim me ndjenjën që institucionet e thirrura për të mbrojtur Arlindën nga dhuna e kanë kryer në plotëni detyrën e tyre konform ligjit dhe përgjegjësive të tyre.

Shumë të nderuar deputetë,
Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore përcakton qartë kornizën ligjore për mbrojtjen e viktimave dhe reagimin institucional. Por, mbrojtja reale bëhet vetëm kur dispozitat zbatohen me kohë, kur institucionet

komunikojnë me njëra-tjetrën dhe kur rreziku vlerësohet mbi bazën e fakteve, pa lëshime të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Policia e Kosovës ka rol thelbësor në pranimin dhe dokumentimin e raportimit, vlerësimin e rrezikut dhe ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme brenda kompetencave të saj. Prokuroria e Shtetit ka përgjegjësinë për trajtimin e dyshimeve për vepra penale dhe ndërmarrjen e veprimeve procedurale në përputhje me ligjin. Gjykatat vendosin për kërkesat për masa mbrojtëse dhe për çështjet penale brenda kompetencave të tyre. Mbrojtësit e viktimave dhe Qendrat për Punë Sociale kanë rol të rëndësishëm në informimin, mbështetjen dhe adresimin e nevojave për mbrojtje të viktimave dhe, kur është e nevojshme, të fëmijëve.

Këto nuk janë detyra të shkëputura nga njëra-tjetra. Ato përbëjnë një zinxhir të mbrojtjes, në të cilin informacioni duhet të përcillet, rreziku duhet të rivlerësohet kur ndryshojnë rrethanat dhe veprimet e secilit institucion duhet të jenë të qarta e të dokumentuara. Nëse një hallkë nuk funksionon, pasojat mund të jenë të rënda. Dhe prandaj konsideroj se duhet të ndërmarrim hapa konkretë në disa drejtime:

- Së pari, shqyrtimi i plotë i rastit të Arlinda Zekajt, i cili do të sigurojë një kronologji të dokumentuar të trajtimit të të gjitha rasteve të saj, duke përfshirë raportimet, kërkesat, vlerësimet e rrezikut, vendimet e marra, masat e shqyrtuara dhe komunikimin ndërmjet institucioneve. Ky shqyrtim duhet të identifikojë qartë se çfarë dhe kur është bërë apo nuk është bërë, mbi çfarë baze është marrë secili vendim dhe nëse ka pasur mangësi që kërkojnë trajtim të mëtejshëm.

- Së dyti, rishikimi urgjent i rasteve aktive me rrezik të lartë. Kam kërkuar po ashtu që institucionet kompetente të ndërmarrin një rishikim urgjent të rasteve aktive të dhunës në familje të vlerësuara me rrezik të lartë, me qëllim identifikimin e viktimave që mund të kenë nevojë për masa shtesë ose ndërhyrje të menjëhershme. Prioritet duhet t'u jepet rasteve ku ka kërcënime serioze ndaj jetës ose integritetit fizik, dhunë të përsëritur apo përshkallëzim të saj, raportime të përsëritura nga viktima, dyshime për shkelje të urdhrave mbrojtës dhe situata ku ekziston informacion për rrezik të shtuar.

Ky proces nuk guxon të mbetet një punë administrative, por duhet të çojë në rivlerësim të rrezikut, përcaktim të qartë të përgjegjësive dhe ndërmarrje të masave të nevojshme brenda kompetencave ligjore të secilit institucion.

- Së treti: Forcimi i koordinimit ndërinstitucional. Po ashtu, kam kërkuar përgjigje të qarta për mënyrën e shkëmbimit të informacionit, njoftimin për ndryshimin e nivelit të rrezikut, përcaktimin e përgjegjësisë për veprimet e mëtejshme dhe ndjekjen e zbatimit të masave mbrojtëse mes institucioneve të policisë, prokurorisë, gjykatave, mbrojtësve të viktimave e Qendrave për Punë Sociale.

- Së katërti: Një mekanizëm sistematik për analizimin e vrasjeve të grave. Qëllimi nuk është vetëm numërimi i viktimave, por identifikimi i modeleve të përsëritura, i mundësive të humbura për parandalim dhe i ndryshimeve që nevojiten në politikat dhe praktikat institucionale.

Dua të theksoj qartë një parim: kërkesa për llogaridhënie nuk është sulm ndaj institucioneve e as ndaj pavarësisë së tyre. Përkundrazi, është kusht për funksionimin efikas të tyre. Përgjegjësia duhet të përcaktohet mbi bazën e fakteve, dhe aty ku faktet evidentojnë shkelje, duhet të ndërmerren veprime përkatëse ligjore dhe disiplinore. Nuk mund t'i kërkojmë një gruaje të raportojë dhunën, e pastaj të mos sigurohemi që raportimi i saj të trajtohet me seriozitetin e duhur. Nuk mund t'i thoshim një viktime se ligji e mbron nëse nuk bëjmë gjithçka që kërkohet për ta bërë reale atë mbrojtje. Sot nuk mjafton të shprehim trishtimin tonë, ne duhet të veprojmë dhe të sigurohemi që masat e ndërmarra të japin rezultat. Andaj, u bëj thirrje institucioneve kompetente edhe nga kjo foltore që të veprojnë me urgjencë dhe përgjegjësi. Mbrojtja e jetës është detyrim institucional dhe shoqëror, dhe ky detyrim duhet të dëshmohet me veprime, jo vetëm me fjalë.

Nuk dua të përsëris atë që tashmë e vuri në pah kryetarja e Kuvendit, zonja Albulena Haxhiu, jo vetëm rreth Ligjit të ri për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Nuk dua të përsëris mekanizmat e rinj të krijuar. Dua të them që ligji është, procedurat janë të qarta. Këtu shtrohet pyetja se kush nuk u soll konform tyre? Kush dhe pse nuk iu përmbajt ligjit dhe procedurave, të cilat janë shumë të qarta. Dhe të jeni të sigurt që përgjegjësit do të japin përgjegjësi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministre! Tani është radha sërish te grupet parlamentare. Vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje. Ftoj deputeten Arijeta Rexhepi.

ARIJETA REXHEPI: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar të pranishëm,
Të dashur qytetarë.
Mbrëmë në Pejë ndodhi edhe një vrasje e një gruaje, edhe një jetë e humbur, edhe një familje e shkatërruar, edhe një plagë tjetër e rëndë në ndërgjegjen e shoqërisë sonë. Dhe fatkeqësisht nuk po flasim për një rast të izoluar, po flasim për një fenomen të tmerrshëm që po përsëritet dhe që, sa herë ndodh, na përball me të njëjtën pyetje: A po bëjmë mjaftueshëm për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat tona?

Sot nuk dua të flas vetëm si deputete e Kuvendit të Kosovës, dua të flas si grua, si nënë. Dua të flas si një njeri që nuk mund ta pranojë si normale një shoqëri ku gratë humbin jetën nga dhuna, ku vajzat mund të mos kthehen më në shtëpinë e tyre dhe ku fëmijët mbesin pa nënat e tyre. Asnjë grua nuk duhet të paguajë me jetën e saj. Asnjë fëmijë nuk duhet të rritet pa nënën e tij, sepse institucionet nuk arritën ta mbrojnë atë.

Të nderuar deputetë,
Kur ndodh një vrasje e tillë, nuk mjafton të shprehim keqardhje. Nuk mjafton ta dënojmë rastin, nuk mjafton ta publikojmë një reagim dhe pas disa ditësh të vazhdojmë sikur nuk ka ndodhur asgjë. Dhuna ndaj grave dhe femicidi nuk mund të trajtohen vetëm si çështje e një dite, si temë e një debati apo si reagim pas një tragjedie. Ato duhet të jenë pjesë e pandashme e agjendës sonë institucionale dhe politike, sepse çdo rast i tillë na kujton se pas statistikave ka emra, fytyra, familje, ëndrra dhe jetë të ndërprera padrejtësisht. Nuk duhet të ketë më prindër që, sa herë vajzat e tyre dalin nga shtëpia, jetojnë me frikën nëse do të kthehen të sigurta. Nuk duhet të ketë më gra që ndihen të vetmuara përballë kërcënimeve. Nuk duhet të ketë më fëmijë që mbesin jetimë kur dhuna mund të ishte parandaluar. Siguria e një gruaje nuk është privilegj, është e drejtë themelore, dhe mbrojtja e jetës së saj nuk është çështje vullneti institucional, por detyrim.

Prandaj, sot duhet të flasim edhe për përgjegjësitë institucionale. Ligjet janë të domosdoshme, por vetëm ligjet nuk mjaftojnë. Nuk mjafton të kemi mekanizma mbrojtës në letër nëse ato nuk funksionojnë në praktikë. Nuk mjafton të kemi procedura nëse ato nuk zbatohen në kohën e duhur. Nuk mjafton që institucionet të reagojnë pasi një grua e ka humbur jetën. Institucionet duhet të veprojnë para se të jetë tepër vonë.

Dhe kur nuk veprojmë, kur i neglizhojmë rastet, kur nuk i trajtojmë seriozisht kërcënimet dhe kur nuk i zbatojnë detyrat e tyre ligjore, duhet të ketë përgjegjësi. Përgjegjësia nuk mund të përfundojë te një deklaratë zyrtare. Ajo duhet të çojë në hetim, në konstatim të fakteve dhe, kur të vërtetohen shkeljet, në masa konkrete ndaj përgjegjësve.

Pikërisht për këtë arsye kërkoj që rasti i fundit në Pejë të hetohet në tërësi dhe me seriozitetin më të lartë. Duhet të marrim përgjigje për pyetjet që sot na shqetësojnë të gjithëve: A janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e Arlindës? A janë trajtuar me seriozitet të gjitha kërkesat, denoncimet apo paralajmërimet që mund t’u jenë drejtuar institucioneve? A ka pasur neglizhencë, vonesë apo shkelje në trajtimin e rastit? A janë shqyrtuar të gjitha dokumentet dhe komunikimet e dorëzuara në institucionet përkatëse, si dhe komunikimet me avokaten e saj, nëse ato lidhen me kërkesën për mbrojtje?

Këto nuk janë pyetje që duhet të mbeten pa përgjigje. Janë pyetje që kërkojnë një hetim të plotë, të paanshëm dhe transparent, duke respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e të gjitha palëve. Ne nuk mund të paragjykojmë rezultatet e hetimeve, por as nuk mund të pranojmë që dyshimet për mosveprim institucional të kalojnë pa u shqyrtuar. Nëse ka pasur dështime, ato duhet të identifikohen. Nëse ka pasur shkelje, ato duhet të trajtohen sipas ligjit. Nëse dikush nuk e ka kryer detyrën e vet, pozita e tij nuk mund të jetë mburojë ndaj përgjegjësisë. Vrasësit kanë emër dhe mbiemër, por edhe përgjegjësia institucionale duhet të ketë emër, mbiemër dhe pasoja ligjore kur vërtetohet se ka pasur neglizhencë apo shkelje të detyrës.

Të nderuar deputetë,
Kjo çështje nuk duhet të na ndajë politikisht. Kjo çështje kërkon përgjegjësi të përbashkët dhe veprim konkret nga të gjitha institucionet. Duhet të forcojmë mekanizmat e mbrojtjes për gratë që përjetojnë dhunë. Duhet të sigurojmë që çdo denoncim të trajtohet me seriozitet. Duhet të kemi koordinim më të mirë ndërmjet policisë, prokurorisë, gjykatësve dhe shërbimeve sociale. Duhet të monitorohet zbatimi i masave mbrojtëse dhe të sigurohet që gratë në rrezik të mos mbeten vetëm përballë dhunuesve të tyre.

Po ashtu, duhet të ketë vlerësim të rregullt të rasteve kur institucionet kanë dështuar, në mënyrë që gabimet të mos përsëriten dhe përgjegjësia të mos mbetet vetëm në nivel deklarativ. Sepse, një institucion që merr seriozisht jetën e qytetarëve të tij, nuk matet vetëm me ligjet që janë në letër, por me zbatimin e tyre. Dhe një shoqëri që pretendon se respekton gratë, nuk mund të heshtë përballë dhunuesve ndaj tyre.

Të dashur qytetarë,
Arlinda nuk duhet të jetë vetëm emri i radhës i një lajmi tragjik. Vdekja e saj duhet të na detyrojë të reflektojmë, por mbi të gjitha të veprojmë. Nuk duhet të presim viktimën e radhës për të kuptuar se sa urgjente është kjo çështje. Nuk duhet të presim një familje tjetër të shkatërruar për të kërkuar përgjegjësi dhe nuk duhet të presim një tjetër fëmijë pa nënë për të kuptuar se fjalët pa veprime nuk e shpëtojnë askënd.

Sot kërkoj drejtësi për Arlindën. Kërkoj hetim të plotë për çdo rrethanë të rastit të saj. Kërkoj përgjegjësi për çdo shkelje që mund të konstatohet dhe kërkoj që lufta kundër femicidit të mos mbetet vetëm zotim politik, por të shndërrohet në prioritet të përditshëm institucional. Të mos harrojmë se pas çdo rasti të dhunës ekziston një mundësi për të ndërhyrë, për të mbrojtur dhe për të shpëtuar një jetë. Detyra jonë është të sigurohemi që institucionet të mos e humbin atë mundësi. Prandaj, asnjë grua më pak, asnjë viktimë më shumë, asnjë neglizhencë pa u hetuar, asnjë përgjegjësi pa u adresuar. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë, qenka zonja Deliu-Kodra, sepse zonja Hoxha tha që vetëm ajo do të flasë. Po, urdhëroni zonja. Po, po, patjetër, vetëm se u bazova në atë çfarë zonja Hoxha tha. Urdhëroni!

BLERTA DELIU-KODRA: Zonja kryetare e Kuvendit,
Po, kishim një dakordim që e tha me të drejtë zonja Hoxha, që nuk do të flisnim. Megjithatë, nuk e mendoj që mund të qëndrojmë të heshtur karshi deklarimit të ministres, sepse përtej deklaratave të një zonje që është në krye të një strategjie e cila do duhej ta luftonte edhe femicidin, edhe dhunën, edhe raste të cilat i përsëritim e i numërojmë këtu secili, unë dhe ju bashkë, mendoj që duhet të jemi pak më të përgjegjshëm.

Nëse një zonjë nuk jeton më dhe ka kërkuar përgjegjësi prej shtetit, a mjaftojnë një minutë heshtje, këto deklarimet e mia e të juaja, të secilit prej nesh këtu, që duhet ta dënojmë dhunën? A është ky një normalizim i asaj që po ndodh në Republikën e Kosovës? A e dini çfarë i bie kjo? Operacioni tha u krye me sukses, pacienti vdiq.

95 raste të grave u lexuan nga e para e Kuvendit, vdekje të cilat e kanë përcjellë shoqërinë kosovare nga vrasës të cilët nuk janë dekurajuar prej fjalimeve tona, nuk janë ndier të kërcënuar prej fjalimeve në këtë Kuvend. A ka shtet këtu kolegë deputetë? A ka Kosova institucione apo ne ende duhet të thirremi në procedura, në ligje, se qenka një strategji që ka dështuar, por që ende është funksionale, që ka ligje të cilat nuk po zbatohen e sa herë e kemi thënë këtë gjë.

Me mijëra herë kemi folur për dështimin e atyre që janë të thirrur për ta respektuar legjislacionin në fuqi. Dhe, nëse diçka e tha në letrën e saj Arlinda e ndjerë, tashmë e tha: Nuk e di si do ta bëni ju gjumin, a do të mund të flini të qetë?

Edhe unë sot ju pyes juve, përfaqësues të Qeverisë, bashkë me veten dhe kolegët e mi: A do ta bëjmë ne gjumin e qetë deri në vrasjen tjetër? A do të dalim pas një vrasje tjetër të thërrasim prapë seanca plenare, prapë të vajtojmë siç po bëj dhe unë sot e pastaj të themi që e kemi kryer detyrën tonë. Mjaft është! Dhe, për besë, mua më vjen marre prej këtij fjalimi tim sot në këtë Kuvend, sepse është paturpësi e madhe, dikush që e ka gjithë mundësinë të shprehë vullnetin, dikush duhet të dorëhiqet. Dikush duhet të japë përgjegjësi. Nuk duhet të thirremi më në procedura në ligje e ta vajtojmë Arlindën e ndjerë deri në viktimën tjetër.

Zonja ministre, e keni përgjegjësinë! Do të ftohen në komision edhe Këshilli Prokurorial, edhe Këshilli Gjyqësor. Po ka edhe prokurore e kryeprokurore që e kanë pasur rastin e saj.

Nuk guxojmë të sillemi me nonshalancën që po silleni ju sot.

Një grua e ka lënë fëmijën e saj jetim. Shteti ka dështuar ta mbrojë dhe shteti është koncept i përgjithshëm. Në shtet ka mekanizma, të cilët secili prej tyre, duhet të marrë burgun, e të mos flasim ne këtu secili, edhe unë dokrra sot, se paska dështuar të zbatohet një ligj. Kjo është keq zonja ministre!

KRYETARJA: Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të LDK-së. Sipas radhës, ju lutem! Zoti Gashi, urdhëroni!

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Rasti i dhimbshëm dhe i dhimbjes të pafundmë në Kosovë mbi vrasjen e grave dhe vajzave është një rast që duhet të na shqetësojë dhe duhet të na bashkojë.

E dëgjova secilin fjalim me vëmendje absolute. Diçka që jo rrallë dëgjohet në Kuvendin e Kosovës, por ajo që po dëgjoj nuk po më jap shpresë për fat të keq. Vazhdon të më shqetësoj, sepse nuk ka vizion.

Po flitet për pasojat, po flitet për ndëshkimet, po flitet për hetimet, por nuk u fol për parandalimin.

Ne, në këtë Kuvend këtu, shumë herë kemi diskutuar, shumë herë kemi debatuar për çështje që pajtohemi e nuk pajtohemi, por institucionet kanë memorie, kanë përgjegjësi dhe kanë llogaridhënie.

Hyra dhe e pashë çka ka ndodhur këto pesë-gjashtë vitet e fundit në aspektin e parandalimit të dhunës në familje. E pashë që në vitin 2022 është hartuar një Strategji për parandalimin e dhunës në familje, e cila vlen 2022-2026. E pashë që në vitin 2023 është hartuar Ligji për parandalimin e dhunës familje. E pashë që në vitin 2023 është ndryshuar Kodi Penal për kriminalizimin dhe rritjen e ndëshkimeve për parandalimin e dhunës familje. E pashë që në vitin 2023 është ndryshuar Kodi i Procedurës Penale për aspektet e parandalimit të dhunës familje, por edhe mu kujtua se këtu në këtë sallë e kemi diskutuar kur janë bërë gjithë këto ndryshime se nuk ka një qasje holistike, se qasja është e gabuar. A e dini cili është rezultati mbas të gjitha këtyre ndryshimeve, strategjisë dhe tri-katër ligjeve? Nga një ose dy raste në vit, tetë raste deri tash sivjet. Tetë raste deri tash.

Çarë ka ndodhur? A janë bërë ligjet gabim, është bërë strategjia gabim, janë bërë ndryshimet gabim? Pse? Mbas të gjitha këtyre ndryshimeve, rriten rastet. Pra, nuk ka sistem efikas! Nuk janë marrë me qasje sistemore.

Më kujtohet kur e kemi diskutuar këtu në këtë parlament, kam qenë kryetar i grupit; kam thënë se nuk ka qasje sistemore dhe po bëhet, mënyra se si po rriten masat, mund të jenë edhe kundërproduktive dhe problematike. Më thanë, po e stimulon dhunën në familje. Qe ku i keni pasojat!

Prandaj, që të mos merremi me akuza e kundërakuza, se janë kundërproduktive; të mos merremi vetëm me pjesën ndëshkimore, sepse atje një kriminel i cili e ka vrarë një grua do të shkojë në burg. Patjetër që shteti në 20-30 vitet e ardhshme do të kujdeset për të që ta mbajë në burg, t'ia çojë doktorin e psikologun, ta ushqejë. Një fëmijë është jetim, një grua është varrosur, një familje është shkatërruar, një opinion i tërë është terrorizuar dhe është ndërtuar një model dhe po

ushqehet modeli i dhunës. Këto janë probleme madhore! Prandaj, ne duhet të merremi me tema përmbajtjesore.

Tema përmbajtjesore në këtë rast është parandalimi. Çka po bëjmë ne për parandalim? Meqenëse jemi te parandalimi, unë si deputet i Kuvendit të Republikës propozoj veprime konkrete.

E pashë një rezolutë që është propozuar. E pashë edhe një komision hetimor që është propozuar. Çka doni të hetoni? Njerëzit janë vdekur. Prokuroria do ta marrë rastin, do ta gjykojë, do ta dënojë, pak më shumë apo pak më pak. Problemi është te parandalimi. Unë propozoj që të ndërtohet, meqenëse problemi është madhor, të ndërtohet sistem. Një institucion që mund të quhet agjenci apo sido që të quhet, agjenci shtetërore për parandalimin e dhunës në familje dhe të ketë disa shtylla. Shtylla e parë duhet të jetë edukimi. Kur flas për edukimin, e kam fjalën për gjithëpërfshirjen në edukim, duke filluar nga familja, nga shkolla, duke edukuar policë që merren me këto raste, gjyqtarë, prokurorë, janë të paedukuar edhe gjyqtarët edhe prokurorët për këto tema. Janë tema shumë komplekse dhe shumë të ndjeshme.

Gjyqtarë, prokurorë, policë, hetues, të gjithë janë të paedukuar; si shoqëri jemi të paedukuar për këtë çështje. Prandaj, na u duhet një koncept i edukimit për këto tema.

E dyta, duhet të merret, të ndërtohet një komponent i kësaj agjencie që merret me trajtimin, trajtimin psikologjik, trajtimin social, trajtimin ekonomik të viktimave. Dhe e treta, që mendoj se është më e rëndësishmja, me ligj duhet ta sanksionojmë me ligj dhe t'i japim kompetencë gjykatës që me automatizëm, në momentin kur raportohet një rast dhune në familje, viktima e dhunës së bashku me fëmijët duhet të largohet nga ai ambient familjar, duhet të strehohet në ambient të sigurt.

Unë e di se tash dikush thotë jo po duhet ndërtuar qendra sociale, duhet shpallur tenderë, edhe 10 vjet derisa të ndërtohet. Jo, jo! Duhet qasje urgjente dhe agjencia duhet të menaxhojë në tërë territorin e Kosovës, t'i ngrejë kapacitetet edhe në komuna. Nuk kanë kapacitete komunat e Kosovës. Nuk kanë kapacitete! Me mijëra shtëpi janë të pabanuara në Kosovë, me mijëra. Vetëm në Komunën e Istogut për shembull, në regjistrimin e fundit të popullsisë, rreth 40 për qind e ambienteve të banimit janë të pabanuara.

Agjencia në bashkëpunim me komunat duhet të identifikojë këto objekte, t'i marrë me qira afatgjate dhe në momentin kur ka një rast të dhunës familje, komplet gruaja në këtë rast, sepse kryesisht është gruaja viktimë, së bashku me fëmijët zhvendoset në ambientin e ri. I jepet siguri fizike, i jepet siguri ekonomike, i jepet ndihmë sociale, i jepet ndihmë psikologjike dhe parandalohet.

Çfarë çmendurie! Në rastin konkret që po flasim sot, gjyqtari urdhëron që të bashkëjetojnë në një shtëpi dhe i thotë të mos i afrohet më shumë se dy metra. Kjo është çmenduri. Po duhet larguar edhe prej asaj komune, prej atij territori. Rast i rëndë në Pejë, dërgohet në Viti, dërgohet në Gjilan, për t'u garantuar jeta, trupi dhe shëndeti, shëndeti fizik dhe shëndeti emocional. Na duhet një qasje gjithëpërfshirëse!

Pra, nuk është ndëshkimi në vetvete ajo që e parandalon. Nga duhet sistem parandalimi. Sistem efikas i ndërtuar mirë, i menduar mirë, ku përfshin edukim, trajtim dhe rehabilitim. Pra duhet, me automatizëm, në momentin kur raportohet një ngjarje dhune në familje, të ndahen, të largohen fizikisht. Momenti kur janë fizikisht afër në një objekt banimi, çka presim ne? Çka presim? Konflikti vazhdon, dhuna vazhdon, veç vdekja e ndan atë punë.

Prandaj, ne si deputetë kemi përgjegjësi të marrim detyrën tonë. Qeveria normalisht që duhet ta shikojë me urgjencë krijimin e një agjencie, sepse është bërë pandemike, dhuna në familje dhe vrasjet janë bërë pandemike dhe dëmi është afatgjatë.

Përveç te viktima, është edhe te familjarët, te fëmijët. Fëmijët është cikël i dhunës. Janë studime sociologjike dhe psikologjike. Si një cikël i dhunës për t'u ndërprerë duhen të paktën dy gjenerata. Neve na duhet të investojmë në këtë punë.

Prandaj, meqenëse sistemi i ndëshkimit nuk po funksionon, na duhet të rritim kapacitetet e parandalimit. Dhe kapacitetet e parandalimit duhet rritur me një qasje gjithëpërfshirëse nga institucionet qendrore, ku përfshin, edhe njëherë po e përsëris, edukimin për policë, prokurorë, gjyqtarë, hetues, nëpër shkolla, nëpër familje e kudo, për trajtimin psikologjik, emocional e social dhe kapacitetet ligjore ku çdo rast i dhunës i cili lajmërohet në institucione, me automatizëm ndahet familja, personat që janë subjekt i dhunës çohen në vende të sigurta dhe fillon një jetë e re për ta, ku përfshihet edhe integrimi në shoqëri, edhe integrimi me automatizëm nëpër shkolla të fëmijëve etj.

Pra, na duhet urgjentisht të veprojmë, sepse kjo është bërë tepër. Çka është tepër, është tepër! Mos e merrni si akuzë për një qeveri ose një qeveri tjetër; jo e bëri ky, s'e bëri ai. Jemi ku jemi! Masat e rritura ndëshkimore të qeverisë së kaluar, siç po shihet, kanë dhënë kundërefekt, nga një-dy raste në vit, deri tash, vetëm sivjet i kemi tetë raste.

Pra, na duhet sistem parandalimi i cili merret në mënyrë detajuar me këtë punë dhe ngrit kapacitetet si në nivel qendror edhe në nivel lokal. Sepse, ka komuna që as nuk e kanë idenë çka janë këto punë. Komuna të vogla nuk i kanë kapacitetet as njerëzore as intelektuale, të them të drejtën, që të merren me këto tema. Prandaj, duhet qasje prej lart, e cila rregullohet me ligj dhe një agjenci, e cila mendon në mënyrë të vazhdueshme për këto tema. Faleminderit!

Ngushëllime familjes dhe të gjithë juve, sepse është një temë shumë e ndjeshme.

KRYETARJA: Faleminderit, z. Gashi! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të Aleancës. Deputetja Albana Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, kryetare!
Të dashur kolegë deputetë,
Qytetarë të Kosovës,
Qeveri,
Media,
Është mjaft e rëndë që të flasim për një temë kaq të ndjeshme, ku përgjegjësia buron brenda Qeverisë.
Ju lutem, gratë që vriten ndërsa shteti i Kosovës po fle dhe po bëhet bashkautor në heshtje i këtij krimi, i cili ka shpërthyer viteve të fundit. Pra, edhe njëherë, sot ky pushtet po fle dhe po i vret në heshtje. Nuk ka ndjenjë më të keqe që në njërën anë të themi që në shtetin tonë gratë po vriten, po dhunohen e keqtrajtohen vazhdimisht.

Ndërsa, në anën tjetër të kujtojmë që këto gra janë pasardhëse e trungut të grave heroina që dhanë shumë për familjen, shtetin e shoqërinë në të gjitha etapat e historisë së Kosovës. Sot, nëse do të ishte koha për mburrje e do të flisnim për emrat e personaliteteve gra si Dua Lipa, Rita Ora e shumë gra të tjera të suksesshme, do të shihnim Qeverinë që do të dilte me krenarinë më të madhe të na shiste moral për sukseset e vajzave, grave të shtetit tonë.

Ndërsa sot, kur flasim për temën e vrasjeve, keqtrajtimeve dhe dhunës së vazhdueshme ndaj grave, i njëjti pushtet na moralizon dhe vetëmbrohet për situatën pa zgjidhje e pa veprime institucionale. Nuk ka turp më të madh për institucionet e shtetit tonë, Ministrinë e Brendshme dhe të Drejtësisë të Qeverisë Kurti, që në vitin 2026 të lejojmë barbarizëm, dhunë e vrasje sistematike ndaj grave në Kosovë.

Kjo vrasje e ndodhur dje dhe dhjetëra të tjera në vitet e fundit janë alarm frike për çdo familje e çdo grua në vendin tonë. Prandaj është urgjencë kombëtare të bëjmë zgjidhje e ndëshkime institucionale. Një ministër i Brendshëm dhe një ministre e Drejtësisë që kanë moral e ndjenjë njeriu duhet me automatizëm të shkarkojnë e ndëshkojnë gjithë zinxhirin përgjegjës për këtë gabim që kushtoi me një jetë njeriu e vuajtje të rëndë familjare e shoqërore.

Dhe krejt në fund, ministrat përgjegjës në shenjë solidarizimi duhet të japin dorëheqje, siç japin ministrat e tjerë në shtetet ku demokracia funksionon normalisht.

Në ditët që jetojmë, shtetet e Evropës dhe të botës perëndimore në mënyrën më të mirë kanë arritur të bëjnë bashkimin dhe mbrojtjen e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe statusi.

Ndërsa, Kosova tani e 28 vjet ende s'ka filluar përpjekje praktike për mbrojtje, barazi, paqe e drejtësi ndaj grave.

Andaj, sot duhet t'i themi stop faktit që gratë vriten e kryesit e veprave të dënohen barabartë me një kryes të veprës së vjedhjes. Ne jemi këtu që të jemi zëri i qindra grave të tjera në Kosovë që sot janë në gjendje dhune në familje me mundësi epilogu deri në vrasje, sikurse të gjitha rastet e tjera të deritanishme.

Kërkojmë mbrojtje, të drejta e liri për gratë në Kosovë. E dëgjova sot ministren e Drejtësisë, që është edhe koordinatore kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, një fjali mbi 10-minutëshe, dhe ende ministrja po dyshon se a ka pasur dështime të institucioneve. Po, ministre, ke pasur!

Dhe sot këtu i bëj thirrje ministres së Drejtësisë, e cila është edhe koordinatore kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje, çohu e jep dorëheqje, sepse ti nuk e meriton të jesh në atë karrige e ulur.

KRYETARJA: Vazhdojmë me Grupin Parlamentar Multietnik. Nënkryetarja Emilija Rexhepi!

EMILIJA REDŽEPI: Poštovana predsednice Skupštine!
Uvaženi premijeru Vlade,
Poštovani ministri,
Uvažene kolege i koleginice,
Poštovani građani Republike Kosovo,
Danas se obračam ovoj Skupštini sa dubokom tugom i zabrinutošću zbog još jednog izgubljenog života žene koja je morala biti zaštićena. Nažalost, još jedna naša žena je ubijena. Još jedna porodica je zavijena u crno. Još jedan život je nepovratno ugašen.

Ubistvo u Vitomirici kod Peći posebno je potresno. Prema dostupnim informacijama, žrtva se samo tri dana ranije obratila nadležnom tužilaštvu, zahtevajući hitno postupanje. Na dan ubistva, prijavila je nasilje u porodici, a svega nekoliko sati kasnije, brutalno je ubijena.

Dame i gospodo,
Posebno zabrinjava podatak da je tokom ove godine na Kosovu, u nasilnim okolnostima, život izgubilo osam naših žena, dok su samo tokom oktobra zabeležena tri smrtna slućaja.

I za svih ovih brojki stoje ljudski životi, to nije samo obična cifra. Stoje porodice i stoje veliki gubici.

Zato zahtevam nezavisno preispitivanje postupanja nadležnih organa i utvrđivanje eventualne odgovornosti za institucionalnim i moguče propuste. Ženama nisu potrebna samo saopštenja nakon tragedije, potrebna im je delotvorna zaštita dok su žive.

Ubistvima žena često prethode pretnje, zastrašujuće i dugotrajno nasilje, zato su neophodni pravovremena procena rizika, hitne mere i zaštita i dosledno postupanje po svakoj prijavi nasilja u porodici.

Međutim, nasilje ne možemo sprečiti isključivo krivopravničkim merama, neophodno je menjati i društvenu svest naših građana kao i edukaciju. Na javnom servisu Radio Televizije Kosova kao i na brojnim privatnim televizijama, značajan deo programa posvećen je političkim debatama i raznim analizama pojedinaca, dok su edukativni sadržaji o upravima žena, rodnoj ravnopravnosti i prevenciji nasilja nedovoljno zastupljeni.

Mladu generaciju od najranijeg uzrasta možemo učiti i moramo učiti poštovanju ljudskih prava, dostojanstva i ravnopravnosti, pre svega u porodici, zatim kroz obrazovni školski sistem, društvenu sredinu i kasnije u institucijama i raznim okruženjima.

Dame i gospodo,
Posebno zabrinjava širenje govora mržnje, pretnji i poziva na nasilje nad ženama putem društvenih mreža, što predstavlja ozbiljan i ozbiljnu opasnost za celokupnu našu državu.

Sloboda izražavanja ne može biti opravdanje za pretnje i podsticanje nasilja, čije posledice mogu biti kobne. Iz svih gore navedenih razloga, pozivam državno tužilaštvo da u skladu sa zakonom, po službenoj dužnosti postupa u slučajevima krivično-kažnjivih pretnji i podsticaja nasilja nad ženama.

Od Nezavisne Komisije za Medije očekujem dosledno sprovođenje zakonskih nadležnosti i izricanje odgovarajućih sankcija medijskim subjektima koji krše važeće propise, zato što javne osude objavljene na društvenim mrežama ne mogu biti zamena za konkretne institucionalne mere koje se trebaju preduzeti.

Poštovane koleginice i kolege,
Zaštita žena nije pitanje političke pripadnosti, nacionalnosti ili religije, to je pitanje osnovnih ljudskih prava, vladavine prava i odgovornosti naše države.

Mi ne smemo čekati novu žrtvu da bismo reagovali na neku prethodnu. Dužnost države ja i bezbednosnih i pravosudnih institucija nije samo da obezbede pravdu nakon tragedije kada se ona dogodi, već da preuzmu sve neophodne mere kako bi se takve tragedije u budućnosti sprečile.

I na samom kraju, dozvolite mi da svoje obraćanje završim jednom porukom.
Kada žena zatraži zaštitu, odgovor države mora biti sigurnost, a ne još jedno saučešće svih nas u ovoj sali. Hvala vam!

KRYETARJA: Faleminderit! Kryeministër!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: E nderuara kryetare e Kuvendit të Republikës, znj. Albulena Haxhiu!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,
Të dashur qytetarë,
Një bashkëqytetare e jona kërkoi, por nuk e mori mbrojtjen që i duhej për të mbetur gjallë. Arlinda Zekaj u vra dje. Vrasja mizore e Arlinda Sylaj-Zekaj është tejet tronditëse për të gjithë neve. Tri ditë para se të vritej, Arlinda i ishte drejtuar prokurorisë, duke paralajmëruar për rrezikun ndaj jetës së saj.

Këto rrethana kërkojnë hetim të plotë dhe të menjëhershëm, ndërkohë që dorasi është në arrati, pra ende nuk është i arrestuar. Prokuroria dhe institucionet përgjegjëse duhet të sqarojnë se si janë trajtuar denoncimet e saj, pse paralajmërimi për rrezikun ndaj jetës nuk është parandaluar me masa konkrete mbrojtëse dhe nëse ka pasur neglizhencë apo mosveprim nga zyrtarët përgjegjës.

Çdo shkelje duhet të zbardhet dhe çdo përgjegjësi të trajtohet sipas ligjit. Familjes së saj i shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Vrasja e saj na detyron të kërkojmë përgjegjësi në çdo hallkë institucionale dhe ta shqyrtojmë ndërgjegjen tonë shoqërore. Çfarë po mbrojmë kur në emër të familjes kërkojmë heshtjen e gruas? Kur në emër të nderit gjykojmë zgjedhjet e saj, kur durimin përballë dhunës ia njohim si virtyt, ndërsa kundërshtimin ia ngarkojmë si faj?

Një shoqëri nuk mund ta quajë vlerë atë që ruhet duke cenuar dinjitetin dhe jetën e një njeriu. E dënoj ashpër këtë krim. Për Arlindën kërkoj drejtësi dhe zbardhjen e çdo përgjegjësie. Nga të gjithë ne, kërkoj gatishmërinë për ta kundërshtuar atë mendësi që ende e mat vlerën e gruas me nënshtrimin e saj. Për ta kundërshtuar këtë mendësi duhet të jemi të qartë për atë që e bën një vlerë të denjë për t'u mbrojtur. Respekti për dinjitetin njerëzor. Familja, tradita dhe rendi shoqëror e humbin legjitimitetin moral kur përdoren për t'i kërkuar një njeriu të durojë poshtërimin. Asnjë gruaje nuk mund t'i kërkohet ta paguajë ruajtjen e tyre me heqjen dorë nga vetvetja. Dinjiteti i saj nuk varet nga bindja, durimi apo gatishmëria për sakrificë.

Ai i përket, i takon çdo qenieje njerëzore. Të duash veten të lirë do të thotë ta duash edhe tjetrin të lirë. Kjo kërkon që lirinë ta njohim edhe aty ku nuk e kontrollojmë përfundimin e saj. Një burrë që të drejtën për të vendosur e konsideron të natyrshme për veten, ndërsa te gruaja e trajton

si leje që mund t'ia japë ose t'ia tërheqë, e ka vendosur veten mbi të. Pikërisht këtë pabarazi duhet ta kundërshtojmë, pretendimin se njëri mund ta përcaktojë jetën e të dyve.

Gruaja ka një ekzistencë që nuk shterohet në rolet që kryhen për të tjerët. Ajo ka mendimin, ambiciet dhe të drejtën e saj për një jetë ku e njeh vetveten. Të qenët bashkëshorte, nënë apo bijë nuk ia zvogëlon këtë të drejtë dhe nuk ia kalon askujt autoritetin mbi trupin, ndërgjegjen apo të ardhmen e saj.

Afërsia krijon përgjegjësi ndaj saj, nuk krijon pushtet mbi të. Pranimi i kësaj barazie provohet kur gruaja kundërshton, kur kërkon ndryshim, kur refuzon ose vendos të largohet. Nëse liria njihet vetëm për aq kohë sa zgjedh atë që presim ne prej saj ose dikush tjetër veçmas prej saj, atëherë i kemi njohur vetëm hapësirën për t'u bindur ajo.

As zhgënjimi, as xhelozia dhe as ndjenja e refuzimit nuk e bëjnë legjitime përpjekjen për ta detyruar të qëndrojë. Askush nuk mund ta kërkojë vazhdimin e një marrëdhënieje duke ia mohuar tjetrit të drejtën për të dalë prej saj. Dhuna e vendos pikërisht këtë detyrim që gruaja ta organizojë jetën sipas frikës nga dhunuesi.

Kontrolli mbi paratë, punën, lëvizjen dhe lidhjet me familjen mund t'ia kufizojë gradualisht mundësinë për të vepruar. Kur çdo kundërshtim mund të pasohet nga kërcënimi, edhe heshtja bëhet mënyrë për t'u mbrojtur. Një institucion që nuk e kupton këtë rrethanë rrezikon ta interpretojë si pajtim atë që mund të jetë përpjekje për mbijetesë.

Dukuria e vrasjes së grave është pasojë e mendësisë së patriarkalizmit, që fatkeqësisht nuk i përjashton as institucionet, ku ushqen neglizhencën dhe mosveprimin përballë dhunës ndaj grave. Kjo është arsyeja pse kur të hetojmë, duhet t'i hetojmë edhe hetuesit. Kur të presim prej prokurorëve, do të na duhet t'i akuzojmë edhe ata.

E kur kemi të bëjmë me gjykatësit, do të na duhet të mendojmë edhe kush do t'i gjykojë ata. Sivjet janë vrarë tetë gra. Na duhet një debat publik për mënyrën se si shoqëria dhe shteti i trajton gratë që kërkojnë shkurorëzim, pavarësi dhe të drejtën e tyre në pronë e në trashëgimi. Për bindjen time të fuqishme, ky është thelbi.

Ne kemi një raport të vështirë me shkurorëzimin dhe me barazinë gjinore kur vjen puna te trashëgimia dhe pronësia. Duhet të flasim për mënyrën se si kërkesat legjitime të grave për të drejtat e tyre shndërrohen në burim konflikti. Si normalizohet kontrolli mbi jetën dhe vendimet e tyre dhe si, në vend që të mbështeten, ato shpesh lihen të përballen të vetme me dhunën dhe institucionet të cilët dështojnë t'i mbrojnë.

Prandaj, pyetja pse një grua nuk është larguar nuk mund të shtrohet duke shpërfillur atë që largimi do t'i kushtonte dhe mbrojtjen që do ta kishte në dispozicion. Qëndrimi, kthimi apo hezitimi për të denoncuar nuk ia kalojnë asaj përgjegjësinë për dhunën. Ato na obligojnë ta kuptojmë më mirë rrezikun dhe pengesat me të cilat përballet.

Përgjegjësia për dhunën mbetet tek ai që e ushtron. Përgjegjësia për mbrojtjen duhet të përmbushet nga institucionet që e kanë marrë përsipër. Këtu liria bëhet çështje konkrete e qeverisjes. Një gruaje nuk i mjafton t'i thuhet se ka të drejtë të largohet, nëse largimi e lë pa strehim, pa të ardhura dhe sërish të ekspozuar ndaj kërcënimit.

Njohja e së drejtës na obligon të krijojmë kushtet për ushtrimin e saj. Përndryshe, gruas i kërkojmë të bëjë e vetme atë që shteti me të gjitha kapacitetet e tij nuk ka arritur t'ia mundësojë. Për këtë arsye, punësimi, qasja në pronë dhe mbështetja ekonomike e grave kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për sigurinë dhe pavarësinë e tyre.

Të ardhurat e veta mund t'ia japin një gruaje mundësinë për të refuzuar një varësi që e mban të ekspozuar ndaj dhunës. Politikat që kemi ndërmarrë janë thelluar me këtë qëllim, që gratë të kenë mundësi reale për të vendosur dhe që nevoja për mbijetesë të mos i detyrojë të mbeten pranë personit i cili i rrezikon.

Të nderuar deputetë,
Pushteti për të gjykuar dhe për të ndjekur penalisht është një përgjegjësi publike e jashtëzakonshme. Shoqëria ua beson këtë autoritet njerëzve prej të cilëve pret zotësi profesionale, ndërgjegje morale dhe ndjenjën e nderit që buron nga shërbimi ndaj tjetrit. Pavarësia i mbron nga presioni dhe ndërhyrja.

Ushtrimi i saj i nënshtrohet ligjit dhe llogaridhënies. Askush nuk mund ta interpretojë pavarësinë si të drejtë për të mos dhënë përgjegjësi, ndërkohë që pasojat e neglizhencës i bart qytetari. Mandej, autoriteti publik kërkon përulësi përpara dinjitetit njerëzor dhe guxim për ta përmbushur detyrën edhe kur kjo sjell vështirësi, kërcënim apo rrezik personal.

Askush nuk është ulur në kolltukun e pushtetit që t'ia lejojë vetes ta presë një grua të dhunuar me pyetjen: çfarë i ke bërë burrit ashtu, zonjë?. Një pyetje e tillë e përdor autoritetin e shtetit për t'ia ngarkuar viktimës fajin e dhunuesit dhe për ta thelluar nënshtrimin prej të cilit ajo po kërkon të dalë. Gjyqtarit dhe prokurorit, shteti u ka besuar një pjesë të autoritetit të vet për të ndarë drejtësi. Duhet ta kuptojmë peshën e këtij besimi. Në ushtrimin e detyrës së tyre, vendimet mund të përcaktojnë nëse një person do të mbrohet nga dhuna apo do të ngelet i ekspozuar ndaj saj. Një përgjegjësi e këtillë kërkon përkushtim profesional, ndërgjegje morale dhe ndershmëri për t'u përballur me pasojat e veprimeve të veta.

Autoriteti, statusi dhe kompensimi që e shoqërojnë funksionin kanë kuptim vetëm në shërbim të kësaj detyre. Emërimi në drejtësi nuk të vendos mbi qytetarin, të ngarkon me përgjegjësi ta dëgjosh, ta mbrosh kur të kërkon, të vërtetosh provat dhe të sjellësh vendimin që mbi të gjitha mbron të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Aq shumë herë kam dëgjuar fjalët 'pavarësi e gjyqësorit', aq herë sa kam kritikuar apo komentuar çështje që lidhen me sistemin e drejtësisë. Të qenit i pavarur nga ndikimi i jashtëm nuk do të thotë që je i pavarur nga përgjegjësia, nga profesionalizmi, nga integriteti e urtësia që domosdo duhet të zotërosh si autoritet i sistemit të drejtësisë.

Në raste si ky kur viktima kërkon mbrojtjen, e ti nuk ia jep ankesës së saj të gjithë peshën e përgjegjësisë tënde ndaj pozitës, ndaj shtetit e ndaj vetvetes, gjithsesi ke dështuar. Aty ti e tregon sa i pavarur je dhe si vendos ti kur vjen puna që pozita jote të vijë në shprehje. Në drejtësi nuk ke fituar të drejtën të sillesh si sovran ndaj qytetarit. Të është besuar detyra t'i shërbesh ligjit që e mbron atë. Masa e denjësisë për funksionin që mban është serioziteti me të cilin e trajton jetën, sigurinë dhe dinjitetin e atij, të cilido që vjen para teje.

Të nderuar deputetë,
Prandaj, edhe unë i bashkëngjitem kësaj iniciative dhe propozoj dy ndërhyrje konkrete: të ngarkojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme që përmes strukturave kompetente të policisë të organizojë brenda 72 orëve rishikimin urgjent të rasteve aktive me rrezik të lartë, për secilin rast të dokumentohen masat e sigurisë, zyrtari përgjegjës për ndjekjen e tyre dhe bashkërendimi me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale, përfshirë zbatimin policor të urdhrave mbrojtës dhe reagimin ndaj alarmeve të mbikëqyrjes elektronike.

Gjithashtu, brenda 72 orëve, Ministria e Drejtësisë të vijë me një raport të detajuar që zbardh gjithë reagimin apo mosreagimin e secilës hallkë të zinxhirit institucional në këtë rast.

Të dashur qytetarë,
Mendimi se liria jonë na obligon ndaj lirisë së tjetrit ka peshë të veçantë në shoqërinë tonë. Ne e dimë çfarë do të thotë të kërkosh që jeta jote të mos i nënshtrohet vullnetit arbitrar të dikujt tjetër. Këtë bindje duhet ta zbatojmë me të njëjtin seriozitet në familje, në shoqëri dhe në institucione. Për Arlindën, kemi detyrimin e drejtësisë. Për gratë që sot jetojnë nën kërcënim, kemi detyrimin e mbrojtjes në kohë.

Për secilën prej tyre, kemi përgjegjësinë që dinjiteti i njohur me ligj të përjetohet si siguri dhe liri konkretisht në jetën e përditshme. Vetëm kësisoj e trajtojmë lirinë si të drejtë që na bashkon dhe që secili prej nesh është i detyruar ta respektojë. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, kryeministër! Vazhdojmë me grupet parlamentare. Është radha e Lëvizjes Vetëvendosje, deputetja Adriana Matoshi.

ADRIANA MATOSHI: Faleminderit, e nderuara kryetare!
I nderuar kryeministër,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Tetë gra janë vrarë brenda familjes këtë vit në Kosovë; tetë jetë të ndërprera, tetë gra që kishin të drejtë të jetonin të sigurta, të vendosnin për veten dhe të plakeshin pranë njerëzve të tyre.

Arlinda Zekaj u vra mbrëmë pasi e kishte kërkuar ndihmën e prokurorisë, kishte shkuar në polici, e kishte raportuar dhunën, kishte kërkuar mbrojtje, kishte kërkuar mbrojtjen e Komunës, kishte kërkuar të zbatohej vendimi që ia njihte të drejtën për ta shfrytëzuar shtëpinë e përbashkët. Ne duhet ta pyesim veten: kush janë këta që vrasin?

Krejt flasin për zyrtarë publikë, flasin për ta me patjetër. Ata kanë emër e mbiemër. E do ta marrin ndëshkimin me patjetër herët a vonë. Po këta që nuk hetohen kurrë, këta që fyejnë e sulmojnë përditë çdo grua që ua zë udhën, me këta dhe me frymën që e kanë mbjellë, kush do të merret? Si flitet për gratë e vajzat tona? Për fjalorin me të cilin poshtërohen deputetët, gazetarët, artistët, aktivistet dhe vajzat që dalin në një debat publik, apo vajzat e ndonjërës prej nesh, veç pse janë vajzat e kundërshtarit politik?

Ta marrim me radhë. 'Rrugaçe'! Një grua kundërshton, ngre zërin, kërkon përgjegjësi dhe përpiqen ta zhvlerësojnë me këtë fjalë. Argumentit të saj i shmangen, asaj ia sulmojnë dinjitetin. Mesazhi është që ta ulë kokën dhe herën tjetër të mos flasë. 'E kudravtë'! Unë e njoh këtë përvojë, grua që ka marrë vendim të ndahet nga bashkëshorti dhe të vijojë jetën e vetë sipas të drejtës që ia garanton ky shtet. 'Analfabete'! Kjo fjalë hidhet si etiketë pa u marrë fare me atë që gruaja ka thënë, ka bërë apo ka arritur. Përbuzja përdoret për ta mbyllur debatin përpara se ai të fillojë. 'E shkretë'! Edhe kjo është mënyrë për ta ulur një grua. I flasin me mëshirë të shtirur, sikur të mos ishte e aftë të kuptonte çështjen për të cilën po flet.

Këto shprehje janë dokumentuar edhe në monitorimet e gjuhës ndaj grave në politikë. Pastaj vjen gjykimi i pamjes, veshja, trupi, mosha. Një grua del të flasë për një problem publik dhe përfundon duke u detyruar të mbrojë mënyrën se si është veshur apo si e ka trupin.

Sami Lushtaku më krahasoi me dikë që del prej një shtëpie publike. E tha pasi ishte pyetur për kritikat e mia ndaj tij. Kështu e zgjodhi të përgjigjej një gruaje që kundërshtonte publikisht.

Kur një kryetar komune e përdor këtë gjuhë, pesha e saj shkon përtej gruas që ai fyen. E dëgjon edhe vajza që po mendon të angazhohet në politikë, gazetarja që përgatitet të bëjë një pyetje të vështirë, gruaja që dëshiron të denoncojë një padrejtësi. Secila e kupton kërcënimin që bart ai poshtërim: nëse na kundërshton, do të merremi me jetën dhe me dinjitetin tënd.

Pikërisht këtu duhet ta kërkojmë lidhjen me mendësinë që ushqen dhunën ndaj grave, te pretendimi se burri ka të drejtë ta përcaktojë vendin e gruas dhe ta ndëshkojë kur ajo nuk bindet. Në jetën publike kërkohet heshtja jonë përmes turpërimit. Brenda familjes kontrolli mund t'i shtrihet punës, parave, lëvizjes dhe vendimit për t'u ndarë. Kur shoqëria arsyeton këtë kontroll, gruaja mbetet gjithnjë e më e vetmuar përballë dhunuesit.

Pastaj, edhe pas vrasjes, pyetjet shpesh drejtohen nga ajo: pse qëndroi, pse u kthye, pse iku? Arlinda kishte kërkuar ndihmë. Përgjigjen për mbrojtjen që nuk e pati duhet ta japin institucionet përgjegjëse.

Të nderuar kolegë,
Përgjegjësia jonë fillon edhe këtu, në këtë sallë, në partitë tona, në komisionet ku marrim pjesë. Sa herë një grua poshtërohet për shkak të gjinisë, duhet të reagojmë cilado qoftë përkatësia e saj politike.

Nga institucionet kërkojmë mbrojtje me kohë, zbatim të masave dhe përgjegjësi për çdo lëshim.

Nga vetja duhet të kërkojmë që të mos e normalizojmë përçmimi që ua vështirëson grave kërkimin e ndihmës. Tetë gra të vrara këtë vit na detyrojnë ta matim seriozitetin tonë me veprime. Çdo grua duhet të mund të flasë pa u poshtëruar, të kundërshtojë pa u kërcënuar dhe të jetojë pa pasur frikë se dikush do ta ndëshkojë për lirinë e saj.

Divorci dhe ndarja e pasurisë e kujdestaria për fëmijët nuk duhet t'i vrasë gratë.

Dhe për fund, ai burri nga Deçani që e publikoi raportin policor të vajzës sime për të më sulmuar mua, shihet në foto krah për krah me burrin vrasës të Arlindës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit deputete për fjalën! Tani vazhdojmë me grupet parlamentare, nga PDK-ja, z. Tahiri.

ARIAN TAHIRI: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar deputetë,
Si Parti Demokratike e Kosovës vendosëm dhe patëm qëndrim që të mos përfshihemi në debat dhe të mos kemi diskutime pas diskutimit të zonjës Hoxha, sepse besuam se sot është dita që të

heshtim. Sot është dita që ne bashkërisht të gjithë të ndihemi të turpëruar, të ndjejmë përgjegjësi morale, institucionale.

Mirëpo, duke dëgjuar fjalimin e znj. Gërvalla, duke dëgjuar fjalimin e Kryeministrit Kurti, por edhe fjalime të tjera, nuk mund të rrimë pa e ngritur zërin. Kuvendi sot më shumë po duket sikur një sallë e një seminari ku kryeministri Kurti po flet për rolin e gruas në shoqëri, znj. Gërvalla po moralizon për punën që e ka bërë, qëllimin, qasjen e energjinë që e ka.

Ndërsa, sot shoqëria jonë e mori një goditje të madhe në degradimin, në shkatërrimin dhe në rrënimin e vlerave më të shenjta dhe më të rëndësishme. Sot një grua e humbi jetën, një familje u rrënua, që është mesazh pas shumë goditjeve që i mori shoqëria jonë se gjendja shoqërore, morale e sociale është në degradim të vazhdueshëm.

Sot kërkohet përgjegjësi institucionale, penale dhe morale!

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund ta vërë dikë para përgjegjësisë penale, sepse janë institucionet përgjegjëse kompetente, por po, përgjegjësi morale. Edhe zyrtarët e kabinetit qeveritar, përkatësisht, konkretisht znj. Gërvalla, sot minimumi i minimumit do të duhej që të mbajë përgjegjësi morale.

Minimumi i minimumit si reflektim i përgjegjësisë, i ndjeshmërisë të kësaj Qeverie, znj. Gërvalla sot është dashur të jepte dorëheqje.

Nuk është seminar, po e përsëris, nuk është diskutimi për të moralizuar për rolin e gruas në shoqëri sot. Sot duhet dhënë përgjegjësi. Sot duhet vepruar! Sot duhet të ndihet i turpëruar secili prej neve, sot duhet heshtur, sot duhet reflektuar.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë, kjo situatë nuk duhet të na gjejë para betejave politike dhe të na prodhojë shkaqe e arsye. Nuk duhet as deputetja paraprake të moralizojë e të tentojë të krijojë situata ku nxitet problemi, pse ndodh problemi, e të bëjë betejë politike. Qe gjashtë vjet kryeministër i Kosovës është, qe gjashtë vjet e udhëheq këtë vend.

Nuk e dija a është duke folur një deputet i opozitës apo është duke folur kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili qe gjashtë vjet e udhëheq shtetin.

Andaj, kolegë, sot është ditë e turpshme për secilin prej neve. Sot prej neve kërkohet përgjegjësi morale!

Sot znj. Gërvalla, minimumi i minimumit, do të duhej që të japë dorëheqje dhe ne bashkërisht ta miratojmë rezolutën dhe të heshtim; të heshtim dhe të ndihemi të turpëruar për degradimin e vazhdueshëm, moral, social që është duke i ndodhur shoqërisë sonë. Faleminderit!

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i LDK-së. Kush është në radhë? Po, me radhë është deputeti Sadiku.

ERMAL SADIKU: Faleminderit, kryetare!
Faleminderit të gjithëve për kohën,
Të nderuar deputetë,
E nderuar Qeveri,
Të dashur qytetarë,
Nuk desha sot të jem pjesë e seancës. Nuk desha, se për 26 vjet kam qenë në anën tjetër të kamerave dhe i kam parë seancat e tilla. I kam dëgjuar pak a shumë këto fjalime të bukura dhe të dhimbshme. I kam lexuar këto rezoluta të fuqishme që dalin prej këtyre fjalimeve dhe prej këtyre seancave. I kam dëgjuar emrat e viktimave e krejt çka kam parë pas këtyre seancave është kjo listë e emrave të viktimave, duke u rritur për çdo seancë, duke u shtuar edhe një emër edhe një mbiemër.

Po, ne jemi votuar të vijmë të flasim këtu, edhe të mundohemi ta bëjmë atë që e kemi për detyrë ta bëjmë. Unë e kam një vajzë 14-vjeçare që kam vendosur që ajo të rritet këtu në këtë vend, pa miratimin e saj, e kur unë s'jam më, dikush duhet të kujdeset për sigurinë e saj dhe për sigurinë e vajzave tuaja.

Po besoj që ky institucion do të duhej të ishte thelbi i asaj sigurie.

Nuk po kërkoj të mbahet një minutë heshtje. Unë sot po kërkoj të thyhet heshtja e përgjegjësisë, se mendoj se sot mund të thyhet kjo heshtje e përgjegjësisë. Ne jemi këtu në këtë sallë të ngrohtë, të sigurt, policia jashtë, dyert e hekurta, një sallë e madhe dhe e bukur, e jemi duke folur për një rezolutë derisa një person ka vdekur.

Sa e lehtë është të flasësh për vdekjen e dikujt tjetër derisa ne jemi të sigurt! Sa e rëndë është të mbash një minutë heshtje derisa ne s'kemi folur kur është dashur të flitet! Ne s'kemi heshtur kur është dashur të flitet.

Vrasja është e tmerrshme, po ka diçka edhe më të tmerrshme se një vrasje: është kur njeriu e sheh vdekjen duke ardhur edhe kërkon ndihmë, edhe kërkon ta mbrojnë ata të cilët janë betuar për ta mbrojtur, e ata nuk e shpëtojnë.

Ajo grua i ka besuar një shteti. I kemi parë letrat që ia ka dërguar shtetit, i kemi parë kërkesat që ia ka dërguar shtetit. Kërkesat kanë qenë për të jetuar, nuk kanë qenë për pushtet, as për punë, as për rrogë, as për diçka të tillë, veç për të jetuar. E kjo kërkesë të saj, ne kemi dështuar!

Dëgjo, në thelb shteti nuk është as kjo ndërtesa, as nuk është një ligj, as nuk është një rezolutë që kemi për ta bërë, as nuk është një Kushtetutë. Shteti, në thelb, është një farë premtimi që dikush kur ka shumë frikë, e ka premtimin që atij personi i japim siguri, i jemi afër. E ne në këtë premtim kemi dështuar.

Nuk mendoj që kemi të drejtë të vajtojmë për të vdekurit, kur s'i kemi dëgjuar kur kanë qenë gjallë ata. Por, çka do që ka ndodhur, nuk mendoj që zoti Kryeministër është aspak fajtor, ama çka do që ndodh brenda këtyre 24 orëve, unë mendoj që është fajtori kryesor, nëse s'kemi dorëheqje, dënime, përgjegjësi në 24 orët e ardhshme, fajtorin kryesor e keni mbrapa meje. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga AAK-ja, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Të nderuar deputetë!
Qytetarë,
Media të Kosovës,
Ta them të drejtën, as që e kisha në plan të flasë. Bashkëndiej me familjen e Arlindës dhe dhimbjen që e kanë familjarët e Arlindës për këtë akt barbar edhe të turpshëm që i ka ndodhur Arlindës, po që po u ndodh edhe të tjerëve, edhe u ka ndodhur edhe më parë.

Nuk bën bujë dhe nuk deshëm ta zhvillojmë debatin, sepse një dhe e tëra është përgjegjësia. Përgjegjësia është e këtyre njerëzve prapa këtu. Përgjegjësia është e Qeverisë. Ndërsa, po shoh eksponentë të Lëvizjes Vetëvendosje duke folur, duke aluduar dhe duke dashur ta shpërqendrojnë vëmendjen e opinionit publik nga përgjegjësia e këtyre mbrapa.

Kot e keni, nuk do të biem në grackën tuaj sot dhe asnjëherë tjetër, që këtë debat të dhimbshëm sot që po e zhvillojmë këtu në seancë, ta ktheni në arenë dyluftimesh. S'do t'jua japim atë kënaqësi.

Jepni përgjegjësi për veprimet që kanë ndodhur! Shkarkime për njerëzit edhe për gjithë atë hierarki, sepse Arlinda i është drejtuar Qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë, e ka thënë edhe në letrën e vet, dhe ata duhet të japin përgjegjësi. Përgjegjësia është e juaja, Qeveri, edhe ministrat tuaj.

KRYETARJA: Deputeti Ergul Mazrek e ka fjalën.

ERGUL MAZREK: Sayın Başkan, Değerli Milletvekilleri,
Medya ve Kosova Cumhuriyeti Vatandaşları…
Bugün burada bir kadının kaybından söz ediyoruz. Geride kalan bir aileden, yarım kalan hayallerden ve bir daha geri gelmeyecek bir hayattan…

Arlinda Zekaj'ın ölümü hepimizin yüreğinde derin bir üzüntü bırakmıştır. Ailesine ve sevdiklerine sabırlar diliyorum.

Kamuoyuna yansıyan bilgiler, bu acı olayın bütün yönleriyle incelenmesini zorunlu kılıyor. İlgili kurumların sorumlulukları açıklığa kavuşturulmalı, varsa eksiklikler tespit edilmeli ve benzer acıların yaşanmaması için gerekli adımlar atılmalıdır.

Elbette hiçbir söz Arlinda'yı ailesine geri getiremez. Ancak onun ardından sorulması gereken soruları sormak, gereken dersleri çıkarmak ve başka kadınların aynı kaderi yaşamaması için harekete geçmek bizim elimizdedir.

Çünkü bir kadının hayatı, bir istatistikten ibaret değildir. Her hayat bir ailedir, bir hikâyedir, bir gelecektir.

Arlinda'nın kaybı hepimize önemli bır sorumluluğu hatırlatmaktadır: Hiçbir kadın yardım istediğinde kendisini yanlız ve güvencesiz hissetmemelidir…

Arlinda Zekaj'ı saygıyla anıyor, ailesine başsağlığı diliyorum.

Teşekkür ederim!

KRYETARJA: Faleminderit, deputet! Vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje. Vetëm ta shoh radhën, ju lutem! Po e ftoj ministren. Më fal ministre, se nuk ju pashë. Urdhëroni!

MINISTRJA DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ: Shumë të nderuar deputetë!
Vërtet nuk është sot dita që të diskutojmë dhe të vazhdojmë debatin tonë politik, por kemi nevojë për disa sqarime.

E para, ju dëgjova të gjithëve me shumë vëmendje. Dëgjova propozime shumë të mira, por pashë edhe shumë mosdije edhe shumë mungesë informacioni rreth asaj çka vërtet ka ndodhur jo vetëm në aspektin legjislativ, por edhe në implementimin real të procedurave të ndryshme, të protokolleve të ndryshme të cilat kanë ndryshuar qasjen institucionale ndaj viktimave të dhunës në familje.

Është e vërtetë: numri sivjet është alarmant! Po hajde të flasim pak edhe për numrin e vitit të kaluar. Duhet të analizojmë me kujdes shkaqet e rritjes së numrit këtë vit para se të japim deklarata, sepse të njëjtat ligje kanë qenë edhe vitin e kaluar 2025, kur për fat të mirë kemi një viktimë të vetme, por edhe ajo është një më tepër sesa që do të duhej të ishte.

Të mos krijohet përshtypja e gabuar që dhuna në familje, vrasja e gruas nga partneri, ish-partneri apo familjarët është një fenomen kosovar apo një fenomen vetëm i yni. Dhuna në familje, fatkeqësisht, dhe vrasja e grave nga partnerët apo ish-partnerët e tyre është një fenomen ndërkombëtar. Mirëpo, ajo çka e dallon Kosovën nga shumë vende të tjera është që ne, qoftë në debatin publik, qoftë në debatin politik, e marrim shumë seriozisht secilin prej rasteve që ndodhin në vendin tonë dhe kjo është shumë mirë.

Sot nuk mendoj që është dita të heshtim, sepse po të heshtim, krijojmë përshtypjen që po injorojmë nevojat dhe që po injorojmë pritjet që kanë qytetarët e Republikës ndaj asaj çfarë duhet të thonë të zgjedhurit e tyre dhe Qeveria që ka dalë nga ky Kuvend. Arlinda i është drejtuar drejtësisë dhe nuk ka marrë mbrojtjen e kërkuar. Fatkeqësisht, Arlinda nuk i është drejtuar Qeverisë. Ndoshta po të i ishte drejtuar Qeverisë, ndoshta do të kishte pasur angazhim, duke respektuar natyrisht rendin kushtetues të vendit tonë.

Po, duhet të ketë edhe shkarkime, mirëpo në rendin tonë kushtetues, në Republikën tonë parlamentare, nuk është ministri i Drejtësisë ai që shkarkon as prokurorë e as gjyqtarë. Ministri i Drejtësisë i ka detyrat e veta, nuk është as polic, as prokuror dhe as gjyqtar; e respekton pavarësinë e gjyqësorit, edhe në bashkëpunim me instancat e gjyqësorit, përpiqemi së bashku t'i japim zgjidhje problemeve të përbashkëta. Prandaj, unë nuk mund të shkarkoj asnjë prokuror i cili e ka lënë në baltë Arlindën, sepse nuk ma jep këtë kompetencë Kushtetuta.

As nuk mund të ndryshojë fotot në publik për shoqëri të përjetshme e jo veç për fushata të njerëzve të ndryshëm. Por, nuk jemi mbledhur sot për të diskutuar për këtë. Jemi mbledhur për të thënë që jemi solidarë me Arlindën dhe me familjen e saj. Unë u përpoqa pa emocione edhe pa fjalë të mëdha të tregoj konkretisht se si do të duken ditët e ardhshme.

Ky ishte synimi i vetëm, pa sulmuar askënd, pa folur me fjalë të mëdha, por duke u munduar të tregojë që e marrim shumë seriozisht edhe që konform përgjegjësisë që e kemi dhe mundësive reale që i kemi, pra duke respektuar rendin tonë kushtetues, i cili i ka pushtetet e ndara, legjislativi, gjyqësori edhe ekzekutivi, ne do të bëjmë gjithçka që është në mundësitë e qeverisë për ta sqaruar jo vetëm këtë rast, por edhe për të parandaluar.

Dhe ju bëj një ftesë publike: të gjithë ju që keni njohuri të mangëta rreth jo vetëm ligjit të ri, por edhe rreth gjithë sistemit zinxhir që ka ndryshuar gjatë viteve të fundit, me një angazhim të jashtëzakonshëm të Kryetares së tanishme të Kuvendit të Republikës, znj. Albulena Haxhiu, ju

ftoj që të ulemi së bashku, t'i ftojmë të gjithë personat përgjegjës edhe të paktën ta plotësojmë këtë zbrazëtirë, të cilën duket hapur që disa nga deputetët e këtij Kuvendi e kanë.

Për të gjitha temat e tjera, do të kemi ditë të mjaftueshme për të diskutuar dhe për të biseduar, edhe për përgjegjësitë edhe për papërgjegjësitë individuale apo institucionale të secilit prej nesh. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministre! Vazhdojmë me grupet parlamentare. Deputeti Osman Musliu, sipas radhës që është paraqitur nga Vetëvendosja.

OSMAN MUSLIU: Përshëndetje, e nderuar kryetare!
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Është hera e parë e imja si deputet që e marr fjalën. Dëshira ime ka qenë që të flas për ndonjë program, për ndonjë zhvillim a sukses të Kosovës, të Qeverisë e të Kuvendit, por fatkeqësisht fjala ime e parë po fillon me një vrasje, dhe një vrasje të një gruaje që është shumë e tmerrshme. Vrasje me sëpatë! Akoma më e tmerrshme! Vrasje pas shumë vrasjeve të tjera që kanë ndodhur në Kosovë.

Kjo na bën përgjegjës të gjithë neve, pozitë e opozitë, besa-besë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, prindërit dhe të gjithë të tjerët. E para që unë mendoj që ne duhet ta ndalim vrasjen e grave është që ne duhet të dimë që jemi përgjegjës në këtë jetë, jemi njerëz dhe në asnjë mënyrë nuk guxojmë ta mendojmë gruan, bashkëshorten si pronë tonën, për arsye se ajo nuk është prona, ajo është dashuria, është bashkëshortja, është nëna e fëmijëve tanë, është motra e dikujt. Pra, në këtë mënyrë një pjesë e madhe e mendësive të qytetarëve të Kosovës e kanë që bashkëshorten ende e shohin si pronë e jo si shok të jetës.

E dyta, nëse gratë ndihen jo të lira në familje, nëse nuk ndihen të lira në rrugë, në punë, atëherë ne nuk e kemi kuptuar përgjegjësinë si burra, edhe si Qeveri, edhe si Kuvend, por edhe si qytetarë, edhe si prindër, edhe si punëtorë, edhe si udhëheqës nëpër kompani. Pra, për arsye se ka një pjesë e madhe e njerëzve që lehtë e gjykojnë dhe e sulmojnë tjetrin. Unë kam qenë një njeri që jam marrë edhe me këto gjëra dhe kam parë raste të tmerrshme, saqë ka raste një pjesë e madhe, disa burra, gruan e konsiderojnë sikur është pronë e tyre dhe mund të veprojnë si duan dhe çka duan me të.

E treta, që unë mendoj, duhet të jetë edukimi. Pra, ta ndryshojmë mentalitetin. Duhet ta dimë se ky mentalitet fillon duke ndryshuar në familje më së pari, në shkolla, në kisha, në xhami, në punë, kudo që jemi. Për arsye se, pa edukim të mirëfilltë, ju e dini pjesa më e madhe edhe jeni, së

paku deklarativisht, jeni të besimit islam, ka edhe të besimit tjetër që kam respekt edhe për ata, sepse sipas mësimeve tona pejgamberi ynë, i dërguari ynë, herën e parë që ka qarë edhe ka quajtur në kalendarin e jetës së tij 'vit i dëshpërimit', vitin kur i ka vdekur bashkëshortja, jo kur e ka vrarë bashkëshorten, jo kur ia ka vrarë dikush, po kur i ka vdekur. Kur i kanë thënë: O i dërguari i Zotit, edhe ti po qan? Ka thënë: Ka qenë shoku më i ngushtë i jetës.

Ne duhet të edukojmë një pjesë të madhe të njerëzve që prindërit tanë janë njerëzit më të vlefshëm në këtë jetë. Fëmijët tanë janë dashuria më e madhe në këtë jetë. Bashkëshortët tona janë shokët më të ngushtë të jetës. Pra, unë i shpreh ngushëllime familjes së Arlindës. E lus Zotin që t'u ndihmojë ta kalojnë këtë dhimbje, për arsye se është një dhimbje tepër e madhe edhe Zoti e mëshiroftë shpirtin e saj! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar deputet Musliu! Ju lutem që të mbani qetësi në sallë, rend e rregull! Vazhdojmë me grupet parlamentare.

Znj. Deliu jeni paraqitur prapë për fjalë? A mund ta kërkoni në kohë replikën? Dy minuta replikë. Urdhëro! Fjalën regjia! Regjia, deputetes Blerta Deliu-Kodra fjalën për replikë.

BLERTA DELIU-KODRA: Zonja kryetare,
Ministren do ta kemi edhe në komision, po ta them të drejtën është bukur e padrejtë një deklaratë që Arlinda paska trokitur në derën e gabuar. Merreni me mend! Paska trokitur, se s'paska trokitur në derën e Qeverisë.

Jo e tha! Zonja ministre tha: Ajo ka trokitur në derën e gabuar, sepse po të trokiste te Qeveria, ne do të reagonim ndryshe.

Ajo kërkesa e viktimës që ende sot po e rëndon shoqërinë tonë ka qenë e drejtuar te institucionet e Kosovës dhe unë nuk mendoj që ka adresim më të qartë edhe deklarim më të qartë të saj në drejtim të një gruaje e cila sot nuk jeton më, por që ka pasur shpresë te shteti i Kosovës.

Unë kujtoj vitet e kaluara si jeni akuzuar me të tjerët për dështim të institucioneve. Unë sot po e them që është përgjegjësi e shtetit t'u ofrojë mbrojtje dhe më e pakta që duhet të kemi, është të kemi dorëheqje, të kemi një reagim të institucioneve, sepse sot e kemi një grua mbi dhe, dhe çka do që flasim ne sot këtu për procedura, për ligje, është krejtësisht e padrejtë nëse s'ka reflektim nga pozita, opozita dhe nga shoqëria jonë.

KRYETARJA: Unë nuk jam avokate e ministres, por nuk është në rregull që ta përdorësh këtë foltore të Kuvendit për ta keqinformuar opinionin publik.

Nuk e tha ashtu. Urdhëroni, znj. Gërvalla! Nuk e tha ashtu. Ju lutem! Ju lutem që të keni parasysh se çka flisni.

MINISTRJA DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ: Kemi nevojë vetëm ta sqarojmë një keqkuptim.
Një deputete e Kuvendit tha që Arlinda iu drejtua Qeverisë. Unë vetëm këtë keqkuptim e korrigjova. Ajo me të drejtë dhe me pritje të drejta u është drejtuar institucioneve të drejtësisë, por nuk është e vërtetë që ajo i është drejtuar Qeverisë. I kemi pushtete të ndara. Kaq ishte sqarimi im.

Nuk desha në asnjë mënyrë të ftoj viktimat që të injorojnë institucionet e drejtësisë dhe t'i drejtohen Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARJA: Nuk ke të drejtë, znj. Deliu-Kodra. Vazhdojmë me LDK-në, sipas radhës! Jo, z. Haziri sipas radhës e kemi Doarsa Kica-Xhelilin. Nëse Doarsa ta ka kaluar. A ia ke kaluar fjalën z. Haziri? S'ka problem. Urdhëro!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, Doarsa!
Zonja kryetare e Kuvendit,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Zakonisht në traditën tonë edhe parlamentare në ditët e mortit solidarizohen, ajo që shqiptarët e quajnë: hapet dera edhe për mikun edhe për hasmin.

Nuk po dua të ndërtoj narracion tjetër, por sot Kryeministri e adresoi disa herë edhe mënyrën edhe metodën edhe ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësisë para Kuvendit dhe nuk kemi parë mbledhje të qeverisë e cila e ka trajtuar këtë problem. Njerëzit nuk janë numra!

Po flasim për 96 gra të vrara. Kryetarja e Kuvendit e paraqiti listën. Njëra prej tyre u vra në Zvicër. U vra nga burri shqiptar. Po dhimbja ka ardhur deri në Kosovë dhe ne e kemi përjetuar dhe e kemi përballuar. Po Zvicra i ka përballuar situatat e veta, por ne çka kemi bërë për një vit? Tetë gra janë të vrara!

Nuk po e lidh me kalendarin e asnjë ministri këtu që quhet përgjegjësi. Po e lidhim me mandatin e Qeverisë, që detyrën e parë prej krejt detyrave të tjera, e ka sigurinë juridike të qytetarëve dhe sigurinë fizike të tyre. A ka dështuar në të dy detyrat Qeveria? Ajo që po themi: ka rënë shteti në rastin e të ndjerës, në aktin më të rëndë që u përjetua.

Tani, nëse flasim për një vit, ku kanë mbërritur rastet e tjera të zbardhen apo cila është masa që përgjegjësia ka marrë për ta parandaluar? Kjo është! Nuk mund të distancohesh prej detyrës së

sigurisë juridike dhe sigurisë fizike që shteti e ka ndaj qytetarëve të vet. Është mundësi e mirë për ta adresuar përgjegjësinë brenda atyre që e kanë mandatin. Mandatin e keni ju si Qeveri.

Kryeministri Kurti duhet shfrytëzuar këtë mundësi të madhe, sepse unë pajtohem me ju kur të flasim për raste të tilla të pavarësisë së institucioneve, por nga kjo foltore është thënë: Nuk mund të bëhet kryeprokuror i shtetit dikush i cili nuk më pëlqen mua dhe kryetarit të Kuvendit.

Tre vjet kjo Republikë ka qenë pa siguri juridike të qytetarëve. Kemi folur, kemi bërtitur, kemi thirrur, kemi thënë: Nuk mund ta lëmë vendin pa siguri juridike, në rastin tjetër edhe pa siguri fizike, sepse kur dështon, mandej përgjegjësia kthehet mbrapa. Është e vërtetë që mundësinë e mirë duhet shfrytëzuar Kryeministri për ta adresuar brenda Kabinetit qeveritar, e mandej në strukturë të llogaridhënies secila hallkë që ka dështuar.

Hetimet kush do t'i bëjë? Përderisa po flasim për një komision hetimor të Kuvendit, në anën tjetër janë organet e shtetit që duhet të merren me hetime të drejtpërdrejta. Komisioni parlamentar është ai që mund të kishte shkaktuar diçka në të cilën ne do të vazhdojmë të besojmë që po e ushtrojmë rolin tonë, por në fund hoxha do të thoshte: gjynah është para Zotit edhe para robit, sepse shqiptarët në traditën e vet, ato çka e dëgjova sot është e dhimbshme, ne nuk kemi familje që vrasin gra.

Shqiptarët e kanë të rregulluar me familjen, ku gruaja ka rol. Ne jemi të lindur prej nënave, prej grave, se ende ligji s'lejon që ne të lindim prej burrave. Tendencën që e ka Qeveria ta sjellë edhe atë. Por, ne së paku jemi të lindur nga kjo.

KRYETARJA: Ju lutem, zoti Haziri, keni parasysh që jeni duke folur para qytetarëve të Republikës së Kosovës!

LUTFI HAZIRI: Jeni duke folur dhe jeni duke ndarë dhembje, dhe ju kisha lutur që të mos ndërhyni!

KRYETARJA: Sepse edhe një herë, jua ndërpres fjalën! Të mos më ankohesh pastaj.

LUTFI HAZIRI: Sepse ne po duam ta vëmë në pah vetëm raportin e përgjegjësisë kurrgjë tjetër këtu s'ka. Ne e dimë që nuk ka raporte të personalizuara, të shkurtra këtu. Qeveria ka përgjegjësi kolektive, por njëri nga ata është i pari i Qeverisë, e ka marrë përgjegjësinë dhe mandatin që të ndajë drejtësi. Ne po kërkojmë llogaridhënie, dhe duhet në këtë raport të jepet përgjegjësi për aq sa bëhet gjetje.

Ju besoni, ne besojmë, secili prej neve beson që duhet ky shpirt, këta shpirtra që janë marrë në mënyrë të padrejtë ta fitojnë drejtësinë nga shteti. E kemi obligim të kërkojmë drejtësi, të

vendosim drejtësi. E keni mundësinë të vendosni drejtësi, vendosni drejtësi. Të mos i ikni përgjegjësisë dhe të mos e shpërndani përgjegjësinë atje ku nuk ka. Të tjerët nuk kanë përgjegjësi. Ne nuk kemi përgjegjësi. Sigurinë juridike dhe fizike, keni marrë mandat, e kemi pranuar, jeni votuar, duhet ta ushtroni deri në fund. Tani, kur të ballafaqohesh me probleme të tilla, kjo është koha e vendimeve të vështira. Duhet t'i merrni këto vendime dhe duhet të dilni dhe të kallëzoni që nesër e tutje nuk mund të ndodhin raste të tilla, sepse vrasja e grave nuk mund të jetë numër më në Kosovë, por do të ballafaqohen me drejtësinë sipas përgjegjësisë që e ka, prej Kabinetit e deri atje ku ka dështuar hallka e pushtetit. Faleminderit!

KRYETARJA: Ndoshta më shumë, ose rreth dy dekadave keni qeverisur herë vetë e herë bashkë, kurrë asnjë një veprim s'e keni ndërmarrë dhe kurrë s'ka pasur asnjë kryeministër që ka folur për dhunën ndaj grave, për femicidin. Kurrë asnjëherë. Kurrë asnjëherë.

Për herë të parë ka filluar të ndërmerren veprime në 2021-tën kur jam bërë ministre e Drejtësisë, kam pyetur cilat janë veprimet që janë ndërmarrë? Asnjë. Prandaj, nuk është në rregull që sot ta keqpërdorni këtë foltore të Kuvendit duke hedhur akuza të pabaza. Asnjëherë. Asnjëherë s'e keni ndërmarrë asnjë veprim. Pse? Sepse kryeministrat e kaluar dhe ministrat e kaluar kanë menduar që s'është punë e tyre të merren me dhunën ndaj grave. S'është puna e tyre vrasja e grave. Ja që është. E për shkak të mosveprimeve tuaja, ne sot përballemi me situata të tilla. Prandaj, të keni kujdes se çfarë flisni në këtë foltore dhe në këtë Kuvend.

Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të PDK-së. Dy replika, Tahiri dhe Haziri. Tahiri dhe Haziri. Tahiri dhe Haziri. Uluni! Njëherë Tahiri, pastaj Haziri.

ARIAN TAHIRI: Kryetare,
Minimumi çka duhet sot është të mos keqpërdoret dhe të mos shndërrohet në debat politik. Nuk është sot temë, analizë statistikore se kush ka bërë, e kush s'ka bërë. Shpejt e këqyra, se më detyrove. Për 11 vjet deri në vitin 2022 janë vrarë 47 gra. Prej vitit 2022 deri në vitin 2026 janë vrarë 20 gra. Nëse e përkthejmë në vite, është shumë skandaloze. Është skandaloze secili rast që ka ndodhur dhe është përgjegjësi institucionale, morale edhe e secilit prej nesh.

Andaj, sot duhet reflektim, duhet përgjegjësi, duhet dhënë dorëheqje zonja Gërvalla, si akt moral. Dhe duhet që bashkërisht të ndërtojmë platformë e agjendë institucionale shtetërore që të ndërpriten rastet e tilla të rënda e të dhimbshme. Pra, nuk duhet sot të zhvillohet debat politikë, e të moralizojmë me situatën, por duhen veprime konkrete dhe duhet përgjegjësi morale. Përgjegjësia morale është dorëheqja.

KRYETARJA: Pesë gra janë vrarë në 2019-tën. Pesë! Kush nga ju ka dhënë dorëheqje? Kush nga ju keni folur në këtë Kuvend për këto raste? Asnjëri! Asnjëri s'keni folur.

Unë kam qenë ministre, e di shumë mirë çfarë keni bërë. E di shumë mirë çfarë keni bërë.

Zoti Haziri, urdhëro!

LUTFI HAZIRI: Nuk është mirë të udhëhiqeni prej shembujve të këqij, zonja kryetare, duhet udhëhequr prej shembujve të mirë. Nëse nuk paska ndodhur dorëheqje më herët, kjo nuk të amniston sot që ta adresosh përgjegjësinë, e para.

LDK-ja dhe ministrat e saj ka dhënë dorëheqje kur janë vrarë dy burra në rrugë të Prishtinës. Përgjithësi morale kanë ndier, ka dhënë dorëheqje, ka shkuar gati prej politikës krejt, por ka shkuar me ndjenjën e përgjegjësisë. Nuk emëruam, së paku unë nuk emërova, thashë, është mundësi e mirë kryeministri të valorizojë, të analizojë dhe të adresojë në Kabinet përgjegjësinë. Është çështje krejt tjetër mënyra se si do t'i zbatojë masat, por nuk mund të vazhdoni të amnistoni duke e mbrojtur, sepse ju e para si kryetar i Kuvendit dolët e i emëruat, i personalizuat, the që ministrja e Drejtësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme nuk kanë kurrfarë përgjegjësie në këtë punë.

Ko është krejt çështje e juaja qysh keni zgjedhur ju të ndërtoni mbrojtjen, por nuk po është vetëm në këtë rast tragjik, mënyra se si i mbroni dukuritë dhe rastet që gjenden në ministri, qofshin te nepotizmi, qofshin probleme të tjera është e njëjtë. Duhet thënë se kanë ndodhur edhe më herët, kemi pasur raste edhe më shumë. Po. Po në dështimet e mëhershme jeni ngritur edhe keni fituar besim tash. Tash ju po adresoni, krahasimoren po e bëni me të kaluarën. Është mundësi e mirë që pas tri vjetëve, meqë është zgjedhur kryeprokurori, ai që e zgjedh, e detyron ta zbatojë ligjin. Ky Kuvend ka zgjedhur prokurorë, ka zgjedhur edhe ka emëruar dhe gjyqtarë. Mund ta ushtrojë rolin. Adresojeni vetëm përgjegjësi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Nga AAK-ja Burim Ramadani. Ata i ka vrarë UNMIK-u dhe ju e dini këtë shumë mirë. Aktivistë politikë që kanë protestuar dhe janë vrarë nga UNMIK-u.

BURIM RAMADANI: Faleminderit!
Të nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,
Normalisht që kjo pjesa e polemizimit nuk po besoj që i shkon kësaj seance. Sidoqoftë, secili vendos për veten se si e bën formën dhe veprimin, fjalët që i zgjedh, por të njëjtën kohë duhet ta kemi të qartë se shumë prej këtyre që po thuhen tash mund ta vërtetojmë se janë veç fjalë.

Shihni! Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet përgjegjëse dhe palët mbështetëse, e po e përsëris, Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet përgjegjëse dhe palët mbështetëse:

1. Marrin përgjegjësi për trajtimin me prioritet të të gjitha rasteve të dhunës familje dhe dhunës ndaj grave.
2. Sigurojnë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare, infrastrukturore për të luftuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.
3. Sigurojnë qasje në shërbime cilësore të integruara.
4. Garantojnë drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarat.
5. Sigurojnë riintegrim dhe fuqizim të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.
6. Ndëshkojnë, risocializojnë dhe rehabilitojnë kryesit e dhunës.
7. Rrisin vetëdijesimin e mbarë shoqërisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Këto nuk janë pika që sot po thuhen për herë të parë. Ky është dokumenti juaj, Qeveri e nderuar, janar 2022. Kjo është Strategjia Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave.

Pra, krejt çka po flasim sot janë folur edhe në vitin 2022 dhe fjalë për fjalë kushdo që e merr transkriptin e sheh se fjalë për fjalë është në strategji dhe ne ju matim me diçka, e nderuar. Ne ju matim me dokumentet tuaja dhe ky është ballafaqimi me të vërtetën që duhet ta kemi. Nëse ju e keni shkruar këtë strategji, e që në letër është e mirë, por ministrja e tha, me të drejtë fatkeqësisht, shifrat janë alarmante sivjet.

Edhe e shohim kush e ka përgjegjësinë për krejt këto veprime? Kush e ka përgjegjësinë për zbatimin e strategjisë? A besojmë ne që Qeveria e Kosovës në vitin 2022, në janar të vitit 2022 ka bërë një dokument të keq? Hajde po e shpallim pra që strategjia e vitit 2022 ka qenë dokument kot. Sepse, a e dini pse po e them kështu? Sepse më 13 mars 2026, sivjet, kryeministri Kurti kur e ka emëruar zonjën Gërvalla Koordinatore Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave e ka thënë shprehimisht. “94% e aktiviteteve janë zbatuar dhe janë në zbatim”. Pra, po e shihni!

Është një dokument shtetëror, sepse është Strategji Kombëtare a po? Po flasim për krejt shtetin, i përfshin krejt institucionet dhe jo vetëm Qeverinë, por mbi të gjitha Qeverinë, sepse Qeveria është ajo që e udhëheq dokumentin. Qeveria është ajo që e udhëheq politikën, politikën konkrete, dhe kur thotë kështu, thotë që 94% është zbatuar, domethënë është sukses.

Dhe, nëse një vlerësim quhet 94% i zbatuar dhe në proces të zbatimit, pra s’po flasim për dështime, po flasim për suksese. E nëse janë suksese, atëherë ju lutem, qysh është e mundur që shifrat janë alarmante? Qysh ndodh? Nuk mund të ndodhë. E kundërta. Pra, ka rënie të shifrave, e që do të duhej të kishte rënie të shifrave. Kjo është tepër e qartë, besoj.

Tek ajo që u tha, e pashë ose e shënova, dy kërkesat që kryeministri Kurti i bëri për Kuvendin.

Unë besoj që se çka duhet të bëjë Ministria e Brendshme dhe çka duhet të bëjë Ministria e Drejtësisë brenda 72 orëve, unë besoj që kjo është punë veç e kryeministrit. Kuvendi nuk ka nevojë t'i thotë kryeministrit, ose të mbështetë kërkesën e kryeministrit për ministrat e vet. Ai është udhëheqësi i tyre. Ai mund të kërkojë, dhe pastaj Kuvendi mund t'i kërkojë Qeverisë që ta ndajë raportin me ne. E flasim raportin, e diskutojmë apo s'i diskutojmë as çështje se si e vendos Kuvendi.

Por, të thuash tash se Kuvendi mbështet kërkesën e kryeministrit ndaj ministrave, mendoj që Kuvendi është duke i hyrë në hak detyrës së Qeverisë. Pra, nuk ka nevojë. Është punë e Qeverisë. Nuk ka nevojë Kuvendi ta bëjë këtë. Pastaj, mund t'i kërkojë Qeverisë, e që unë besoj, ne duhet t'i kërkojmë Qeverisë, pajtohem që Qeveria brenda 48 orëve, dorë në zemrën, s'ka nevojë as 72 orë, duhet të sjellë raport të saktë, konkret, të detajuar në këtë Kuvend edhe ta diskutojmë, qoftë edhe me dyer të mbyllura. Sepse nëse ka gjëra që mund të ndikojnë eventualisht në hetime, mund të vendosë Kuvendi të mbahet me dyer të mbyllura.

Sa i përket përgjegjësisë, është tepër e qartë pa dashur të përsëris shumë prej atyre që u thanë. E qartë, e dukshme, ka përgjegjësi penale dhe përgjegjësia menaxheriale e politike. Por, ju lutem! Më 30 gusht 2022, sepse ne nganjëherë harrojmë çka ka ndodhur e çka ndodh, ka dhe shembuj që mund të vendosen si standard i mirë.

Më 30 gusht 2022, drejtori i policisë ka dhënë dorëheqje, ministër, a po? Për çka? Sepse është raportuar se një vajzë 11-vjeçare është përdhunuar prej pesë individëve, kriminelëve. Çfarë të duash mund t'u themi? Por ka pasur përgjegjësi. Një njeri ka thënë, ja e ka fjalinë e saktë, thotë: "Ndërgjegje profesionale". E tash, kurrkush s'ka ndërgjegje profesionale? A s'mundet drejtori i policisë tash bëjë të njëjtin? A s'mundet dikush tjetër ta bëjë të njëjtën, të thotë: ngadalë, e kemi bre një standard. Është vendosur bre një standard!

Nëse ka kësi rasti që është kaq i rëndë, jo vetëm si krim, por dhe si përfaqësim i shoqërisë në aspektin njerëzor e moral, e dështimit të sistemit, sepse këtu u tha që ka dështim të sistemi, kjo më nuk është diçka e re, sepse u tha që ka dështuar, e nëse ka dështuar, unë s'besoj që ka dështuar shteti. Por, kemi qejf ne të themi shteti, shteti. OK!

Ka dështuar një zinxhirë i detajuar i reagimit. Por, dikush duhet të marrë përgjegjësi për atë. Dikush duhet të marrë përgjegjësi dhe të thotë, ngadalë, nëse e kemi një rast në 2022-ën, pse s'e kemi sot? E nëse nuk e kemi sot, dikush duhet thënë, jo zotëri, ose zonjë, je shkarkuar. E njëjta vlen për Koordinatoren Kombëtare.

Që kjo strategji për të cilën fola, kallëzon që ose ka qenë fort e keqe, në kuptimin pa ambicie, pra s'ka pasur qëllime të mëdha që të bëhen veprime që të ulet trendi i krimit të tillë çfarë është edhe çfarë u tha që janë shifra alarmante. Ose, zbatimi i politikës, Qeverisë, nuk është bërë prej

ministres, nuk është bërë prej koordinatores, në këtë rast ka përgjegjësi. S'po them e s'duhet të them që kush ka përgjegjësi penale. Atë duhet thënë institucionet e tjera.

Dhe së fundi, nëse nuk ke e qartë, absolutisht duhet të japë ministrja dorëheqje. Domethënë, për përgjegjësinë e zbatimit të strategjisë. Pa asnjë dilemë, për mua. Dhe e fundit, e që besoj është me rëndësi, te Komisioni Hetimor Parlamentar që është pjesë e dokumentit të rezolutës, nëse vendoset, për shkak se në dokument janë paraparë disa prej fushëveprimit, ta themi, absolutisht besoj që nëse parashihet ashtu, nëse duam të vendosim ashtu, rolin e Koordinatores Kombëtare për Mbrojtje ndaj Dhunës në familje dhe Dhunës ndaj Grave duhet ta ketë një prej pikave kryesore komisioni hetimor.

Nuk mund të thuash, me dokumente jemi mirë, aktivitetet i kemi zbatuar. Mirë ka shkuar, 94%...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ju lutem, zonja nënkryetare, a mund të vini ta kryesoni seancën për pak çaste? Sepse po drejtohem me fjalë si deputete.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Emilia Rexhepi.)

KRYESUESJA: Urdhëroni, kryetare!

ALBULENA HAXHIU: Më lejoni që t'ju drejtohem edhe një herë me fjalë, sidomos për veprimet që janë ndërmarrë në kohën sa unë kam udhëhequr Ministrinë e Drejtësisë. Dhe arsyeja pse po flas është pikërisht për shkak të përgjegjësisë që ndiejmë si institucione në raport me vrasjen e vajzave dhe grave në Republikën e Kosovës.

Më besoni apo jo, por dy prej çështjeve për të cilat asnjëherë nuk janë ndërmarrë veprime nga institucionet para 2021-ës është pikërisht rasti i femicidit, për adresimin e femicidit, dhunës në familje, vrasjen e grave, por edhe rastet e krimeve të luftës.

Unë si ministre në atë kohë jam ballafaquar me sfida të mëdha, sepse nuk kam gjetur as zyrë, as dokument, as vazhdimësi institucionale, ku është dashur të bazohem edhe vetëm ta vazhdoj ndërmarrjen e veprimeve. Dhe pikërisht për këtë arsye, unë kam kërkuar nga Komisioni atëherë për të Drejtat e Njeriut që Koordinatori Nacional për adresimin e dhunës në familje të jetë pikërisht ministri i Drejtësisë, jo zëvendësministri.

Është pikërisht ministri i Drejtësisë për të ngritur përgjegjësinë institucionale në raport me rastet e vajzave dhe grave që po dhunohen në shtëpitë e tyre, në rrugë, në shkollë, kudo. Ka pasur shumë raste kur më kanë thënë çka po merresh me dhunën në familje, ajo është çështje që duhet

të mbetet brenda mureve të shtëpisë, nuk është punë e jotja. Kap bëje vetingun, bëje reformën në Këshillin Prokurorial. Përkundër këtyre deklarimeve, nuk jam ndalur për asnjë moment gjatë mandatit tim si ministre e Drejtësisë për adresim të përgjegjësive që kemi pasur si institucione të Republikës së Kosovës në raport me këto raste.

Është e vërtetë që ligji është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Konventa e Stambollit, po ashtu, dhe ne jemi munduar që strategjinë që zoti Ramadani e përmendi, t'ua përshtatim kërkesave që ka Konventa e Stambollit. Ka shumë vende ku ka protesta kundër Konventës së Stambollit. Kosova është shembull i mirë, ku ka pasur unifikim të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta miratuar apo për ta ratifikuar Konventën e Stambollit.

Kemi themeluar për herë të parë Sekretariat në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Merreni me mend. Pas më shumë se dy dekadave të pasluftës për herë të parë është themeluar Sekretariati, sepse kushdo që vjen pas meje në atë ministri, në këtë rast është ministrja Gërvalla, ta dijë çka ka bërë ministrja Haxhiu, dhe ta ketë Sekretariatin dhe personat përgjegjës që e ndihmojnë për ta vazhduar punën e Koordinatores Nacionale.

Kemi miratuar strategjinë. Ka një zyrë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që jep përqindjet në raport me zbatimin e strategjisë. Strategjia ka paraparë mbi 100 rekomandime për institucionet në nivelin lokal, në nivelin qendror. Këtu përfshihen komunat. Sfidën më të madhe, të dashur deputetë, e kam pasur me kryetarët e komunave. Pafund herë ju kemi shkruar si Ministri e Drejtësisë, cilat janë ndër veprimet që i keni ndërmarrë për qendrat për punë sociale, sepse të vritet gruaja në qendrën për punë sociale, sepse hyn dhunuesi që bëhet vrasës me armë në një ambient të tillë. Më besoni apo jo, katër apo pesë kryetarë komunash kanë kthyer përgjigje dhe kanë raportuar për veprimet që obligohen t'i ndërmarrë me strategji.

Këto dokumente të cilat ne i kemi ndërmarrë nuk janë bërë vetëm nga unë, nuk janë bërë vetëm nga kabineti im, nga zyrtarët e ministrisë. Janë bërë me organizatat e shoqërisë civile, me partnerët ndërkombëtarë, me përfaqësues të institucioneve të tjera, polici, prokurori, gjykatat, me të gjithë që direkt apo indirekt janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin në fuqi.

Për herë të parë e kemi lansuar Protokollin shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale në Republikën e Kosovës. Për herë të parë e kemi miratuar kurrikulën mbi zhvillimin për programet për kryesit e dhunës në familje. Sepse ata persona që po dënohen, pajtohem me zonjën Osmani-Sadriu, që nuk parasheh Kodi Penal dënim vetëm me gjobë për dhunuesit, me gjobë dhe me burg, por gjykatat nuk e zbatojnë detyrimin që kanë. Nuk e zbatojnë. Ne kemi ndërmarrë megjithatë veprime që ata dhunues që janë kryesisht në Qendrën Korrektuese në Dubravë të trajnohen, në mënyrë që kur ta përfundojnë dënimin, të mos u bie ndërmend as me gisht ta prekin partneren, vajzën, nënën apo këdo tjetër. Këtë e kemi bërë bashkë me Këshillin e

Evropës. Kemi mundësuar kompensimin e viktimave të krimit. Kjo ka qenë, po i kemi lehtësuar procedurat për viktimat.

Për herë të parë kemi ofruar ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje. Pra, më herët është dashur të paguhet. Të paguhet pra. Gruaja që është e papunë të paguajë për shërbimin që i ofrohet nga institucioni. E kemi marr përsipër këtë dhe e kemi adresuar në kuadër të ndihmës juridike falas dhe jo të merren avokat privat për t'u mbrojtur pranë procedurave.

Kemi ndryshuar Kodin Penal, Kodin e Procedurës. Sipas agjendës legjislative sërish Ministria e Drejtësisë e ka paraparë për procedim. Le ta diskutojmë edhe temën e femicidit. Ka vende që femicidin e kanë ligj të veçantë. Ka vende që e kanë në kodet e tyre penale. Le të shohim cila është rruga që duhet ndjekur. Ka shembuj si Norvegjia dhe si Spanja që kanë ndërmarrë veprime të duhura në raport me këto raste. Le t'i trajtojmë edhe ne shembujt më të mirë se si t'i mbrojmë vajzat dhe gratë në Republikën e Kosovës.

Për herë të parë, po ashtu, është adresuar edhe programi që e përmenda për trajtimin e dhunuesve. Lansimi i masës për punësimin e viktimave të dhunës në familje. Pra, për herë të parë Qeveria ka lansuar masë për t'i punësuar viktimat e dhunës në familje, sepse përqindje e lartë e tyre kanë qenë të papuna. Edhe këtë e kemi bërë për herë të parë. Buxheti për strehimoret nga sa ka qenë 60-70 mijë, e kemi rritur deri në 3 milionë buxhet kemi ndarë për strehimore dhe për organizata që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare apo që strehojnë viktimat e dhunës në familje.

Po ashtu dhe shumë veprime të tjera që natyrisht që nuk do t'i përmend në këtë seancë, por kurdo që ai komision hetimor ta fillojë punën, unë jam e gatshme si ish-koordinatore që të raportoj për secilin veprim që e kam ndërmarrë si ministre e Drejtësisë në atë kohë. Më duket jo korrekte që sulmet sot dhe nuk ka të bëjë që jemi në të njëjtën koalicion, sulmet sot t'i drejtohen ministres Gërvalla. Kjo nuk është në rregull. Nëse keni sulme, më sulmoni mua. Kërkoni të dorëhiqem nga kryetarja e Kuvendit. Por, unë po ju njoftoj që gjithçka çfarë kam pasur përgjegjësinë e kam adresuar në atë kohë si ministre e Drejtësisë, problemin e kemi që ende në Republikën e Kosovës kemi policë, kemi prokurorë, kemi gjyqtarë që të thonë që, "po çka të bëjmë, në martesë ka dhe dajak".

Epo se s'ka dajak në martesë. Nuk ka dajak në martesë. Mund të ketë mospajtime ndërmjet partnerëve, por ato me dajak e me dhunë psikike, e me dhunë seksuale, e me dhunë financiare nuk zgjidhen. Prandaj, krejt çka po kërkoj unë është që secili prokuror, secili gjyqtar, secili polic, secili zyrtar në qendrën për punë sociale ta trajtojë viktimën me dinjitetin më të lartë pa asnjë paragjykim.

A je ndarë a s'je ndarë, a e ke në plan ta lësh. Është çështje komplet e gruas, sepse sot çka po ndodh dhe unë mendoj që kjo ndërlidhet edhe me fjalën e zotit Gashi, pse unë mendoj, nuk është që kam bërë ndonjë hulumtim, ndonjë analizë të stërholluar, por fatmirësisht gratë në Republikën e Kosovës kanë filluar të vetëdijesohen, të emancipohen, s'po e durojnë dhunën. Nuk e durojnë dhe shumë mirë, dhe unë sot nga kjo foltore u bëj thirrje grave e vajza në Republikën e Kosovës, të mos e duroni dhunën as nga babai, as nga vëllai, as nga bashkëshorti, as nga askush tjetër.

Ndërkaq, institucioneve të drejtësisë, po ashtu, u bëj thirrje që të ndërmarrin veprimet e tyre në raport me përgjegjësitë që i kanë, sepse sot mund të japë dorëheqje ministrja. Nesër mund ta kemi një rast tjetër të femicidit. Prapë ministri duhet dhënë dorëheqje, siç po thoni ju. Pasnesër mund ta kemi sërish. Por, ky është dorëzim para kriminelëve. Unë nuk u dorëzohem kriminelëve. Nuk ju kam dorëzuar as kur kam qenë ministre, e beso nuk do t'u dorëzohem as sot.

Jo, e di që po thoni pse Kuvendi po flet, por në qoftë se Kuvendi s'flet, e në qoftë se Kuvendi s'ndërmerr rezolutë që u kërkon institucioneve të tjera të veprojnë, atëherë ç 'kuptim ka që funksionojmë si institucion? Ç 'kuptim ka që funksionojmë? Prandaj mos iu frikësoni debatit. Të mos i frikësoheni. Unë s'i frikësohem debatit. Por, as nuk u dorëzohem kriminelëve.

KRYESUESJA: Faleminderit, kryetare! Radha është te Grupi Parlamentar i PDK-së. Deputetja Besa Kabashi e ka fjalën.

BESA KABASHI-RAMAJ: Faleminderit!
Është shumë me rëndësi të mos e bastardojmë diskutimin. Po, replikë është. Sot është një ditë e rëndë për të gjithë Kosovën, edhe duhet t'ia rikujtojmë Qeverisë, ministres së Drejtësisë, ministrit të Punëve të Brendshme e kryeministrit të vendit që askush që mban një post të lartë publik nuk duhet të përdorë ndarjen e kompetencave për t'iu shmangur llogaridhënies.

Për pjesën e përgjegjësisë penale jemi të vetëdijshëm, ekzistojnë ligje, do të ndodhë një hetim. Do të zbatohet gjithçka sa i përket kush ka pasur përgjegjësi penale në këtë rast, nëse është kështu fjala, po përtej përgjegjësisë penale, ekziston përgjegjësia morale politike dhe këtu duhet vënë standard. Të dytë bashkë me kryeministrin keni përgjegjësi morale në këtë rast dhe minimumi çfarë mund të bëni për Arlindën, ministre e Drejtësisë dhe ministër i Punëve të Brendshme, është të jepni dorëheqje.

(Drejtimin e seancës e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.)

KRYETARJA: Ju lutem që të mbani qetësi në sallë! Unë personalisht po e kam shumë të vështirë ta dëgjoj fjalën e deputetëve. Ju lutem që të uleni! Karriget janë për t'u ulur. Edhe ata që konsiderojnë që ky debat është i panevojshëm, kanë mundësi të tjera, por do të duhej që të

qëndronit këtu, të kontribuonit dhe të mbanit qetësi, ta respektoni fjalën e njëri-tjetrit. Gashi për replikë. Zotit Gashi. Arben Gashit, fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!
Këto sulmet e kundërsulmet janë joproduktive. Problemi kryesor është që është në rritje pandemike dhuna në familje dhe vrasjet. Prandaj, na duhet të ndërtojmë sistem. Tash, përgjegjësia morale, personale, ato të tjerat, ato janë masa ndëshkimore. Sistemi nuk është duke funksionuar. Prandaj, duhet të ndërtojmë sistem efikas, i cili merret me parandalim të dhunës familje dhe të pasojave të tyre. Ky është problemi i madhor që e ka kjo shoqëri.

Për ta zgjidhur këtë, unë propozova konkretisht krijimin e institucionit, institut, agjenci, sido mund t'ia vendosni emrin, në varësi të Qeverisë që e koordinon krejt punën ndërinstitucionale në të dyja nivelet, nivel qendror dhe nivel lokal dhe që jep tri elemente kryesore: e para, edukimin sepse kanë nevojë edhe policë, edhe prokurorë, edhe gjyqtarë të edukohen. Nuk dinë, nuk dinë. Është çështje kulturore, është problem madhor.

E dyta, me trajtimin edhe në aspektin psikologjik, social e ekonomik të viktimave. Dhe e treta, të vendoset një standard me automatizëm, kur të raportohet një ngjarje e dhunës, ajo me automatizëm të merret dhe të strehohet viktima së bashku me fëmijët, sepse personi që ushtron dhunë, ai nuk ndalet veç te gruaja, vazhdon te fëmijët, vazhdon e bën problemin, sepse do ta ndëshkojë gruan duke i ndëshkuar dhe fëmijët. Pra, është problem shumë madhor.

Cikli i dhunës në bazë të studimeve që bëhen, duhet të paktën dy gjenerata që të ndalet. Neve na u duhen masa parandaluese, jo vetëm masa ndëshkuese. Nuk po i mohoj masat ndëshkuese, rritjen e dënimeve, por nuk po japin efekt. Neve na duhet parandalimi, se ndëshkimi është vonë.

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu, zoti Gashi! Të tjerët për replikë? Hajde me radhë. Po s'kam përmendur emra. Po në rregull. Burim Ramadanit, po, por nuk e pata për ndonjë kundërshtim.

Zoti Ramadani, dy minuta pastaj të tjerët.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetare!
Edhe po filloj me falënderim. Po të falënderoj për mbështetjen e kërkesës sime që edhe pjesa e punës së Koordinatorit Kombëtar të jetë pjesë e fushëveprimtarisë të komisionit hetimor.

Pra, me kënaqësi besoj që do t'ju kemi edhe juve për periudhën tuaj, pra në komision hetimor, por po ashtu, besoj që ka edhe koordinator paraprak para jush, që sot bile është Avokat i Popullit, dhe me të cilën duhet ta kemi të njëjtën temë. Ajo që e mendoj e që është e rëndësishme, është se

iu adresuat punës, një pjese të punës që ishte administrative, edhe e kuptoj nevojën e themelimit të Sekretariatit e të gjitha, por janë aspekte administrative dhe jo tematike.

Rrjedhimisht, fillimi e fundit i këtij diskutimi për mua është ajo që e tha ministrja Gërvalla, shifrat janë alarmante sivjet. Ky është thelbi. Pse janë shifrat alarmante sivjet? Pra, nëse janë shifrat alarmante sivjet, ky është thelbi. A po funksionon Sekretariati apo jo, janë çështje edhe administrative, por jo krejt përmbajtjesore. Pra, jo përmbajtjesore. Faleminderit!

KRYETARJA: Nuk pajtohem, por flasim për komisionin hetimor. Flasim në komisionin hetimor për çështje të tjera të detajeve të këtij diskutimi. Vazhdojmë me zotin Sadiku dy minuta, pastaj me të tjerët.

ERMAL SADIKU: Në një seancë ku numrat nuk do të duhej të ishin as temë, megjithatë numrat mbesin numra dhe statistikat mbesin statistika. Në vitin 2019 kur keni ardhur në pushtet i kemi 1 532 raportime të dhunës ndaj grave në familje, sot janë 2 500, 46% rritje.

Kjo mund të argumentohet me faktin që po ka më shumë raportime, sepse besimi është shtuar, por rritja është enorme, edhe ky numër e ka tejkaluar normalitetin. Prej vitit 2010 deri në vitin 2026 janë 67 vrasje, prej tyre më shumë se gjysma janë gjatë qeverisjes suaj. Numrat janë numra. Dëgjoni! Unë personale aspak nuk e kam unë.

Unë me zonjën Gërvalla nuk kemi asnjë problem, as nuk kemi pasur edhe shpresoj nuk do të kemi asnjëherë. Në fakt, me zotin Sveçla dhe njihemi, kemi raporte të mira, por dorëheqja nuk është personale. Dorëheqja nuk është akt i ulët. Dorëheqja është bujari. Dorëheqja është fisnikëri. Dorëheqja nuk është të dorëzohesh ndaj krimit, zonja kryetare. Dorëheqja është ndoshta të nisësh të vihet një farë ose një thelb të diçka që është e mirë që ndodh në të ardhmen e këtij vendit.

Nuk mund të thoni që po dorëzohem para krimit nëse jap dorëheqje. Në fakt, ndoshta edhe po e nis një proces të mirë, bujar për të ardhmen e këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARJA: Ju lutem, vetëm ngriheni dorën, sepse nuk e kam të qartë kush është paraqitur për replikë. Deputetja Musliu, pastaj Ariana Musliu-Shoshi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Nuk jam kundër seancës, përkundrazi, e përgëzoj këtë seancë dhe uroj që ky debat i filluar sot të mos përfundojë sot ose nesër me varrimin e të ndjerës që ka pësuar në këtë tragjedi.

Po e dëgjoj debatin gjatë gjithë kohës me vëmendje dhe vetëm në këtë formë nuk kisha dashur ta dëgjoj këtë debat sot. Ky debat nuk i shërben as së ndjerës, as rasteve të mëhershme. Nuk na shërben as neve që ta kthejmë ligjshmërinë dhe të vendosim një stop të vrasjeve të grave dhe kujto tjetër në Kosovë.

E dëgjova me vëmendje, nderuar kryetare, edhe fjalimin tënd dhe të përgëzoj për të krejt punët e mira që i ke bërë në këtë drejtim pa dallim. A i ke bërë për herë të parë apo për herë të dytë, hiç s'më intereson. Unë të përgëzoj për punët që i ke bërë. Sepse ky është shteti. Dikush për herë të parë e ka shpallur pavarësinë, e ka bërë ushtrinë, i ka bërë gjykatat, e ka bërë policinë. Dikush i bën për herë të parë ligjet, se ky është proces i jetës tonë. Përndryshe, ne do të duhej ta mbyllnim këtë Kuvend e këto institucione, të mos kemi nevojë absolutisht të merremi se është dashur t'i kryej dikush për herë të parë.

Do të bëjnë të tjerët që vinë pas jush, dhe këtë duhet ta kuptojmë. Por, konsideroj që megjithëse ne kemi mjaftueshëm ligje, strategji që po i lexoj vetëm disa prej tyre nëse më lejohet, sepse në Kosovë kemi ligje e mekanizma për ta luftuar dhunën në familje dhe për t'i mbrojtur gratë, Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në barazi gjinore ose në baza gjinore. Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kodin e Procedurës Penale. Ligjin për barazi gjinore. Konventën e Stambollit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Në rregull, Gane! Vazhdo dy minuta!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!
Konventën e Stambollit, mekanizma institucionalë për mbrojtjen e viktimave dhe koordinimin e institucioneve. Pra, të mos hy t'i numëroj secilën çfarë kemi. Kemi bërë protesta, kemi bërë marshe, kemi mbajtur seanca, kemi zhvilluar debate, por diçka jemi të gjithë të bindur se nuk është duke funksionuar.

Diku kemi huq, kryetare, dhe të nderuar kolegë deputetë. Prandaj, sot, para se ta drejtojmë gishtin drejt njëri-tjetrit, hajde të ndalemi dhe të mendojmë ku ia kemi huq, ku kemi dështuar, cila hallkë s'ka funksionuar në krejt këtë makabër që është duke ndodhur në Kosovë.

Unë mendoj që këtu duhet të fokusohet debati ynë parlamentar. Është përgjegjësi e secilit prej neve deputetëve që energjinë mos ta drejtojmë kundër njëri-tjetrit sot, se nuk i bëjmë nder, në rend të parë vetes, e në rend të dytë nuk u bëjmë nder as atyre viktimave që i kemi me numër të madh në Kosovë. Ky debat nuk guxon të përfundojë sonte. Ky debat duhet të vazhdojë e të mos ndalet derisa ne të vendosim ligj, rend e disiplinë në këtë vend. Derisa vrasësit nuk guxojnë as të mendojnë që duhet të vrasin ose mund ta vrasin një grua në Kosovë.

Prandaj, ju kisha lutur shumë ta kthejmë debatin në një drejtim tjetër, pa e akuzuar njëri-tjetrin, pa lyp përgjegjësi sot prej njëri-tjetrit përgjithësi politike. Ky debat mbi të gjitha nuk guxon të shndërrohet në debat politik. Unë kam vërejtjet e mia dhe në formën si u sjell kjo seancë, sepse do të doja që kjo seancë sot sillej nga Grupi Parlamentar i Grave Deputete, që të ndjehen të gjithë të barabartë. Të mos vrapojmë për bajraktarizma në tema të tilla, sepse nuk kemi nevojë, nuk fitojmë kush po del i pari sot e kush po e rëndon njëri-tjetrin më shumë me fjalë të rënda...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Pajtohem që kjo seancë është dashur që të vijojë ndryshe. Pra, jo akuza e kundër-akuza. Unë në fjalën time të parë isha shumë e kujdesshme në raport me këtë rast, por pastaj fjalimet e deputetëve më obligojnë që të flas për këto raste. Edhe për replikë, ju lutem që të keni mirëkuptim, vetëm për replikë! Me Ganën e bëmë një përjashtim, ndërsa tash janë edhe 3 deputetë, deputetja Musliu-Shoshi, pastaj Eliza, e pastaj edhe ju.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Po ashtu, pajtohem dhe më vjen keq që debati po shndërrohet në akuza dhe mbrojtje politike, por një gjë është e sigurt, Arlinda vdiq në duar të shtetit. Arlinda, ministre, nuk iu drejtua Qeverisë, sepse i dinte kompetencat institucionale. E dinte saktësisht ku do duhej që të drejtohej, në organet kompetente që kishin përgjegjësi ligjore që ta mbrojnë jetën dhe të drejtat e saj.

Po aty ku kërkohet përgjegjësi dhe veprim nga ju si Qeveri e nga ju si ministri, ju heshtni, zhvilloni propagandë dhe përpiqeni të arsyetoheni pse nuk keni faj. E me të drejtë Arlinda kishte thënë: "Tani e kuptoj pse ka kaq shumë vrasje". Pikërisht mënyra se si po zhvillohet sot ky debat në këtë Kuvend është pasqyra më e qartë e asaj që Arlinda kishte kuptuar dhe paralajmëruar. Edhe pas vdekjes së saj, në vend që të kërkohet përgjegjësi, po kërkohen arsyetime, dhe është saktë prapë ajo që tha Arlinda që "kjo është e dhimbshme deri në asht".

KRYETARJA: Deputetja Hoxha, replikë!

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetare!
Veç mora shkas edhe nga fjalimi juaj dhe nga mënyra se si po rrjedh seanca. Në fakt, vetë filli i seancës mendoj që është dashur të jetë ndryshe. Ky Kuvend historikisht ka një Grup të Grave Deputete që agjendën kryesore e ka barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe dhunën ndaj grave.

Mendoj që për të pasur një debat të sinqertë dhe pa beteja politike dhe për ta mos e politizuar betejën për jetën e grave ose fuqizimin e grave, kjo seancë dhe shumë çështje të tjera gjinore do të duhej të liheshin në domenin e Grupit të Grave Deputete, pikërisht për balancën politike dhe partiake brenda këtij Kuvendi.

Andaj, me shumë sinqeritet ju kërkoj që në këtë ditë të vështirë për Kosovën, s'kemi nevojë t'i kallëzojmë njëri-tjetrit kush çka ka bërë e çka s'ka bërë, por një që kemi nevojë është shumë e rëndësishme, që përgjegjësia institucionale e cila na jepet, na dhurohet me besim nga njerëzit jashtë nuk mund ta anashkalojë përgjegjësinë morale që është mbi të gjitha përgjegjësitë e tjera. Përgjegjësitë institucionale kanë afat, përgjegjësia morale flet për dinjitetin e personit, i cili ka marrë për detyrë t'u shërbejë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: I fundit për replikë, deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetare!
U thanë shumë gjëra dhe duke pasur parasysh ndjeshmërinë e kësaj do të ndalem vetëm në dy-tri çështje shkurt. Të mos tingëllojë kjo thirrja e kësaj seance, sepse më tepër po duket sikur po bëhet për shfajësim sesa që e kemi obligim dhe marrje përgjegjësisë gjithkush ato nga pozita të cilën e bartim, dhe këtë ne duhet ta themi qartë përpara të gjithë qytetarëve. Në radhë të parë përgjegjësitë do t'i marrë Qeveria dhe saktësisht dikasteret përkatëse.

Unë do t'i referohem fjalës së kryeministrit, e mbajti një fjalim të gjatë më herët, i cili dukej më shumë si fjalim edukativo-mësimor që mund t'i shërbejë ndonjë katedre dhe harronte krejtësisht nga pozita në të cilën fliste si kryeministër i vendit, njeriu i cili ka përgjegjësinë kryesore, pra ekzekutimin në shtetin e Kosovës.

Në fund të fjalimit, pastaj ai që është i vetëdijshëm për atë që përfaqëson, bëri dy hapa konkretë, ku iu drejtua ministres së Drejtësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme që të bëjnë nga një veprim për 72 orë. Kjo na tregon qartë se kjo është përgjegjësia e Qeverisë, e cila duhet të merret në vazhdimësi të bëhen hapat konkretë, e jo vetëm kur ndodh një rast tragjik sikurse ky që ka ndodhur sot.

Ne duhet të jemi të sinqertë. Ne kemi parë në vazhdimësi sukseset, për shembull, e policisë së Kosovës. I pari që ka dalë për të marrë meritat gjithherë ka qenë ministri i Punëve të Brendshme aty. Pra, në atë rast kur ka suksese policia, po merr përgjegjësi ministria. E në rastet e vështirësive të rasteve tragjike po ndodh kjo tërheqja sikur ne jemi në pozita ku s'mund të marrim përgjegjësi.

Ne nuk mund t'u themi qytetarëve si Qeveri e vendit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Veç Ganes ia shtova replikën, se nuk shtohen replikat, pastaj paraqitesh për fjalë. Vazhdojmë me deputetin Veton Berisha.

VETON BERISHA: E nderuar kryetare, zonja Albulena Haxhiu,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të dashur deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës
Sot, të gjithë ne u zgjuam me lajmin më tronditës të mundshëm të kohës së fundit, ku e kuptuam që mbrëmë kishte humbur jetën një nënë, një grua, një grua të cilën unë e kam njohur, sepse vij nga komuna e Pejës, Arlinda Zekaj, e kam njohur personalisht, dhe flas me përgjegjësi të plotë. Ka qenë një person i cili ka qenë shembull, një vajzë, një grua shumë ambicioze, shumë e zonja dhe për këtë jam prekur thellë, sepse e kam takuar disa herë në një vend pune ku ajo punonte në një agjenci në Pejë, dhe për këtë ndihem tepër i tronditur dhe shpreh ngushëllimet e mia familjes së të ndjerës.

Se sa e rëndësishme është një grua, besoj secili prej nesh e kuptojmë edhe duhet ta kuptojmë dhe s'ka dilemë këtu, sepse të gjithë ne kemi ardhur në këtë botë nga një grua. Pra, të gjithë ne e kemi nga një nënë. Arlindën e kam njohur edhe pikërisht ndjej obligim ta marr fjalën këtu dhe pa dashur të bëj debat politik, e ka mirëpritur këtë seancë. Fatkeqësisht, pas tetë vrasjeve të këtij viti dhe pas 96 rasteve, nuk e di, nuk mbaj mend që ka pasur një debat për vrasje të tilla, por megjithatë u desh të ndodhte rasti i Arlindës dhe ne ta mbajmë një debat në Kuvendin e Kosovës.

Vrasjet nga burrat janë bërë dukuri shumë e rëndë në Kosovë, jashtëzakonisht e rëndë. A mbajmë përgjegjësi të gjithë ne pa dallim? Secili këtu e secili nga jashtë kësaj seance, secili që mban përgjegjësi publike, secili nga ne kemi dështuar dhe askush nuk mund të thirret që ka bërë më mirë apo më keq, sepse rastet po na ndodhin dhe këtë nuk mund ta kalojmë absolutisht te tjetri. Dhe kjo dukuri nuk po njeh as përkatësi etnike, as përkatësi politike, e as dallime e tjera të cilat, disa prej folësve shpesh e thanë që tradita shqiptare e të tjerë e të tjerë, ose u ngushëlluan vetëm shqiptarët. Në këtë rast të gjithë jemi të prekur.

Zonja kryetare, nuk e kam personale me askënd, por e thatë në fillim që burrat duhet ta japin kontributin këtu, sepse burrat po i bëjnë këto vepra. Është e vërtetë, kryetare! Por, në një vend në Kosovën time, ku e kam një presidente grua, e kam një kryetare të Kuvendit grua, e kam një ministre të Drejtësisë grua, shumë të respektuara secila prej juve, një përgjegjëse e prokurorisë në Pejë, e cila ishte grua, një prokurore e rastit grua dhe nuk merret në mbrojtje një grua, vërtet këtu diçka nuk po funksionon.

Tani u tha që shteti ka ligje, ka dokumente, ka mekanizma, ka strategji, ka të gjitha. Edhe unë jam shumë i lumtur për këtë punë dhe e mbështes dhe kjo ka ndodhur shumë dhe për shkak të përshtatjes me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe falë kësaj ne i kemi këto, dhe çfarë po ndodh? Pse po çalon procesi? Pse po ndodhin vrasjet kur ne kemi kaq dokumente të rëndësishme ligjore dhe pse nuk funksionon sistemi?

A thua a do duhej që ne sot të flasim për përgjegjësitë e secilit atje, e secilit prej nesh këtu dhe pa dashur të hedh përgjegjësi te dikush tjetër. Pra, secili kemi përgjegjësi. Pajtohem Arbenin për shkak që ndoshta prej, s'po dua t'i veçoj secili dha kontributin e vet, dhe nuk mendoj që këtu jemi që të kemi mundësi nesër për të marrë vota më shumë ose më pak, sepse në fund prapë në secilin pushtet do të na ndodhin raste të tilla nëse s'ndërmarrin veprime.

Pajtohem shumë me Arbenin, Arben Gashin, i cili konkretisht dha propozim që të krijohet një agjenci dhe të krijohet një mekanizëm institucional, ku do të ketë buxhet, do të ketë strategji, do të marrim shembuj të mirë të organizimit të kësaj dukurie. Nuk është Kosova e vetmi vend ku ndodhin vrasjet te gratë. Kudo në rajon, kudo në botë dhe në vende demokratike, por Kosova ka mundësi më të mëdha t'i parandalojë këto, dhe të gjithë ne kemi, dikush, sigurisht që secili prej nesh ka bashkëshorte, ka nënë, ka vajzë, dhe secilin prej nesh nesër mund ta presë kjo situatë dhe çfarë po bëjmë ne.

Unë mendoj që një rol jashtëzakonisht të madh, përveç Ministrisë së Drejtësisë, rolin kryesor mund ta them e ka Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke pasur do mekanizma komunale atje në komunë që janë të ashtuquajtura Qendra për Punë Sociale. Me sa unë e di dhe kam përvojë, sepse punoj shumë edhe di që përfaqësoj komunitetin egjiptian dhe më bie shpesh, ata në rolin e tyre mendojnë që vetëm duhet të japin social, skema sociale.

Ata nuk e kuptojnë, nuk e njohin përgjegjësinë e vet, nuk i njohin ligjet, nuk i njohin detyrat. Ata e kanë rolin kryesor për t'u marrë dhe për ta parandaluar dhe të merren veprime konkrete. Të gjitha unë i di, besoj secili prej jush i di. Unë mendoj që barra kryesore në këtë rast, krahas Ministrisë së Drejtësisë që duhet sigurisht t'i thërrasë në përgjegjësi, i bie edhe Qendrës për Punë Sociale.

Unë e mbështes rezolutën, e mbështes komisionin hetimor. Me aq sa kam kapacitet sigurisht që jam i gatshëm të jap kontribut edhe të jap ndihmë, e kemi në përgjithësi ngase humbja e Arlindës sot, është humbje për secilin prej nesh.

Sepse jam në një shtet, ku presidentja është grua, kryetarja është grua, sepse po i referohem një paragrafit të shkrimit shumë profesionist të Arlindës dhe ajo ka qenë shumë e zonja dhe e keni kuptuar nga shkrimi se çfarë kemi humbur ne.
Ajo tha: "Gruaja me ligj në dorë po e vritka gruan, jo burri".

Secili prej nesh, e duke inkurajuar shumë gratë që kanë detyra, duhet të punojmë shumë, të parandalojmë dhe sigurisht që Kosova të mos zgjohet me raste të tilla. Ngushëllime familjes! Dhëntë Zoti që ky rast të jetë rasti i fundit në mesin tonë!

KRYETARJA: Tani vazhdojmë me grupet parlamentare, sërish nga Lëvizja Vetëvendosje. Ju lutem të më ndihmoni se kush nga ju e ka fjalën! Deputetja Arbëreshë Kryeziu-Hyseni.

ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
E nderuar zëvendëskryeministre,
Ministra,
Deputetë,
Shumë të dashur qytetarë!
Para pak javësh nga kjo foltore fola për vrasjen e Nafije Bogujevcit e të vëllait të saj Egzonit në Gjilan. Kërkuam drejtësi dhe mbrojtje për gratë. Sot flasim për një tjetër vrasje, atë të Arlinda Zekajt në Vitomiricë të Pejës, pasi e kishte kërkuar ndihmën e institucioneve.

Ajo e kishte paralajmëruar rrezikun që i kanosej jetës së saj. Por, sot dua ta shtroj edhe në një çështje që po lihet jashtë diskutimit. Kush janë burrat e dyshuar për vrasje? Me kë janë të lidhur ata dhe përse lidhjet e tyre mbesin gjithmonë jashtë vëmendjes publike? Lidhjet me të fortët e regjimit të vjetër duhet të shqyrtohen me gjithë seriozitetin që kërkon mbrojtja e jetës.

Duhet të zbardhet nëse këto lidhje kanë pasur ndikim në sjelljet e tyre ndaj viktimave dhe në mënyrën se si institucionet i kanë trajtuar këto viktima, sepse këtu qëndron një çështje thellësisht politike. Çfarë ndodh kur një burrë beson se njohjet e tij vlejnë më shumë sesa të drejtat e një gruaje? Kur emri i njeriut që e ke prapa i duket madje më i fuqishëm se vetë ligji. Kur gruaja duhet të dëshmojë vazhdimisht se është në rrezik, ndërsa atij i mjafton vetëm t'i tregojë kë e ka prapa vetes.

Gruaja nuk mund të detyrohet të përballet njëkohësisht me dhunuesin dhe më pastaj edhe me ndikimet që dhunuesi i ka nga rrethi i tij i jashtëm. Prandaj, kërkoj që në këto raste të hetohet çdo ndërhyrje e mundshme, çdo favorizim dhe çdo përpjekje për ta zbutur përgjegjësinë. Të përcaktohet nëse dikush ka telefonuar, ka ushtruar presion apo ka penguar veprimin institucional dhe kushdo që ka përgjegjësi të përgjigjet para ligjit, pavarësisht pozitës, pavarësisht miqësive apo përkatësisë politike që ka.

Të nderuar kolegë deputetë,
Arlindën e vrau Albert Sylaj, i nxitur nga vëllai i tij, Jeton Sylaj. Të dy burra të një familjeje nga Drenasi. Çka mund t'i bëjë dy njerëz të bëhen vrasës? Dy burra që janë prindër të dikujt, dy djem që janë fëmijë të dikujt. Presioni kulturor përreth, interesi pasuror, tradita që gruaja që nuk bindet duhet të shtypet, çrregullimet psikologjike, vetëbesimi se nuk ka çka ju bën as QPS-ja e komunës, as policia, as prokuroria.

Në rastin e Arlindës, institucionet duhet të japin përgjigje konkrete. Kush e vlerësoi rrezikun? Çfarë mbrojtje iu sigurua asaj? Si u trajtuan denoncimet e saj? Kush e kishte për detyrë të

vepronte dhe çfarë bëri? Këto përgjigje i detyrohemi familjes së saj dhe çdo gruaje që sot po mendon nëse denoncimi do ta mbrojë apo do ta bëjë atë edhe më të ekspozuar. Përgjegjësia përfshin çdo hallkë, prokurorinë, gjykatën, komunën dhe shërbimet sociale. Asnjë institucion nuk mund ta konsiderojë detyrën të kryer vetëm sepse e ka përcjellë një shkresë te dikush tjetër. Mbrojtja duhet të arrijë te gruaja që po kërcënohet, që po kërkon ndihmë dhe mbrojtje nga shteti.

Edhe atyre që kanë pasur afërsi me këta burra u takon një detyrim i qartë publik, të bashkëpunojnë me drejtësinë dhe të mos përdorin asnjë ndikim për t'ua lehtësuar pozitën. Askush nuk duhet ta përdorë miqësinë, pasurinë apo pushtetin që ka për t'i shpëtuar llogaridhënies.

Një grua ka të drejtë të ndahet, ka të drejtë të kërkojë pronën e saj, të kërkojë kujdestarinë e fëmijës dhe të vendosë si dëshiron ta jetojë jetën e vet. Institucionet e kanë për detyrë të garantojnë ushtrimin e plotë të këtyre të drejtave në siguri.

Për Nafijen, për Arlindën dhe për gratë që sot kërkojnë ndihmë duhet drejtësi që vepron në kohë dhe duhet vendosmëri për të hetuar edhe ndikimin e atyre të fortëve që u shfaqën.

Të dashur qytetarë,
Sot duhet të flasim edhe për kulturën që i formon këta burra. Kulturën e të fortit, të pronarit mbi jetën e tjetrit. Të njeriut që të drejtat e gruas i përjeton si cenim të pushtetit të vet. Për këtë tip të burrit, gruaja mund të ketë mendim për aq kohë sa pajtohet me të. Mund të ketë liri për aq kohë sa i merr leje atij dhe kur kërkon të ndahet, të jetojë vetë apo të ushtrojë të drejtat e saj, ai e trajton vendimin e saj si mosbindje që duhet ndëshkuar. Kjo mendësi ka gjetur përkrahje në një kulturë më të gjerë shoqërore e politike, është kultura që burrin kërcënues e quan burrë me autoritet, arrogancën ia njeh për zotësi dhe frikën që ua shkakton të tjerëve ia përkthen në respekt.

Pastaj dëgjojmë, është njeri me lidhje, ka njerëz prapa, mos u ngatërro me të se përfundon keq. Çfarë po i thuhet një gruaje me këto fjalë? Po i thuhet se të drejtat e saj varen nga fuqia e burrit që ka përballë? Se duhet të llogarisë kë ai përpara se të kërkojë ndihmë për jetën e saj. Pikërisht këtu merr kuptim çështja e lidhjeve me të fortët e regjimit të vjetër që po e ngre sot në dy raste.

Duhet të zbardhet nëse këto lidhje kanë prodhuar favore, ndërhyrje apo mbrojtje, por duhet goditur edhe modeli që ato përfaqësojnë, bindja se afërsia me pushtetin apo dikë që ka ndikim në shoqërinë tonë të jep të drejtë mbi të tjerët.

Reagimi i vjetër la pas edhe këtë shkollë të sjelljes, lavdërimin e njeriut që kryen punë përmes njohjeve, që imponon vullnetin dhe që e mat fuqinë me numrin e njerëzve që mund të heshtë.

Brenda familjes, kjo mendësi e vendosur e vendos gruan nën urdhra. Në shoqëri kërkon njerëz që ia pranojnë sundimin. Përballë institucioneve kërkon thjesht, përjashtim nga rregullat.

Prandaj, përgjegjësi kemi edhe për mënyrën se si reagojmë. Kur një grua denoncon kërcënimin, nuk mund t'i kërkojmë ta ruajë familjen duke duruar dhunën. Kur kërkon të largohet, nuk mund ta turpërojmë për ndarjen e saj. Ose kur kërkon ndihmë, nuk mund ta kthejmë te durimi dhe ta lusim që të durojë, sepse pastaj bien poshtë të gjitha këto virtytet për të cilat një burrë duhet të ndihet krenar.

A e dini çka thonë në Gjilan për vrasësin e Nafijes, për Valon Ramushin dhe këtu më duhet ta them këtë, sepse u tha nga PDK pak më herët që sot duhet të heshtim, sot minimumi i minimumit duhet të jepen dorëheqje. Jo, sot duhet të flasim. Sot minimumi i minimumit, ne që të paktën jemi përfaqësues të popullit, duhet të tregohemi të përgjegjshëm përballë veprimeve që ne i bëjmë.

Krejt Gjilani vrasësin e Nafijes e njeh si njërin nga njerëzit më të afërt të Sami e Mërgim Lushtakut dhe si njërin nga bashkëpunëtorët e bizneseve të tyre. Madje, thuhet që kur gruaja e tij kërkonte ndarje të pronës, ai kishte reaguar fuqishëm në këtë rast, sepse s'kishte çfarë të ndante, sepse asnjëra nga ato prona realisht nuk i takonte atij.

Kjo mund edhe të mos jetë e vërtetë. Mund ta merrni si të doni. Unë e ftoj prokurorinë që të reagojë. Problemi është që të gjithë i besojnë dhe i flasin këto me shqetësim, sepse aq shpesh kanë ndodhur këto fenomene sa më nuk ndahet dot çka është thënë dhe çka është e vërtetë.

Nafijes dhe Arlindës u detyrohemi drejtësi. Grave që sot jetojnë nën kërcënim u detyrohemi mbrojtje, ndërsa kulturës së të fortit i detyrohemi një kundërshtim të hapur në institucione, në politikë dhe brenda shoqërisë sonë.
Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! A po, në emër të grupit? Jo, në fakt, më fal, si deputet! Tash për replikë. Pse ty, se ty s'të ka përmendur Fadil! Mërgim Lushtaku s'është këtu, e as Sami Lushtaku.

Zoti Gruda, ju lutem! Vetëm Arian Tahiri si shef i grupit mund të marrë fjalën sepse po flitet... Përparim, përmblidhe ti edhe çështjen e replikës.

PËRPARIM GRUDA: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar deputetë,

Unë s'e kisha ndërmend të diskutoj, po meqenëse e pashë mënyrën si u orientua diskutimi prej Qeverisë, dola t'i them disa gjëra i nxitur prej atyre që pashë prej deklarimeve të Kabinetit qeveritar.

Arsyeja pse bëjmë këtë debat nuk është ta gjejmë përgjegjësin e kësaj që ka ndodhur në Pejë. Përgjegjësinë individuale do ta adresojnë institucionet e drejtësisë. Ne jemi mbledhur në Kuvend të Kosovës të diskutojmë në kuptim politik dhe institucional, dhe ky debat ka një synim të na tregojë se cila është vetëdija shtetërore institucionale në rend të parë e pushtetit ndaj kësaj çështjeje. Dhe, mendoj që me këtë debat arritëm ta nxjerrim cila është kjo vetëdije sot shtetërore edhe ndërgjegje shtetërore.

Ky nuk është një debat për strukturën materiale të shoqërisë. As nuk është debat i gjerë çfarë e shkakton krimin dhe pse bëhet krimi. Nuk është debat i tillë. Se po deshët, unë mund të them, për shembull, që nëse ju e keni mbajtur Kosovën në testin PISA në fund për arsim në Evropë, kjo ka ndikuar në kriminalitet. Nëse ju e mbani Kosovën vendin më të varfër në Evropë, kjo ndikon në kriminalitet. Po ky nuk është debati sot. Edhe për këto ju jeni përgjegjës, jo ne. Ju jeni përgjegjës se ju jeni pushtetarët. Pra, nëse kemi arsimin më të dobët, ekonominë më të dobët, kjo ndikon në kriminalitet.

Po deshët debat për strukturën e shoqërisë, mund ta bëjmë edhe këtë. Ky sot është debat për përgjegjësinë që ka shteti në çdo shoqëri normale kur ndodh një krim i tillë i llahtarshëm.

Romakët e lashtë kanë thënë "kush i ruan rojet", edhe përgjigjja ka qenë "sistemi". Sistemin e ndërtoni ju. Ish-ministrja e Drejtësisë foli këtu se si gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në lartësi të detyrës. Pyetja fundamentale që e bën çdo qytetar i Kosovës sot është, kush është përgjegjës për ta ndërtuar sistemin e mirë të drejtësisë? Kush ka qenë përgjegjës? Ne këtu apo ju që keni qenë ministre katër vjet? Unë besoj që ju.

Nëse prokurori s'e kryen detyrën mirë dhe sot, e pyesim ministrin që sot në detyrë, çfarë bën ti për ta sistemin? Nëse polici nuk e ka kryer detyrën qysh duhet, Xhelal Sveçla duhet të na tregojë pse s'e ka kryer detyrën qysh duhet polici. Është përgjegjësi e tij institucionale. S'jemi duke i thënë ti je përgjegjësit, ty do të qesim para gjyqit. Ti Para gjyqit s'do të dalësh, para gjyqit do të dalë polici, por ti do dalësh para përgjegjësisë publike që je drejtues i institucionit. Bashkë me privilegjin që je ministër, të vjen edhe përgjegjësia ta marrësh që polici dhe policët nuk e kanë kryer detyrën qysh duhet. Pra, ky është një debat për sistemin.

Nëse po mendoni që kemi ardhur këtu për t'i diskutuar krejt faktorët shoqërorë është gabim. Kemi ardhur të diskutojmë, a ka dikush përgjegjësi në këtë vend për sistemin që kemi ndërtuar. Unë besoj që po dhe gjithë qytetarët janë të bindur sepse dështimi ishte katastrofik në këtë rast. Dështimi ishte i pafalshëm në këtë rast, dhe ne duhet ta adresojmë këtë përmes përgjegjësisë

individuale për policët, për prokurorët, për gjyqtarët nesër, dhe përmes përgjegjësisë për detyrën që mbani si ministra në Qeveri.

Është krijuar një zakon i shëmtuar për besimin tim. Sa herë kemi debate të tilla, krejt ju angazhoheni të vini e të na tregoni qysh fenomeni është i keq, qysh shoqëria ka dështuar, qysh vrasja e grave është e papranueshme. I dimë bre ne këtu, i dimë. Qeveritë nuk votohen për të bërë analiza. Nuk votohen për të konstatuar sa i keq është krimi, sa shëmti është kjo, ajo tjetra. Qeveritë votohen për të ndërtua politika që e përmirësojnë. Për këtë po flasim. Për çfarë politikash, çfarë shteti keni ndërtuar këto gjashtë vjet? Dhe me këtë, çfarë shoqërie keni ndërtuar? Për çfarë shteti keni ndërtuar, na tregon ky rast në Pejë.

Për çfarë shoqërie, edhe një herë bëjmë debatin nëse doni, e dimë të gjithë. Për arsimin, për ekonominë, për performancën e sistemit të drejtësisë, krejt ato i dimë. Ky është debati që duhet bërë. Ajo çfarë prita dhe po e mbyll fjalinë time, ajo çfarë prita unë sot këtu është kjo, jo të thuash, unë jam fajtore, unë shkoj në burg, se s'ka asi përgjegjësie ministri, të thuhet që ne e ndiejmë keqardhjen më së pari për rastin, e pranojmë dështimin e sistemit, marrim përgjegjësinë për dështimin e sistemit.

Mund të thotë ministrja, s'jap dorëheqje, s'e kam unë në plan, do ta rregulloj sistemin, por dil e thuaje. Dil thuaj, këtë herë nuk jap dorëheqje se sa e kam marrë mandatin. Gjeje një arsye, sa e kam marrë mandatin dhe jam duke punuar në sistem. Po merre përgjegjësinë. Tregona që reflekton. Të mos na ndodhë që edhe pas pesë vjetëve, pas gjashtë vjetësh që je ministër të thuash prapë, s'bëjnë gjyqtarët, s'bëjnë prokurorët. Ministri të thotë, s'bëjnë policët. Ju duhet ta ndërtoni sistemin. Kështu që, po e mbyll, ky debat na duhet sot.

Ne këtu mund të flasim çka të duam për strukturën materiale të shoqërisë. Na duhet ky debat i mirëfilltë. Kur ne duam të dalim nga kjo sallë me idenë, me një ide që ju e keni kuptuar peshën e përgjegjësisë. Kjo më duhet mua, zonja ministre e Drejtësisë, që ju e kuptoni peshën e përgjegjësisë dhe do ta adresoni këtë, do ta përktheni në mirëqeverisje.

Shpresoj që nga ky debat ta keni marrë këtë mësim, këtë porosi prej nesh. Shpresoj që duhet të punoni që ta rregulloni sistemin. Nëse ky nuk është mësimi që nxjerrim nga kjo dhe kjo nuk është ajo që merrni ju prej nesh prej këtij debati, ne jemi kot duke i torturuar qytetarët e Kosovës, duke na dëgjuar që gati tri orë debat, duke thënë se cilët faktorë janë të rëndësishëm që të ndodh një krim, e që të mos ndodhë një tjetër, e aq më tepër, deputetëve të Vetëvendosjes, kolegëve ju bëj ftesë të mos i bëni me gisht partive politike, të mos bëni me gisht për individë.

Ne jemi politikanë, ta kuptoni një gjë. Ne jemi politikanë. Ne në fushata takojmë plot njerëz, ofrohen për të bërë një fotografi, të pinë një kafe me ne dhe prezantohen. Unë kam takuar plot njerëz, ka gjasë që ata mund të jenë kriminelë ordinerë. Po s'mbaj përgjegjësi unë për ata. Mos i

intimidoni njerëzit kështu. Flisni për çka duhet folur. Flasim si shtetarë, jo si në fis, se vetëm fis ka asnjë lloj përgjegjësie. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani nga LDK-ja, që është deputetja Doarsa Kica-Xhelili.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit!
Sot në mëngjes e kishim një mbledhje të Komisionit për Legjislacion dhe mora fjalën dhe aty dhe thashë një gjë që s'po më duket e tepër ta përsëris, kjo seancë, sikurse ajo mbledhje, kur flasim për këtë çështje s'ka sens. S'ka sens, sepse është bërë standard.

Dhe, nëse duhet edhe një seancë të njëjtë ta thërrasim nesër për çështjen e njëjtë, atëherë ne të gjithë duhet të dorëhiqemi. Nuk ka arsye të mbesim këtu. S'ka arsye të jemi deputetë të kësaj Republike nëse s'jemi në gjendje të bëjmë asgjë për mbrojtjen e një jete. Nuk po flasim për privilegje, as për prona madje, që është çështje kushtetuese, po flasim për gjënë më bazike, më qenësore, të mos flas për faktin që sot e kemi një fëmijë me një nënë të vrarë e një babë kriminel e një axhë vrasës.

Ne po mblidhemi sa herë po vritet një grua. Po shprehim dhimbjen tonë, po i shprehim shqetësimet tona, po i shprehim ngushëllime familjes, po kërkojmë përgjegjësi, po shpërndahemi, po kthehemi në shtëpi. Të nesërmen po vritet një grua tjetër, prapë po mblidhemi, prapë storia e njëjtë.

Kjo seancë do të ketë kuptim vetëm nëse për herë të parë pas mbajtjes së një seance kot, ku ne flasim e bëjmë shumë pak, s'po them asgjë, por shumë pak, shumë të pamjaftueshëm do të bëjmë diçka shumë më konkrete, shumë më thelbësore.

Çka po presim të ndodhë nëse kjo s'mjafton? Çka po presim tjetër? Do të thotë, unë e kam pak të paqartë për vete, çka duhet të ndodhë më tepër se kaq që ne të alarmohemi deri në pikën që të mos shkojë as mendja që të politizojmë çështje të tilla. Çka duhet me ndodhur më shumë se kaq që një seancë të thirret së bashku, jo vetëm prej një individi. Çka duhet bërë tjetër që neve këtu të mos na shkojë mendja të tentojmë t'ia gjuajmë fajin patjetër një partie politike? Çka duhet ndodhur më tepër?

Edhe kam tash një pyetje për prokuroren. Çfarë prokurore je ti, e qysh fle sonte kur të është dërguar një shkresë duke të lutur të jetohet edhe pak, të mbahet gjallë? E kam përshtypjen që shumë lehtë po u shkon mendja njerëzve të bëhen prokurorë në këtë vend.

Që të jesh prokuror në këtë vend, duhet të mendosh nja 100 herë, sepse kur të ballafaqohesh me shkresa si këto, nuk guxon gjumi të të marrë, e lëre më të flesh edhe pasi që ndodh vrasja.

E çfarë polici je ti kur shkon e lë gruan, e cila është në risk, në kanosje të jetës në shtëpi të vet, ku e ka kriminelin duke e pritur? Çfarë polici je ti? Pret aty pesë minuta, hajt se ndoshta i ka kaluar impulsiviteti, nuk e vrasin më a? E çfarë gjyqtari je ti që vlerëson që një grua mund të qëndrojë veç dy metra larg burrit të vet, i cili e kanos me jetë? Kjo s'është normale bre. Në një sistem të ketë kaq shumë abnormalitet, është e papranueshme.

Dhe, po e them një paragraf tjetër që s'desha ta them, kryeministri që s'është këtu, ia dëgjova fjalimin, nuk e pata në plan asnjë moment ta përmend, por çka më la shumë përshtypje është që e pati një fjalim shumë gjenerik, thuajse shabllon. Nuk e dija a po flas për një kryeministër të një vendi ku është vrarë një grua, për të satën herë, e sata grua me radhë, që s'po ndalen këto vrasja, apo thjesht ka ndodhur diçka shumë standard apo në një shtet që ne nuk i takojmë.

Shteti nuk mund të jetë emër i madh kur dalim të kërkojmë vota dhe duam t'i marrë meritat, e shumë emra të vegjël kur duhet marrë përgjegjësinë. Nëse jemi aq të mëdhenj të kërkojmë votë e të tregojmë për meritat e sistemit që i paskemi mbërritur, duhet marrë përsipër edhe përgjegjësinë. Ose e kundërta, nëse s'jemi në gjendje ta marrim përsipër përgjegjësinë kur duhet, të mos t'i marrim as meritat, të mos i marrim. Sistemi i paska meritat kur përmirësohet, atëherë. Të mos dalim të themi, e kemi bërë ne, e kanë bërë ata. Meqë ata janë vrasësit, ata atëherë janë edhe meritorët kur bëhet më mirë. Ka diçka thellësisht e qenësisht të gabuar në këtë pingpong të shfajësimit.

Ministrja e Drejtësisë tha me të drejtë, kërkimi i përgjegjësisë nuk është sulm ndaj institucioneve, dhe unë pajtohem plotësisht. Prandaj, kërkimi i përgjegjësisë nga ana jonë nuk është sulm ndaj jush aspak. Nuk po ju sulmojmë, po e kërkojmë në fakt atë që ju e kërkonit kur nuk ishit të ulur aty. Dhe unë nuk jam për dorëheqje, për dallim prej ndoshta disa kolegëve të mi. Por, a e dini ku është hipokrizia, që ju i kërkonit dikur dorëheqjet. Ju nuk thoshit atëherë: mos hiq dorë, sepse duhet luftuar krimin dhe mos u dorëzo.

Ju i kërkonit dorëheqjet. Normën e përcaktuat ju, jo ne. Unë mendoj që është gabim sot të flasim për dorëheqje të ministrave, por mendoj që jemi vonë për kërkim të shkarkimit të personave përgjegjës në zinxhirin komandues. Nuk mund të kalojë edhe një ditë tjetër që në Republikën e Kosovës një prokuror të ndihet rehat të bëj çka të dojë, një polic të ndihe rehat e të veprojë si të dojë e një gjyqtar të ndihet rehat të vendosë si të dojë, sepse ne mblidhemi këtu dhe merremi me njëri-tjetrin.

Nuk guxon të ndodhë kjo gjë. Jo sot, jo më! Nuk guxojnë ata të hedhin valle, se ne e kemi hallin me njëri-tjetrin. S'e kemi hallin me njëri-tjetrin. Të paktën për këtë gjë do të tentojmë të jemi unik. As s'do të kemi! Po ajo ministre do të rrijë aty, ai ministër do të rrijë aty e ju do të jepni dorëheqje ose do të shkarkoheni, edhe kurrë më mendja s'do t'ju shkoj askujt hiç të llogaritë në budallallëqet politike që ne shpesh i bëjmë në këtë sallë, se harrojmë për çka jemi mbledhur.

Një koleg i imi shumë mirë tha kryeministri s'ka faj, po ka të drejtë që tha: ka përgjegjësi të plotë për atë që ndodh në 24 orët e ardhshme. Halli im është që ka pasur edhe 24 orët e tjera para këtij 24-orëshi kur është dashur të ketë diçka, po s'ka pasur mjaftueshëm. Prandaj sot, me gjasë do ta rrisim tavanin e pritshmërive tona, sepse u bëmë mjaft.

Dhe për fund, po e them vetëm edhe një gjë. E dëgjova avokaten e të ndjerës që tha ka qenë grua e fortë. Domethënë, pse duhet të jemi të forta ne në këtë aspekt? Ku keni parë ju ta ketë domosdoshmërinë një grua në Kosovë të jetë e fortë, për ta luftuar një burrë me potencial të kriminalitetit? Domethënë, qe për çka detyrohet gruaja në Kosovë të jetë e fortë! E fortë për të mos vdekur, e fortë për ta ruajtur fëmijën e vet, e fortë për t'u kthyer në shtëpi të vet, duke u varur plotësisht prej policëve që duhet ruajtur ty e fëmijën tënd. Nuk e ka lënë këtë fëmijë veç burri e kunati i vet jetim. Fëmijën e kësaj nuk e ka lënë, e ka lënë shteti. Po t'ia nisim prej vendit poshtë, mos të politizojmë.

Prokurori, polici, gjyqtari. Më së pari ata le na tregojnë qysh i kanë marrë këto vendime.
Për të tjerat ka kohë, do të jemi këtu gjatë, do t'i kemi ndoshta edhe komisionet, por të paktën të sigurohemi që gratë tona nuk do të kenë më nevojë kurrë të jenë kaq të forta.

KRYETARJA: Tani është radha, unë po bazohem në tabelën që kam para vetes, e deputetes Adelina Tërshana.

ADELINA TËRSHANA: A ka more ndonjë çështje që ju bën bashkë? Jemi duke folur për një grua e cila brenda mureve të shtëpisë së vet është vrarë prej një burri me sakicë. Edhe jo me fjali me Chat GPT me ngjyra të partisë, nuk është vendi.

E nderuar kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë e kolege deputete,
Vrasja e Arlinda Zekajt në Vitomiricë të Pejës është një tragjedi që kërkon drejtësi edhe përgjegjësi të qartë. Fakti që ajo kishte kërkuar ndihmë dhe mbrojtje, e bën edhe më të rëndë këtë rast dhe kërkon që të shqyrtohet çdo veprim edhe mosveprim i personave përgjegjës. Si deputetë, detyra jonë është të sigurohemi që rrethanat e këtij rasti të zbardhen plotësisht.

E mbështes propozimin e grupit tonë parlamentar për një hetim parlamentar që duhet ta shqyrtojmë mënyrën se si është trajtuar kërkesa për mbrojtje edhe për të ndihmuar në përcaktimin e përgjegjësisë për çdo veprim apo mosveprim.

Njëkohësisht, drejtësia duhet të jetë e vendosur. Personat që shpallen fajtorë duhet të marrin dënime të merituara, në përputhje me ligjin edhe veprat që i kanë kryer. Dhuna ndaj grave nuk mund të relativizohet, edhe përgjegjësia të mbetet ashtu e patrajtuar. Gratë në Kosovë e gjejnë

guximin pavarësisht përgjigjes institucionale ta raportojnë dhunën, të kërkojnë ndihmë, të insistojnë për të drejtat e tyre.

Sidoqoftë, ato kërkojnë që të drejtat e tyre të mos mbetet veç në ligje, por të sigurohen që ato implementohen edhe në praktikë. Ky guxim duhet të përballet me një mbrojtje reale. Çdo kërkesë për ndihmë duhet marrë seriozisht, çdo rrezik duhet vlerësuar edhe çdo reagim duhet të vijë në kohë.

Asnjë grua në Kosovë nuk duhet ta paguajë me jetën e saj guximin për të kërkuar mbrojtje.

E kemi detyrim që ky guxim të mos përfundojë në një tragjedi tjetër. Kjo kërkon drejtësi, llogaridhënie, veprime konkrete për sigurinë e çdo gruaje dhe vajze në Kosovë.

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me deputeten Janina Ymeri, sipas radhës natyrisht, por jeni të lirë që t'ia kaloni fjalën brenda grupit njëri-tjetrit.

JANINA YMERI: Faleminderit kryetare për fjalën!
Sa i përket asaj se kush ka pasur faj, çka ka ndodhur, sa numra kanë qenë, kjo me të vërtetë nuk është tema. Po duke u nisur nga ajo çka ka ndodhur para se ta marr këtë mandat, gjendja nuk ka ndryshuar fatkeqësisht.

Kur jemi te përgjegjësia, premtimi ka qenë për zero në vitin 2026. Besa ju keni qenë edhe ministre. Po mundohem të flas shumë butë, për të mos e humbur fjalën, se reprezentoj edhe votues, por edhe zënin e grave mendoj sot, edhe jo vetëm të grave.

Domethënë, më 2024 është paraparë që të përgjysmohen vrasjet, 2026 zero. Policia thotë duhet të ketë një plan adekuat të mbrojtjes për viktimën. E, ku ka qenë plani, të nderuara, që është kthyer në vrasje? Domethënë, plan nuk ka pasur! Plani ka qenë të kthehet në vrasje.

Ndonëse unë sot nuk dua as ta amnistoj Policinë, as t'i lë fajtorë, kur një ministër e kemi përpara që as uniforma nuk ju siguron, qysh pres unë prej një polici, edhe e shoh në fytyrë kur s'ka këmishë, edhe unë i them pse s'e ke mbrojtur të ndjerën? Ndërsa, ky i nderuar rri kat-kat.

Tash në faqen e 51, edhe me të drejtë, Ministria e Drejtësisë e cakton: zyra koordinatore është përgjegjëse për monitorim të zbatimit. Unë po e kuptoj që e keni caktuar vetëm përgjegjëse, edhe shumë mirë. Po unë nuk e kam shkruar këtë, edhe nuk kam qenë në Qeveri, e edhe po të isha, nuk do të dija kaq mirë t'ia bëj vetes. Ju ia keni bërë vetes përgjegjësinë. Kuvend! Jo, kjo është për strategji.

Megjithatë, ju keni qenë në pushtet. Ministria thotë e Drejtësisë, fakt është! Ju keni qenë përgjegjëse. Nën përgjegjësinë tuaj nuk është miratuar, nuk është zbatuar strategjia, siç edhe po shihet. Domethënë, kjo nuk është nga ne. Kjo është nga ju. Konventa e Stambollit, duke u nisur nga gjuha online që përdoret, thuhet në një studim të KDI-së që nuk ka implementime të caktuara ligjore për zbatim efikas. Kjo ka ndodhur edhe në këtë. Nuk është e mundur që një grua që është e dhunuar të mbahet në dy metra distancë. Lirisht në 2 metra e gjysmë mund edhe ta vrasësh dikë pa problem.

Domethënë, para syve të gjithëve është lejuar vrasja e saj. Edhe këtë s'mund ta mohoni.

Për atë që e keni lejuar dhunën si Qeveri, vërehet edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, ku një drejtor është dhunues faktikisht, edhe që nuk është shkarkuar sot e asaj dite.

Tash kryeministri Kurti thotë Kosova është në mesin e vendeve me siguri të investimit.

Kjo thotë është si rezultat i fuqizimit të sundimit të ligjit. Po çfarë fuqizimi të sundimit të ligjit kur mesatarja e vrasjeve, as numri i tyre, nuk ka ndryshuar në asnjë variant në këtë Qeveri.

Tash e dëgjova dhe fjalimin e znj. Gërvalla, thotë: Kush nuk iu përmbajt ligjit. Më fal, e kush nuk iu përmbajt strategjisë, zonjë? Kush ishte këtu, përveç ministrave të Drejtësisë që nuk iu përmbajtën kësaj strategjie kur policia nuk ka fije plani për rrezikim të një qenieje njerëzore? Domethënë, ju dëgjova në fjalime, thotë: duhet, duhet, duhet! Kush duhet për ju? Mos po pritni Misioni i UNMIK-ut t'jua kryejë juve punën? Domethënë, kush duhet, sipas juve, kur edhe në këtë rezolutën që e keni propozuar, ju veç e lani veten, edhe prapë vazhdojmë pak a shumë njëjtë. Nuk mund të ketë një strategji, një rezolutë si duhet, kur palët që mund të jenë të kompromet uara në proces e sipër janë vetë palë të përfshira që duan ta hetojnë vetveten.

Tash kush është, përveç jush? Prokuroria, sa për Prokurori, rastin e parë e kam dorëzuar kur është vjedhur shkolla në Ferizaj. Rastin e dytë e kam dorëzuar kur është vjedhur Spitali në Ferizaj. Rasti i tretë është dorëzuar për energji. Asnjë, asnjë, asnjë veprim! Si mund të pritet nga ky sistem i drejtësisë, sidomos që e keni kritikuar ju, si mund të pritet edhe sot prej jush?

Tash, meqenëse ju po flitni për një rast shumë të largët, unë e kam ndërmend t'ju tregoj tash juve, edhe t'ju pyes: çka i bëni ju një zonje, qe po e marrim shembull mua, edhe është e dhunuar, edhe është pa familje, edhe është e frikësuar, edhe nuk ka familje, edhe nuk ka fëmijë. Tash unë e di përgjigjen se ku e çoni ju! Ku e çoni ju këtë grua? Jo në QPS, se në QPS u vra në Ferizaj, unë aty s'dua të shkoj. Ku e çoni ju këtë grua kur rri gjashtë muaj në strehimore? Cila komunë? Edhe, përfshirë edhe tuajat.

Unë tash pyeta edhe për Gjilan. Ka thirrje publike, mirëpo nuk ka fond për buxhetim të grave që janë të dhunuara. Tash për juve, se po duket që jeni shumë larg femrave që janë të dhunuara, thuaja se të ishte ndonjëfarë Burkina Faso, përfshirë edhe kryeministrin. Po atë e kuptoj, se ai as familjen s'e ka këtu.

Tash juve, qe! Një viktimë vjen, edhe unë nuk jam deputete, se doemos njeriu edhe kur të rrihet, nuk ka vakt më, nuk e ka mendjen për deputete, se s'ka qetësi.

Thashë, ku më çoni ju? Mos më çoni në QPS. Në QPS vritem, qysh janë vrarë në Ferizaj, edhe mund edhe sot, se nuk ka asnjë ndihmë. E pashë një rezolutë, e keni shkruar: linjë këshillimi, linjë falas për këshillë. Unë nuk dua këshilla. Këshillat i marr prej nënës sime.

Unë dua të më mbrojë shteti. Ku e çoni ju fëmijën tim? Ku jeni ju sonte? Ku më çoni ju mua? Te vëllai, nuk dua. Te burri, më ka rrahur! Ku, ku ia bëni ju sot? Edhe sot na keni sjellë një rezolutë, edhe në fakt pa asnjë diskutim publik. Ju, a jeni duke e mbrojtur njëra-tjetrën, njëri-tjetrin, ju a jeni duke e mbrojtur njëri-tjetrin, duke e ledhatuar që jemi duke bërë, a duhet pyetur ne faktikisht gratë? A e di që në strehimore më kanë treguar që ne duhet pritur në rend për të marrë shërbim shëndetësor, duhet pritur si çdo grua tjetër, edhe ne jemi me frikë se po na vjen dhunuesi.

Domethënë, ku më intereson mua të ngre zërin, kur do të vritem? Ku më intereson mua kur polici me të drejtë ndoshta thotë se s'ka kapacitet, thotë s'kam unë rend, nuk kam kapacitet t'ia ruajtur dhëmbin asaj zonjës? Ky është realiteti në strehimore. Mua po më çudit, po më çudit sa pak të informuar jeni edhe ju. Po meqenëse ju thatë Donika Gërvalla, ministrja, tha: mungesë informacioni.

Tash, hajde më trego ku më çon ti mua pas gjashtë muajve që nëse Komuna e Ferizajt, që edhe që mua nuk më jep banesë, që në atë banesë unë ndihem e rrezikuar, qysh pritni ju sot t'jua votoj rezolutën për ta larë ju veten që keni bërë diçka pa asnjë diskutim publik? Unë jam me ato që sot mua më kanë votuar, edhe familjarët e tyre. Nuk jam me një larje goje, me një larje duarsh flete për të treguar që juve sot ua ndien për neve.

I kritikuat komunat, edhe komunat e partisë suaj, edhe komunat e partive të tjera janë njëlloj neglizhente. Tash, ministrja as nuk këqyr. Jo tash këqyr, çka i bën ti një njeriu që është i dhunuar, që nuk është deputete, që s'e ka imunitetin e shumëkujt këtu që doli ta shesë viktimën. A po e sheh që s'keni fytyrë të tregoni çka i bëni ju sot një gruaje?

KRYETARJA: Sa komuna i udhëheq deputete LDK-ja? A e di? S'po më kujtohet tash për momentin!

Sa komuna i udhëheq LDK-ja? Shumë po më intereson. Merre fjalën, më trego! Sa komuna? Pra, po refuzon të flasësh e tash po të njoftoj. Sipas strategjisë!

Po, urdhëro! Veç trego sa komuna dhe pastaj ta jap përgjigjen.

JANINA YMERI: Edhe të Vetëvendosjes, edhe të partive të tjera. Veç e thashë unë. Kjo nuk është çështje partiake...

KRYETARJA: LDK-ja sa komuna i udhëheq deputete?

JANINA YMERI: Po nuk ka rëndësi kjo!

KRYETARJA: Ka rëndësi, se po dua të ta jap përgjigjen.

JANINA YMERI: Jo, unë po flas për nivel komunal.

KRYETARJA: Po de, për nivel komunal, sa komuna i udhëheq LDK-ja sot.

JANINA YMERI: Po nuk është puna e sasisë së komunave. Prishtina si komuna më e madhe e mundëson këtë.

KRYETARJA: Regjia, ia mundësoni vetëm ta kthejë përgjigjen! Unë të inkurajoj ta lexosh Strategjinë. Po ashtu, të inkurajoj që t'i pyesësh komunat që udhëhiqen nga LDK-ja, për besë nuk po më kujtohen sa janë sot, që t'i pyesësh sa herë ju ka shkruar Ministria e Drejtësisë që të bëjnë fond që viktimat e dhunës në familje ta paguajnë qiranë, edhe të paguajnë shpenzimet mujore për to.

Pyeti ato. A e ka Peja? S'e ka, nuk e ka. A e kanë komunat e tjera? Prapë s'e kanë. Pra, nuk ka të bëjë kjo që s'është adresuar. Problemi është që ai rekomandim që paraqitet në strategji nuk po adresohet nga kryetarët e komunave dhe ky është problemi. Ky është problemi që nuk parashohin fond për mbulim të shpenzimeve.

Konventa e Stambollit kërkon që dhunuesi duhet qitur prej shtëpisë, jo viktimën. E kemi vendim gjykate që thotë dy metra rri larg. Pra, këto janë raste që duhet trajtuar komisioni hetimor.

Po, dy minuta replikë deputetes.

JANINA YMERI: Çështja nuk ka qenë te partitë politike. Unë deri tash e di që Prishtina e mundëson. A po kupton? Nuk është kjo puna: ajo komunë, kjo komunë, pa komunë, me komunë. Unë e kallëzova për një dështim institucional mbarëkombëtar. Nuk është ideja që komuna të ta

ruaj me patjetër QPS-në. A nuk mendon që është përgjegjësi edhe e Policisë? A nuk mendon që është përgjegjësi edhe e ligjit, e nismave tona ligjore që e kemi lënë viktimën dy metra larg? A nuk do të duhej ne sot së pari atë ta themi? A nuk mendon që është gabim kjo dy metra. E po! E po kjo është tema.

Nuk është problemi tash të thuhet a ka fond, a s'ka fond. Ti i kritikove komunat. Me të drejtë që janë të të gjitha partive. Unë po ta them këtë. Nuk ka kurrgjë që unë po them, jo Vetëvendosja, jo LDK, jo PDK. Numri, e nderuar, nuk ka ndërruar me të gjitha partitë. Komunat janë të të gjitha partive që nuk kanë fond. Njëra po, njëra jo.

Nuk është kjo rëndësia. Rëndësia është që rezoluta është mirë të dalë në diskutim publik, të shihen edhe strehimoret se çfarë thonë, e prandaj të vijmë e të votojmë ne, për të përfshirë më shumë pika, edhe të tregojmë se ku shkon një e dhunuar edhe pas gjashtë muajsh në strehimore. Ku shkon me fëmijë të vet, e që nuk do të shkojë te burri, jo se nuk do, po s'mundet. Mund të jetë trashëgimia e vjehrrit, edhe nuk mund të shkojë te vëllai. Nuk është çështje qëllimi të thuhet: shko te vëllai, edhe je martuar, e ke kryer më.

KRYETARJA: Ka shumë çështje për diskutim, por po më vjen shumë keq që po detyrohem që të drejtohem nga kjo foltore e Kuvendit, por veç po të njoftoj. Tri herë ju kemi shkruar komunave. Tash nuk është në rregull që sot t'i keqinformojmë gratë edhe vajzat. Në qoftë se po pyet ku shkon gruaja, unë po të tregoj, komunat e kanë për obligim ta paguajnë qiranë për viktimat që nuk kanë strehim dhe të paguajnë shpenzimet mujore për viktimat. Është kjo mundësi!

Komuna duhet kryer përgjegjësinë për çfarë votohen nga qytetarët e asaj komune. Pikërisht për këtë, edhe unë po të përgjigjem, sepse mënyra se si ju po e adresoni pyetjen po nënkupton që nuk ka ku drejtohet viktima. E kanë përgjegjësi kryetarët e komunave, komunat që të sigurojnë strehim për viktimat e dhunës në familje.

Nuk ke të drejtë më për fjalë se e përfundove.

Është veç edhe një deputet që është paraqitur për fjalë. Vetëvendosja i paska dy deputetë se këtu s'janë paraqitur. LDK-ja e ka një, por z. Zemaj, meqë ka deputetë të grupeve të tjera parlamentare, kalojmë te grupet e tjera.

Jo, në fakt ma kanë dorëzuar listën, por nuk e kanë prekur këtë butonin për fjalë. Vazhdojmë me Taulantin. Taulanti po kërkon të flasë.

TAULANT KELMENDI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!
Kabinet qeveritar,
Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur,
Në fillim më lejoni të shpreh ngushëllimet për familjen Zekaj, një familje punëtore, kokulur, e nënshtruar në punë, për vrasjen mizore të Arlinda Zekajt.

Kjo është një tragjedi që nuk mund të trajtohet si një rast i izoluar. Është alarm për tërë shoqërinë. Përballë një krimi të tillë nuk mjafton të flasim për zbatimin e ligjit dhe strategjitë kundër dhunës në familje. Po, ligji duhet të zbatohet, strategjitë duhet të funksionojnë dhe institucionet duhet të reagojnë me kohë, por duhet të flasim edhe për një fenomen të rrezikshëm që prej vitesh e ka helmuar shoqërinë tonë. Veçanërisht Pejën dhe Dukagjinin.

Kulti i të fortit, kulti i të paprekshmit dhe atij që mendon se është mbi ligjin, pra njeriu mbi ligjin. E kemi shembullin e kryetarit të komunës që nuk zgjedh strategji e ligj, po i qëron hesapet në qendër të qytetit duke u rrahur me qytetarë. Ky fenomen nuk lind vetvetiu. Ai ushqehet nga heshtja, nga frika, nga tolerimi dhe fatkeqësisht edhe nga aërsia e njerëzve të pushtetshëm me persona që ushtrojnë dhunë ose krijojnë bindje se askush nuk mund t'i bëjë asgjë.

Kemi pasur edhe figura publike, deputetë, ish-kryeministra, ish-kryetarë partish, për të cilët janë ngritur publikisht akuza apo pretendime për dhunë në familje. Kur figura të tilla vazhdojnë të gëzojnë mbështetje politike e shoqërore pa një distancim të qartë, atëherë çfarë mesazhi po u dërgojmë grave që kërkojnë mbrojtje? Çfarë mesazhi po u dërgojmë viktimave që presin drejtësi? Edhe më shqetësues është fakti, sipas raportimeve dhe dëshmive të qarkulluara madje edhe në publik, raste të tilla kanë ndodhur edhe në prani të pjesëtarëve të policisë apo mbrojtjes së afërt. Prania e institucioneve nuk ka vlerë nëse ato nuk arrijnë të ndalin dhunën dhe ta mbrojnë viktimën. Siç e lexuam të gjithë qytetarët edhe raportin përmes deklarimeve të avokates së Ardita Zekajt, znj. Adelina Hoxha, ku thotë në institucionet e drejtësisë në Pejë ishte përhapur bindja se burri dhe familja e tij ishin të fortë dhe askush nuk guxon të veprojë kundër tyre.

Nëse një perceptim i tillë ka ekzistuar brenda institucioneve, atëherë kemi të bëjmë me një problem shumë më të madh sesa dështimi i një individi. Kemi të bëjmë me një kulturë të frikës që e paralizon drejtësinë dhe e lë viktimën përballë dhunuesit. Kur një familje konsiderohet aq e fuqishme sa askush nuk guxon të veprojë kundër saj, atëherë ligji nuk është i barabartë për të gjithë. Dhe kur ligji nuk është i barabartë për të gjithë, viktima nuk është e sigurt.

Në anën tjetër, kemi disa sekrete publike, të cilat i kemi parë sot gjithë ditën nëpër rrjete sociale, me të cilat ndërtohen dhe kultivohen raporte me vrasës e doras, e madje edhe me dorasin edhe burrin e viktimës për të cilën e kemi thirrur këtë seancë sot.

Fotografitë, shoqërimet dhe aërsia politike nuk janë domosdoshmërisht dëshmi e përgjegjësisë penale të askujt, por kur bëhet fjalë për persona të tillë dhe raste kaq të rënda, ato ngrenë pyetje

legjitime për përgjegjësinë morale dhe politike të atyre që u japin hapësirë, afërsi dhe legjitimitet publik. Në këtë kontekst, para moralizimit, duhet një distancim.

Në këtë kontekst, publiku ka të drejtë të kërkojë sqarime për fotografitë dhe raportet publike të personave të përmendur në rastin e sotëm me figura publike, e madje janë të përfshirë edhe ata që thoshin se qytetarët kanë pasur bomba nëpër xhepa para Kuvendit të Kosovës, fotografi të shumta, të panumërta, e madje edhe me një deputete që moralizoi këtu, me deputeten Time Kadrijaj, e cila thotë: shoqëria nuk zgjat vetëm në fushata, shoqëria është e përjetshme.

Pajtohem me deputetët paraprakë që thanë përgjegjësia është individuale dhe në fushata kemi raste kur takojmë edhe persona që kanë dëshmi penale. Po këtu po thotë që shoqëria nuk është vetëm në fushata, po ajo është e përjetshme. A distancohet sot zonja deputete me dorasin? Miqësia politike nuk mund të jetë mburojë për dhunën, ndërsa afërsia me politikën ose parapolitikën nuk mund të shndërrohet në imunitet shoqëror.

Para moralizimit, distancim! Distancohuni nga dhuna, nga kultura e të fortëve!

Distancohuni nga ata që mendojnë që lidhjet politike janë mbi ligjin, me emrin ose mbiemrin e familjes që i mbivendosen gjykatave dhe prokurorëve! Pra, është një e vërtetë e dhimbshme, e dhimbshme deri në asht, sidomos në Pejë e Dukagjin. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Fadil Demaku e ka fjalën. Më fal, të lutem deputet. Urdhëro zonja Kadrijaj, replikë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!
Në asnjë formë nuk kemi dashur ta politizojmë, sepse njerëzit nuk kanë faj nëse ka ndodhur një vrasje. Edhe shpërqendrimi i vëmendjes edhe kalimi i përgjegjësisë prej institucioneve përgjegjëse te individi, kjo nuk ka kuptim. Ja, unë këtu e kam një foto.

I dënuari me vdekje Naim Murseli në foto me Albin Kurtin. Nuk e di a mund mediat ta rrokin. Unë e kam një foto. Një foto që Naim Murseli, i dënuar me vdekje për shkak të...

KRYETARJA: Me burgim të përjetshëm, e nderuar, se s'ka dënim me vdekje

TIME KADRIJAJ: Po, me burg të përjetshëm,. Është në foto me Albin Kurtin. Këtu e kam fotografinë. A keni ndonjë sqarim tash këtu? A keni dëgjuar dikush që e ka akuzuar Albin Kurtin për këtë foto? S'e ka akuzuar askush dhe kjo çka po tentoni të bëni, shpërqendrim i vëmendjes, përgjegjësia është e institucioneve të sigurisë.

Arlinda ka kërkuar ndihmë në organet e sigurisë në Pejë. Nuk ka përgjegjësi ta ruaj askush askënd këtu, edhe ata është dashur ta kryejnë detyrën, edhe ta mbrojnë Arlindën, edhe Arlindat e tjera që janë vrarë.

KRYETARJA: Replikë, deputeti Kelmendi!

TAULANT KELMENDI: E thashë në postim, shoqëria është e përjetshme, jo vetëm në fushata, ndërkohë dorasi është akoma në arrati.

A mund ta shfrytëzoni këtë shoqëri të përjetshme që ta telefononi dorasin edhe të dorëzohet para organeve ligjzbatuese? Faleminderit!

KRYETARJA: Nuk keni të drejtë asnjëri dhe as tjetri tash. Replikë, kundër-replikë. Vazhdojmë me Fadil Demakun.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetare!
Në këtë seancë realisht nuk do duhej që të shkonte debati në këtë mënyrë, por ne po detyrohemi. Unë dua t'ju them se sa herë këtu juve ju mungon argumenti për dështimet të cilat i bëni, i keni, ju i gjeni dy pista. O do ta gjeni Sami Lushtakun, o do të thoni: qeveritë e kaluara. Këto të dyja nuk ju falin për dështimet të cilat i bëni çdo ditë. Kjo është shumë e thjeshtë. Ju jeni që gjashtë vjet në pushtet në qeverisje dhe këto gjashtë vjet janë shumë.

Nuk ju jep më asnjë të drejtë që ju të arsyetoni duke thënë qeveritë e kaluara. Prandaj, ju duhet të fokusohemi të gjithë te problemet e mëdha, te çështja për të cilën është thirrur seanca. Mua më vjen keq se si në këtë seancë, në këtë rast kur të gjithë qytetarët janë të prekur thellë nga ajo që ka ndodhur, deputetët e Kuvendit gjejnë mënyra që në interpretimin e tyre ta fusin Sami Lushtakun këtu, kryetarin e Skenderajt. Po çka ka të bëjë Sami Lushtaku këtu? Çfarë lidhje ka ai me këtë çështje që jemi duke e diskutuar ne këtu? Çfarë problemi është kjo?

Kjo është krejtësisht e papërgjegjshme, krejtësisht e papërgjegjshme që të zhvendoset debati nga çështja për të cilën sonte jemi këtu.

Kur vjen puna te miqësitë politike, asnjë nuk do të vlejë këtu përpara qytetarëve.
A jemi shtet? A kemi Qeveri? Nuk ka më të fortë e të ligë e të tillë. Shteti duhet të funksionojë. Ligji duhet të zbatohet para çdonjërit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: E ka pasur fjalën, regjia, ju lutem! Jo replikë, po fjalë.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetare!
Këtu vetëm kërkohet që çdokush aty ku është të marrë përgjegjësitë e tij, t'i kryejë detyrat e tij dhe gjërat do të shkojnë në këtë formë.

Nëse edhe kjo seancë edhe tash po ma krijon bindjen mua tek në fund, sepse ngutia juaj që ta thirrni sa më shpejt, sepse ne të gjithë e kemi ndjerë përgjegjësinë, të gjithë kemi dashur që t'i japim nënshkrimet për këtë seancë sot, ju sikur e shfrytëzuat seancën për qëllimet tuaja për t'u mbrojtur, sepse edhe vetë mënyra e fjalimeve tuaja po shkon në atë frymë.

Unë në fjalën time më herët thashë: ne të gjithë kemi përgjegjësi. Kemi përgjegjësi nga pozitat që bartim në shoqëri që na kanë zgjedhur qytetarët e vendit. E më së shumti kanë ata që janë në ekzekutivin e vendit dhe kjo s'ka asnjë dilemë. Dhe ne duhet të ndalemi këtu, të shohim ide, të shohim vendime që mendoj se janë shumë të vlefshme nga shumë deputetë që u thanë këtu parafolës dhe që të fillojë zbatimi i tyre në funksion të qëllimit për të cilin pajtohemi të gjithë që jemi këtu.
Faleminderit!

KRYETARJA: Vazhdojmë me deputetin Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Të nderuar kolegë deputetë!
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,
Kryetare e Kuvendit,
E para, më lejoni që edhe në aspektin emocional, por edhe të korrektësisë t'i shpreh ngushëllime të sinqerta familjes Zekaj për humbjen e bijës së tyre, por edhe të shpreh edhe keqardhjen time atë çka i ka ndodhur kësaj familjeje, por edhe atij regjioni, duke nënkuptuar se këto nuk janë vlera që i takojnë familjeve shqiptare dhe as nuk duhet të shihen dhe as të promovohen si diçka që mund të nxitë krimet e mëtejshme.

Pa e ditur që sot do të kemi seancë kuvendore, me një status, ashtu siç shumë kolegë edhe njerëz të vullnetit të mirë, nga dhimbja e madhe, unë e quajta vdekje të paralajmëruar. E thashë këtë se kjo tragjedi është pasqyra e një shoqërie që e sheh rrezikun, e dëgjon alarmin, por nuk gjen forcë e as kurajë të reagojë.

Kështu ka ndodhur me shumë krime e vrasje që kanë ndodhur në Kosovë si ndaj grave po ashtu edhe ndaj të tjerëve që kanë qenë cak i sulmeve, linçimeve e ndjekjeve të tyre deri në vrasje. Për ta ballafaquar këtë me aktivitetet dhe përgjegjësitë institucionale, më lejoni të theksoj se Qeveria si ekzekutiv ka përgjegjësi dhe nuk duhet që të trumbetojë në asnjë rast të veçantë nisjen e gjithçka nga një diçka e keqe, nga një diçka e cila i prek të gjithë edhe nga një diçka e cila do duhej të ishte e parandaluar.

Në vitin 2003, hapat e parë të kornizës ligjore të pasluftës filluan me UNMIK-un për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në 2004 kishte mobilizim politik, Rrjeti i Grave të Kosovës si organizata më e madhe deri te organizimi edhe i protestave. Më 2006 filluan procedurat për shërbime sociale.

Në 2010, ligji i parë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës për këtë fushë dhe po atë vit u miratua Strategjia kombëtare për parandalimin e dhunës, mbrojtjes së viktimave dhe trajtimit të kryesve të tyre. Më 2012 koordinimi kombëtar, më 2020 Konventa e Stambollit, e cila u bë edhe pjesë e Kushtetutës, më 2022 Strategjia e re kombëtare, më 2023, Ligji i ri për dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore.

Po në vitin 2024, filloi edhe trajtimi i posaçëm i femicidit. Më 2024, Akademia e Drejtësisë filloi organizimin e trajnimeve për prokurorë dhe gjyqtarë për trajtimin e rasteve të femicidit për gjyqtarë dhe profesionistë të drejtësisë. Më 2024, Presidentja Osmani zhvilloi takim me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë lidhur me vrasjet me bazë gjinore dhe zbatimin e dispozitave ndëshkuese.

Më 2024, Ministria e Drejtësisë nisi punën për hartimin e Ligjit kundër femicidit. Tash, a mjaftojnë të gjitha këto në atë që është kërkesë edhe për edukimin, por edhe për përgjegjësinë institucionale? Çdokush e ka përgjegjësinë e vet. Edhe milionat e shpenzuar të donatorëve, të cilëve duhet t'u jemi falënderues, për edukimin në parandalimin e dhunës në familje.

Miliona nga shumë donatorë. 216 profesionistë u trajtuan nga viti 2021-2023 për trajnim, për reagim ndaj rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Çka tash? A duhet ne të themi, të nderuar kolegë, që përgjegjësia shtetërore nuk duhet të matet me deklarata ose duhet të matet me deklarata vetëm pas tragjedisë? A duhet që vetëm me premtime të bëra nën trysninë e opinionit publik sikur është kjo seancë e sotme?

Kolegë deputetë,
Përgjegjësia matet me veprim parandalimi, me zbatim të ligjit dhe me mbikëqyrje reale të rasteve të grave që kërkojnë ndihmë e mbrojtje. Andaj, pa dyshim kur një grua kërkon mbrojtje dhe përfundon e vrarë, shteti duhet të japë përgjigje. Nëse dikush di të ma thotë ndryshe, le të dalë dhe të më demantojë.

Shteti nuk mund ta kthejë çdo vrasje në reagim publik dhe çdo tragjedi në një premtim të ri. Shteti nuk mund të dalë të na thënë sot neve këtu: kërkojmë zbatim të ligjit, rekomandojmë që vendimmarrja në Qeveri të zbatohet. Paramendoni, sot këtë e dëgjova vetë nga Kryeministri i Kosovës.

E dyta, themelimi i komisionit hetimor kërkohet nga shumica kuvendore për ta hetuar Qeverinë e vet të cilën e ka votuar, hetim parlamentar.

Në parim, nuk ka asgjë të keqe. Është një hap goxha pozitiv. Ama në brendi, fshihet diçka tjetër. E pse unë nuk besoj dhe nuk shpresoj në atë? Tash po them pse. Në vitin 2022, fatkeqësisht në derën e Klinikës së Gjinekologjisë është vrarë një grua. Emrin besoj që ia tha drejt edhe kryetarja e Kuvendit, Hamide Magashi.

Domethënë, në derën e Klinikës së Gjinekologjisë. Tri ditë rresht kishte marrë kërcënime nga kërcënuesi, edhe pse ishte me aktakuzë për dhunë dhe kërcënim. Raport zyrtar. Në të njëjtën ditë, Kryeministri Kurti sikur sot identik e quajti, e ka quajtur në atë kohë: vrasje mizore. Ishte vrasje mizore. Në ditën e nesërme kërkoi përgjegjësi nga grupi ndërministror me deklaratë publike që policia, prokurorët dhe kushdo tjetër që ka përgjegjësi do të marrë përgjegjësi dhe do të shkarkohet.

Për Zotin, a keni dëgjuar që dikush ka marrë përgjegjësi edhe është ndëshkuar për këtë? Katër policë të cilët ishin suspenduar nga Qendra në Lipjan u rikthyen pas një kohe në punë. Vrasësi vrau veten pas dy ditësh. Këtu përfundoi kjo histori. Edhe unë sot kisha besuar në krejt ato që e thatë nëse do të ishte parandaluar ose ishin marrë veprime nga viti 2022.

Në këso lloj raste, cili institucion përgjegjës ka dhënë përgjegjësi? A dha drejtori i klinikës? Jo, se është kandidat për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje. A dha drejtori i QKUK-së? Jo, se është anëtar i një kryesie të një dege atje të Vetëvendosjes. A dha ministri? Jo! A dha sekretari? Jo! A dha ministri i Punëve të Brendshme? Jo!

Cili prokuror a gjyqtar u shkarkua ose shkoi në masë disiplinore? Askush! Pse sot duhet besuar që pas këtij rasti do të ketë përgjegjësi qoftë politike, edhe qoftë institucionale?

Kolegë deputetë,
Policia në Pejë, e kemi thënë këtu Kryetare e Kuvendit, shpeshherë nga kjo foltore, i bartin edhe paratë e fajdexhinjve; edhe paratë e fajdexhinjve i bartin në rajon të Dukagjinit, edhe e dinë të gjithë. 180 raste i ke pasur të denoncuara që janë të fshehura, që një vit e gjysmë nëpër Inspektorat dhe prokurori; kurrkush nuk ka dhënë llogari.

Ndoshta edhe janë graduar ata njerëz, nuk e di, po ndoshta edhe janë graduar edhe ndoshta e bëjnë ligjin. Për këtë arsye ndodh ai rast. Për këtë arsye nuk parandalohet vrasja. Për këtë arsye e çojnë zonjën deri te dera e shtëpisë edhe me aq lehtësi i thonë futu brenda se nuk ka asgjë. Edhe në anën tjetër, domethënë ne vijmë flasim edhe dikush thotë mos kërkoni përgjegjësi politike.

Po, të nderuar, duhet të ketë përgjegjësi politike, nëse dikush do të ketë. Nëse s'dëshiron të ketë, vazhdojmë tutje. Dashtë Zoti që mos të paraqiten këso raste të krimeve makabre. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!
Pa dyshim një ndër debatet më të rënda në Kuvend të cilat ne i kemi dëgjuar dhe në të cilat kemi qenë prezent ka qenë ky debat, për shkak se, si i tillë, na ka shkaktuar dhimbje të madhe gjithë neve që kemi debatuar. Mirëpo, po ashtu më duhet të them që është bukur një marre e madhe të na dëgjojnë qytetarët e Kosovës duke u shtyrë kush e ka fajin e mos të mund të shkojmë pak më përtej, për të mos e parë ngushtë, por për ta parë, do të thosha se vrasjet e grave janë me të vërtetë një urgjencë kombëtare.

U fol shumë për fajin. Edhe unë nuk po dua me u ndal te faji. Po dua ta adresoj një çështje, që e adresova në Kuvend, s'di a është Adnani këtu, një koleg në Komisionin për Legjislacion, e që ndërlidhet drejtpërdrejt me kulturën tonë në shoqëri edhe në familje edhe me heshtjen e vazhdueshme që bëhet në raport me dhunën në familje. Nuk duhet as të frikësohemi, e nuk është dashur atëherë edhe tash, as ta fshehim e as ta mbulojmë një fakt, një marre të madhe që është në shoqërinë tonë, e cila karakterizohet me shkeljen, shpeshherë dhunën, e në rastet e fundit, edhe me vrasjen ndaj grave.

Unë mendoj edhe kërkoj që në rezolutën e këtij Kuvendi të përfshihet po ashtu një kërkesë ndaj institucioneve që nuk janë as parlamentare, as qeveritare, as të rendit dhe as të ligjit, e cilat po ashtu kanë përgjegjësi drejtpërdrejt institucionale të adresojnë çështje kur kombi është në rrezik, kur një kategori e shoqërisë sonë është e rrezikuar, në këtë rast gruaja.

Po flas drejtpërdrejt për Akademinë e Shkencave të Republikës së Kosovës. Kërkoj që në rezolutën e Kuvendit, në mënyrë eksplicite, kështu siç po e them në Kuvend, në qoftë se doni të me hyjë ai nen në vete, pra: kërkojmë nga Akademia e Shkencave të Republikës së Kosovës që të bëjë një hulumtim shkencor rreth dhunës, vrasjes së grave dhe njëkohësisht ndaj çështjeve që ndërlidhen me shtypjen e gruas si në zonat rurale, po ashtu edhe në zonat urbane.

Po ashtu, kërkoj që institucioni i Avokatit të Popullit, i cili është avokati ynë, avokati edhe i kësaj kategorie, në këtë rast z. Naim Çelaj, i cili ka qenë edhe koordinator nacional në qeveri si zëvendësministër i Drejtësisë dhe ka punuar shumë për të kundërshtuar dhunën në familje, po ashtu, në këtë rezolutë, kërkohet nga ky institucion që edhe ky institucion të bëjë një kërkim shkencor, një kërkim të thellë rreth kësaj teme, e cila, siç u tha dhe këtu, u konstatua se është problem shumë i madh.

Është për t'u habitur se si në universitetet tona ka hulumtime shkencore të ndryshme të temave të ndryshme, te katedra e sociologjisë, katedra e studimeve filozofike, po edhe katedra të tjera të cilat do të mund të merreshin me këtë temë, nuk kanë bërë asnjë studim të vetëm dhe kurrë nuk na ka ardhur te ne.

Pra, kërkoj që po ashtu universitetet dhe institutet kërkimore pranë universiteteve publike referente të ndërtojnë dhe të ngritin vetëdije për një armik të cilin e kemi në shtëpi.

Edhe kur them e kemi në shtëpi, e them me përgjegjësi të plotë, se të gjithë e dimë që e kemi në shtëpi përbuzjen, shtypjen, dhunën, edhe vrasjen po e kemi në shtëpi. Hajde ta luftojmë, edhe pse fatkeqësisht po nisemi nga rasti i djeshëm, ta luftojmë përnjëmend. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani është me radhë deputetja Krenare Çerkini.

KRENARE ÇERKINI: E nderuara kryetare e Kuvendit!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë
Dhe ju të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Sot nuk jemi këtu për të mbajtur fjalime të zakonshme. Sot jemi këtu sepse një grua, Arlinda Zekaj, kërkoi mbrojtje nga institucionet e drejtësisë dhe nuk e mori atë. Më 22 tetor, Arlinda i shkroi Prokurorisë. Ajo paralajmëroi për rrezikun ndaj jetës së saj. Kishte urdhër mbrojtjeje, kishte vendim gjyqësor. Kishte raportuar dhunën. Ajo bëri gjithçka që ligji i kërkon një viktime dhe tri ditë më vonë u vra brenda shtëpisë së saj. Kjo nuk është vetëm tragjedi familjare, ky është dështim institucional dhe dështimi institucional ka emra dhe ka adresë.

Si Kuvend, ne nuk mund të qëndrojmë të heshtur. Arlinda nuk është rasti i vetëm. Historia e saj është historia e shumë grave në Kosovë që u vranë nga burrat e tyre, nga familjarët e tyre, edhe pse kishin kërkuar mbrojtje. Prandaj, duhet që teksti ynë të jetë për të kërkuar që çdo zyrtar në polici, në prokurori, në Qendrën për Punë Sociale, që kishte detyrë të vepronte dhe nuk veproi, të hetohet dhe të mbajë përgjegjësi.

Por, përgjegjësia nuk mbaron me hetimin. Duhet të sigurohemi që urdhrat e mbrojtjes të zbatohen në praktikë dhe jo vetëm në letër. Që vlerësimi i rrezikut të bëhet me seriozitet, sidomos kur viktima kthehet në të njëjtën shtëpi me të afërmit e dhunuesit dhe që asnjë grua të mos i shkruajë më shtetit letrën e saj të fundit.

Arlinda shkroi se nuk donte që institucionet të jepnin llogari pasi të ishte marrë jeta. Sot fatkeqësisht jemi pikërisht aty. Të paktën t'i detyrohemi asaj drejtësi të plotë dhe çdo gruaje tjetër në këtë vend mbrojtje reale. Ngushëllime familjes së Arlindës dhe djalit të saj, i cili sot mbeti pa nënë, por nuk do të mbetet pa drejtësi. Faleminderit!

KRYETARJA: Janë edhe dy deputetë të paraqitur dhe kërkoj nga ju që të mos paraqiteni për fjalë, sepse është radha që të lexohet rezoluta, por janë edhe dy deputetë, por nuk do ta keni.

Nuk e keni z. Rrahmani, sepse nuk e keni. Edhe kur të them nuk e ke, edhe nuk do ta kesh fjalën. Deri tash nuk ishe këtu, por nuk e dëgjove askënd, edhe vjen në fund edhe thua kam fjalë. Jo, unë nuk funksionoj ashtu, më vjen shumë keq!

Fjalën e ka deputeti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Përshëndetje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që po na ndjekin!
Të nderuar kolegë deputetë,
Besoj që raste të tilla të dhunës në familje që përfundojnë me vrasje barbare, me të vërtetë meritojnë një trajtim, po meritojnë edhe një sinqeritet në përgjithësi dhe sigurisht ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është mirë vetëm të ngremë fjalën sa për të thënë diçka, por më e rëndësishme është që të ndërmarrim hapa, të cilët, jo vetëm që e dënojnë dhunuesin, marrësin e jetës, por edhe parandalojnë, dhe besoj që në këtë Kuvend është folur mjaft në këtë drejtim, prandaj nuk kam dashur shumë që të diskutoj. Fatkeqësisht, po vjen shprehja të flas këtu në një rast të tillë, ku lakohet fatkeqësisht edhe padrejtësisht, dhe në mënyrë shumë të ulët emri im, edhe i babait tim.

Këtu e kam fjalën për Arbëreshë Kryeziun, e cila pak më parë e ka përmendur emrin e babait tim dhe timin personal, që e ka ndërlidhur me një rast të një personi që e ka kryer një vrasje të papranueshme, ku ka marrë jetën e gruas dhe mikut të tij, gjë që nuk është as në kulturën, as në traditën, as në edukatën tonë si shqiptarë të ndodhë kjo por, krimet ndodhin kudo dhe ato që ndodhin duhet t'i dënojmë.

Por, kur mundohet të ndërlidhë me figura publike pa qenë reale, pa qenë të faktuara, atëherë me të vërtetë është e turpshme vetëm për të zhvendosur vëmendjen, dhe kjo e bën edhe më të ulët komunikimin, debatin e Kuvendit të Kosovës, sepse po do që të largojë përgjegjësinë nga ata të cilët i kanë që gjashtë vite institucionet e vendit, udhëheqjen e vendit, që e kanë edhe Ministrinë e Drejtësisë, që mund të bëjnë edhe politika që dënojnë padrejtësinë, që edhe parandalojnë padrejtësinë.

Dhe, sigurisht deputetja Kryeziu e di që ka imunitet në foltore këtu dhe shpif qëllimshëm. Unë e ftoj deputeten Arbëreshë Kryeziu të dalë edhe jashtë Kuvendit t'i thotë të njëjtat fjalë. Sigurisht që padia do t'i vijë menjëherë, sepse është shpifje e ulët dhe kjo nuk do diskutim.

Prandaj, duhet të përmbahemi para se të themi diçka dhe t'i ndërlidhim me aktet barbare, që besoj të gjithë jemi të tmerruar se çfarë po ndodh në Kosovë. Kurrkush nuk ka të drejtë t'ia

marrë jetën dikujt, veç Zoti e ka të drejtën. Prandaj, është e pafalshme që me të vërtetë të degradohet debati dhe të ndërlidhet me emra të politikës.

Nëse keni vetëm një fakt, unë e jap përgjegjësinë morale, personale, edhe japi dorëheqjen, po ashtu jam i gatshëm të largohem nga Kosova vetëm nëse ndërlidhet ajo temë me mua. Asnjëherë nuk kam pasur as pronë, as biznes me emrin që e ke përmendur ti, që ju e patë në foltore. Andaj, është e turpshme edhe një herë që po duhet të dalë për të mbrojtur të vërtetën, sepse s'ka pasur lidhje asgjë kjo me rastin në fjalë.

Prandaj, besoj që ne si deputetë me të vërtetë duhet të kemi kujdes kur ndërlidhim me rastet e ndryshme me figura publike. Nëse keni fakte, ne e dimë shumë mirë që ka pasur edhe ministra dhe kryeministri që janë takuar me persona publikë që ndoshta në fund të ditës kanë përfunduar të jenë edhe vrasës. Por, nëse ka pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë, sigurisht që edhe unë si deputet i kërkoj përgjegjësi, por edhe ju duhet të kërkoni përgjegjësi, por edhe prej vetë deputetëve duhet t'i kërkojmë përgjegjësi.

Por, kur nuk ka asnjë ndërlidhje, atëherë veç duhet të ulim kokën dhe të kërkojmë falje. Nëse jo, ne mundemi me përmendur emra sepse edhe unë mundem të dëgjoj fjalë se çfarë të ndodhë në Gjilan, kam shumë argumente edhe për babanë, edhe për burrin tënd, edhe për shumë të tjerë, por nuk po dua të lëshohem në atë drejtim, sepse është e ulët të lëshohemi në diskutime të tilla, sidomos në këtë rast, sepse ky rast meriton të trajtohet dinjitetshëm, të krijojmë institucione që edhe parandalojnë, të bëjmë edhe një lloj call center midis institucioneve të drejtësisë që e alarmojnë edhe ndoshta edhe politikën që mos të vihet deri tek kjo më e dhimbshmja, që është privimi nga jeta.

KRYETARJA: Nuk ka të tjerë të paraqitur për shkak se kam konstatuar se debati është mbyllur, vetëm Arbëreshë Kryeziu-Hyseni si replikë edhe vazhdojmë në diskutime, sepse kam kërkesa të vazhdueshme që të vazhdojmë me rezolutën. Urdhëroni, ju lutem, replikë!

ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI: A po e shihni për çfarë folëm ne deri tash? Edhe qysh në fund dalin dhe vetë i vënë vulën kësaj që e thamë, unë edhe krejt deputetët e tjerë parafolës. A u kërcënova unë tani? A më tha deputeti Lushtaku "hajde del jashtë edhe thuaj nëse ke guxim", edhe a u kërcënova? Po tash kur s'ju konvenon juve me ia thënë të vërtetën, reagoni i pari e i fundit.

Hera e parë që po e dëgjoj këtë reagim prej PDK-së sot në këtë sallë, deri tash heshtët, madje thatë nuk është momenti për të folur. Edhe pasojnë me kërcënimin e radhës kur ti ua thua të vërtetën në fytyrë, të thonë: "ta njoh babanë, ta njoh burrin, ta njoh vëllain", mundohen që të gjejnë gjëra që s'ekzistojnë, se s'ju pëlqen realiteti.

Po ky zotëria që vjen në foltore këtu, asnjëherë s'e mohoi afërsinë me personin të cilin unë e përmenda gjatë fjalimit tim, për të cilin krejt në Gjilan e dinë që ti ke lidhje të ngushta me të. Kështu që nëse ti del këtu dhe distancohesh dhe thua: "po, unë bashkëpunoj me këtë person", sepse s'të akuzoi askush që ti e ke shtyrë me e vrarë gruan e vet, po ama u solle, i ra nga Kina për me ardhur te një argument që e vërteton atë që jemi duke e thënë ne këtu, që ju jeni mësuar t'i kërcënoni gratë për mos ta thënë të vërtetën, si ky veprimi që sapo e bëri deputeti Lushtaku në këtë foltore në Kuvend, në një seancë kur po flasim për një vrasje të një gruaje pikërisht sepse ka dashur me e thënë të vërtetën. E vërteta s'është dëgjuar prej shoqërisë sonë.

KRYETARJA: Kundër replikë një minutë. E para se të flas Mërgim Lushtaku, unë po i kujtoj veç dy momente në këtë Kuvend, sepse çfarë ne flasim këtu na dëgjojnë qytetarët padyshim. Edhe më kujtohet shumë mirë kur në një moment, në një seancë në orën 22:00 të mbrëmjes, unë jam akuzuar nga deputeti Lushtaku që bashkë me Arbërie Nagavcin kemi ardhur në Kuvend të dehura.

A e din çfarë do të thotë kjo, zoti Lushtaku? Kjo do të thotë që ti po e poshtëron një grua, pra ka qenë shpifje që po e poshtëron një grua, që po e denigron një grua në baza gjinore. Është një cenim i dinjitetit dhe paramendojeni, paramendojeni çfarë efekti ka ajo deklaratë këtu në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës.

E po ashtu, unë krahët e mi, i thashë Arian Tahirit, tha s'e kam ditur - krahët e mi i kam pasur të mavijosur prej Mërgim Lushtakut kur e ka bërë dhunën në këtë Kuvend. Po mua s'më ka thirrur prokuroria, mua nuk më ka thirrur prokuroria. Prandaj, çfarëdo veprimi ne bëjmë këtu në këtë seancë, duhet tepër të kemi kujdes, sepse shumë besoj që i inkurajojmë njerëzit jashtë kësaj salle për të ndërmarrë veprime të tilla. Kur Mërgim Lushtaku e dhunon fizikisht midis Kuvendit një deputete, një ministre ose kushdo tjetër, natyrisht që ia jep të drejtën ai zotëria vetë që të ndërmarrë veprime të tilla. Prandaj le të sillemi, ti me ujin nuk ma jep, zotëri. Ti mua ujin nuk ma jep. Unë ujin e marr me dorën time se për ty s'kam nevojë, për ty nuk kam nevojë se unë ujin e marr me dorën time.

Prandaj, kur ti të mësohesh që të sillesh me një grua, e merr fjalën. Tash ulu në vend, ulu!

Urdhëro, një minutë! Uluni të gjithë të tjerët!

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetare!
Edhe pse po më vjen keq që e keqpërdore, domethënë si Kryetare e Kuvendit, që të flasësh jashtë rendit, sepse e dimë shumë mirë që për të folur duhet që të vini këtu në foltore për të folur, e jo me dhënë komente pas çdo deputeti që flet.

Uroj që kurrë të mos ketë dhunë, ne kemi aksione politike. Edhe ju keni pasur aksione politike edhe ju keni lënduar. Tash, kur të ka aksione politike, dikush edhe lëndohet, me qejf kurrkush s'ka pasur qejf që të lëndohet. Por, ndërlidhem prapë me rastin. Unë ju ftoj të gjithë ata që flasin në foltore që të flasin jashtë Kuvendit, që ne me u ballafaquar me ligjin, qysh ta thashë edhe më parë. Asnjëherë nuk thashë për tu ballafaquar fizikisht, sepse s'kam nevojë të ballafaqohem fizikisht.

KRYETARJA: Ministri Sveçla, e ka fjalën. Diskutimi i fundit është i Qeverisë, sepse Qeveria ka të drejtë për të diskutuar. Po pastaj pas fjalës së ministrit, meqë ministri po flet, e merr deputeti.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit.
Pas një seance të gjatë, më lejoni që të shfrytëzoj rastin edhe unë që t'i shpreh ngushëllime familjes së Arlindës për humbjen e vajzës, motrës e nënës.

Më lejoni që t'ju them që në momentin e parë që e kam marrë lajmin, unë kam kërkuar hetim nga Inspektorati Policor i Kosovës, i cili tashmë lajmi është publik se ka filluar hetimet për veprimet apo mosveprimet e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Por, pyetja tjetër që ka lindur është: çka me institucionet e tjera? Me prokurorinë, me gjykatën, me Qendrën për Punë Sociale, e cila është në varësi të komunës, me mbrojtësen e viktimave, me vetë Inspektoratin Policor të Kosovës, me avokatët e palëve, pastaj si dëshmitarë e Inspektoratin e Ministrisë së Punës, Familjes dhe Vlerave të UÇK-së?

Duke qenë se kjo është një zinxhir ku secila hallkë mban përgjegjësinë e vetë, e duke parë se nuk ka mekanizma të tjerë për të kërkuar përgjegjësinë, unë kam kërkuar nga Parlamenti që të bëjë komision hetimor parlamentar, në mënyrë që të gjitha institucionet që i përmenda të vijnë para jush në komision edhe të japin llogaridhënie për veprimet apo mosveprimet e tyre. Tash, çështja është shumë e ndjeshme. Lajmet po bëhen publike herë zyrtarisht e herë jo zyrtarisht, por lirisht mund të themi se informatat janë jo të mira për sa i takon lëshimeve, sidomos në disa hallka të këtij zinxhiri.

Por, dua të konstatoj më së pari se çfarë ka ndodhur apo me çfarë është privuar e ndjera. Domethënë, ajo është privuar nga jeta pa frikë duke qenë se në vazhdimësi ka qenë e kërcënuar, është privuar nga fëmija e saj. E kjo është jashtëzakonisht e çuditshme se si një institucion ka marrë vendim që ta ndajë fëmijën nga nëna e t'ia japë babait, i cili pastaj këtë përgjegjësi ia delegon vëllait të tij, i cili paraprakisht ka një dosje të rëndë në Policinë e Kosovës, kurse ligji thotë që pothuajse automatikisht besimi për fëmijën i takon nënës.

Ajo është privuar nga prona. Sipas informatave që kemi, prona është e çiftit, ka qenë e çiftit, do të thotë ka qenë e bashkëshortit dhe bashkëshortes. Si dikush ka vendosur që ajo të privohet nga prona, është e çuditshme po ashtu. Në vend se dhunuesi e kërcënuesi të arrestohet, kurse e

kërcënuara të jetë e sigurt në pronën e saj me fëmijën e saj, ka ndodhur e kundërta, dhe patjetër që privimi më i rëndë është ai nga jeta. Ne si Ministri dhe Polici jemi të angazhuar maksimalisht që krimineli, vrasësi të arrestohet sa më shpejt. Prandaj, edhe me kërkesën time ky rast është ngritur në nivelet më të larta të policisë, e po ashtu kam kërkuar që edhe Prokuroria Speciale të merret me këtë rast, jo prokuroria rajonale, për shkak se të gjitha këto vendime të çuditshme të Qendrës për Punë Sociale, të prokurorisë e të gjykatës mund të jenë edhe si rrjedhojë e ndikimeve të ndryshme dhe duke dashur me parandaluar çfarëdo lloj ndikimi, unë kam kërkuar që Prokuroria Speciale ta marrë në kompetencë të saj qoftë arrestimin e vrasësit dhe pastaj edhe hetimin e gjithë rastit.

Unë dua të përfundoj me një zotim se Ministria që drejtoj dhe të gjitha institucionet e saj do t'i përgjigjen në plotëni komisionit, të cilin ky Parlament do ta formojë dhe po ashtu do të ndërmarrë masat e nevojshme e të domosdoshme, edhe shumë rigoroze, për të gjithë ata të cilët në kuadër të institucionit që unë drejtoj kanë vepruar gabim apo ka munguar veprimi i duhur. Edhe për fund, si qytetar i kësaj republike, unë jam thellësisht i bindur që persekutimi edhe vrasja e gruas nuk ndalet pa një sfidim serioz të gjithë shoqërisë, të mentalitetit tonë. Faleminderit.

KRYETARJA: Atëherë, situatën e kemi kësisoj që shefat e grupeve parlamentare në vazhdimësi po më kërkojnë që ta ndërpres diskutimin e deputetëve dhe të vazhdojmë me rezolutën. Pra, është lutje e vazhdueshme. Kërkoj menjëherë nga shefat e grupeve vetëm një minutë koordinim, sepse unë kam të tjerë të paraqitur këtu për fjalë. Pra, pa koordinim me shefat e grupeve nuk mund ta kaloj fjalën te deputetët.

Ftoj shefat e grupeve një minutë, ju lutem.

Atëherë, koordinimi me grupet parlamentare është: Egzon Azemi, Eman Rrahmani. Egzon, urdhëroni, pastaj Eman Rrahmani.

EGZON AZEMI: Faleminderit.
Edhe një herë ngushëllime së pari familjes dhe gjithë të afërmve për rastin e rëndë tragjik që ndodhi në Pejë, por sinqerisht çfarëdo deklarate ngushëlluese apo çfarëdo fjalie e tillë sot është e kotë nëse nuk e rikujtojmë edhe një herë numrin total të viktimave të këtij fenomeni kaq të përhapur e kaq negativ në shoqërinë tonë.

Por, po dua direkt të ndërlidhem në një fenomen të cilin nuk e tha asnjë nga ne. Përkundrazi, nisi nga subjektet opozitare në mënyrë të paskrupullt thuajse ky na qenka rasti i parë apo thuajse këto raste paskan ndodhur vetëm në qeverinë aktuale dhe nuk paska ndodhur asnjëherë më herët, dhe gjithë faji u kërkua tek dy ministra të kësaj qeverie. Ja, po jepkan dorëheqje dy ministra të kësaj qeverie dhe po u zgjidhka ky problem. Ju të gjithë këtu që jeni e dini që nuk zgjidhet ky problem

në këtë mënyrë. Por, ekziston një problematikë tjetër të cilën e përmendi edhe zoti Zemaj, e që tha që e dimë të gjithë në Pejë që në rajonin tonë atje ka policë apo zyrtarë shtetërorë që e kryejnë kontrabandën.

Është pikërisht ky fenomen që e dimë të gjithë dhe nuk po e flasim si duhet e kur duhet, dhe nuk po e zgjidhim të gjithë bashkë, sepse nëse diçka mund të zgjidhim bashkë, është pikërisht ky fenomen. Nëse ka zyrtarë shtetërorë, policë në këtë rast, prokurorë e gjykatës që e dimë që ka të gjithë, dhe të gjithë duhet të flasim sot për këtë pikë, duhet të jemi dakord që të flasim për këta emra e mbiemra, që nuk duhet të ketë më emër e mbiemër që i frikëson gjyqtarët, prokurorët ose policët, ose që e shfrytëzon autoritetin apo respektin që e ka fituar në të kaluarën në emër të një sakrifice që tashmë të bëhen krime në emër të tyre.

Mirë që zoti Haradinaj qenka distancuar më në fund, por zoti Daut Haradinaj, edhe zoti Ramush Haradinaj duhet të kërkojnë edhe dorëzimin e personit i cili e kreu këtë vrasje, sepse nëse ju keni guxim që të kërkoni dorëheqjen e një ministri dhe nuk keni fare një pikë ndjesie të thoni të paktën të dorëzohet ai person me të cilin keni jo një, por dhjetëra fotografi dhe video, nuk ju bën kjo gjithsesi fajtorë. Nuk po them se ju bën kjo gjithsesi fajtorë. Ki durim që të dëgjosh. Krejt çfarë po them është që nëse keni këtë guxim që të akuzoni në mënyrë kaq të ulët, duhet të kishit së paku një trohë ndërgjegjeje që të kërkoni dorëzimin e atij krimineli që e bëri një akt të tillë. Pra, kjo është çka po kërkojmë.

E jo të tentoni çdo rast të tillë ta ktheni në kauzë politike për ta rrëzuar Qeverinë. Pushteti fitohet me vota, as me bomba, as me kërcënime, as me prokurorë e policë që i shantazhoni, i frikësoni ose i mbani nën kontroll. Kaq!

KRYETARJA: Besnik Tahiri, replikë!

BESNIK TAHIRI: Diskutimi i tanishëm prej deputetit të Vetëvendosjes e zbardhi një të vërtetë të këtij debati, e i cili është drejtpërdrejt i lidhur me ikjen e përgjegjësisë që e ka Qeveria, që e kanë institucionet e rendit dhe të ligjit. Duhet të të vijë turp, Egzon, që ndërlidhesh me një fotografi, e përgjatë gjithë ditës e ke distancimin e Daut Haradinajt, Ramush Haradinajt, edhe të Aleancës, e ke diskutimin tonë, edhe mundohesh që ta bartësh fajin, ta adresosh gishtin në një ngjarje tragjike, barbare, të cilën e ka dënuar edhe Aleanca, edhe vetë personat në fjalë. Ai njeri që shikon të fshihet pas emrit e mbiemrit "Haradinaj", ai njeri ka synime me ... të veta, kushdo që është ai. Kjo ka qenë deklarata e tyre, e sot të dalësh në Kuvend pa fije marre, pa fije turpi në fund, me bartë fajin e me u munduar me drejtuar gishtin, ... një argument nuk është gjë tjetër veç turp, shpërfillje e një dhimbjeje të madhe që e ka sot shoqëria e Kosovës, shpërfillje e një dhimbjeje të madhe që e ka secili njeri i cili u ballafaqua me situatën që ka ndodhur sot. Turp prej teje edhe turp prej atyre që të kanë dhënë urdhër që ta sjellësh në këtë masë, në këtë situatë këtë debat.

KRYETARJA: Kundër-replikë një minutë, Egzon Azemi.

EGZON AZEMI: Zoti Tahiri, në asnjë moment nuk aludova me fajin. Kërkova distancim dhe kërkova që edhe zotërinjtë që i përmenda në fjalë të kërkojnë dorëzimin e kriminelit që e ka ndërmarrë një akt të tillë. Pasi që nuk është një fotografi, por dhjetëra fotografi e video në të cilat shihen zyrtarët tuaj.

Prapë thashë, jo, këto fakte nuk ju bëjnë fajtorë juve, këto fakte as zotin Haradinaj, as ty, asnjë por, pikërisht ju çoheni dhe e kërkoni edhe dorëheqjen e zyrtarëve, dorëheqjen e ministrave për një fatkeqësi të tillë që e dini që mund të ndodhë dhe ndodh pikërisht, sepse kemi në sistemin tonë të drejtësisë njerëz që frikësohen nga mbiemrat e caktuar. Ju e dini dhe e di gjithë Kosova që ky është një realitet.

KRYETARJA: Eman Rrahmani, fjalën.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit!
Fillimisht, po mendoj që është mirë që të respektohet Rregullorja dhe deputetit t'i jepet fjala kur e kërkon, edhe besoj që ende zyrtarisht, sepse praktikisht veç jemi drejt një autoritarizmi të plotë të këtij pushteti.

Madje, duke u munduar edhe fjalën e deputetit për ta mohuar, mirëpo kjo është shumë më pak e rëndësishme sesa tema për të cilën po diskutojmë sot. Kunati e pret me sëpatë gruan e vëllait. Djali e pret me sëpatë nënën. Babai e vret fëmijën me revole. Djali e mbyt babanë me revole. Burri e vret gruan me revole. Këta janë kriminelë. Përgjegjës për parandalimin e akteve kriminale, vrasjeve, janë institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë. Ata duhet të marrin veprimet ndaj secilit që e cenon sigurinë e secilit në këtë vend e në këtë shtet. Nuk ka krim më të madh se sa që mund të bëjë dikush që e vret një nënë. Krim i njëjtë është secili që mendon të përfitojë në kurriz të nënave, edhe të secilës vrasje në këtë vend.

KRYETARJA: Përfundon diskutimi. Zonja Nagavci, urdhëroni, ju lutem, që ta lexoni draftin e Rezolutës së Kuvendit para deputetëve të Kuvendit.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Atëherë, Propozim-rezoluta e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje me propozimet edhe nga deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së është, si në vijim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65, pika 1 dhe 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 pika 1.5 dhe nenit 53 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare, e mbajtur më 26. 10. 2026, miratoi këtë:

R e z o l u t ë

Vrasja e 49-vjeçares Arlinda Zekaj, më 25 tetor 2026, në Vitomiricë të Pejës, dhe raportimet se ajo kishte kërkuar paraprakisht mbrojtje nga institucionet, kërkojnë reagim të menjëhershëm parlamentar. Seanca e jashtëzakonshme dhe rezoluta synojnë të dënojnë pa ekuivok vrasjet e grave dhe dhunën në familje, të adresojnë me radhë përgjegjësitë e të gjitha institucioneve që burojnë nga Kuvendi dhe të shqyrtojnë zbatimin e legjislacionit parandalues dhe ndëshkues të miratuar prej tij.

Rasti i Arlinda Zekajt pason vrasje të tjera të grave gjatë vitit 2026. Më 23 gusht në Kërvasari të Malishevës u vra një grua 25-vjeçare, shtatzënë në javën e 34-t, për vrasjen e së cilës dyshohej bashkëshorti i saj. Më 26 gusht, në Prizren, një grua 80-vjeçare humbi jetën nga dhuna që dyshohet se ishte ushtruar nga bashkëshorti. Këto raste dëshmojnë se dhuna po kërcënon gratë në mosha dhe rrethana të ndryshme të jetës së tyre.

Vetëm pak javë përpara vrasjes së Arlindës, më 9 tetor 2026, në Livoç të Gjilanit u vranë një grua 27-vjeçare dhe vëllai i saj 31-vjeçar, ndërsa një familjar tjetër mbeti i plagosur rëndë. Sipas njoftimit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, për këtë krim dyshohet bashkëshorti i gruas së vrarë. Kjo ngjarje e rëndë e bën edhe më urgjente nevojën për të shqyrtuar funksionimin e mekanizmave të parandalimit dhe mbrojtjes.

Nëpërmjet kësaj rezolute Kuvendi dënon pa ekuivok dorasit, nxitësit dhe të gjithë ata që tolerojnë, frymëzojnë, përkrahin apo relativizojnë dhunën ndaj fëmijëve, grave dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Dhuna nuk mund të pranohet si formë disiplinimi apo si mjet për të imponuar bindjen dhe nënshtrimin. As autoriteti prindëror apo bashkëshortor, as zakonet dhe as pretendimet për mbrojtjen e nderit, pasurisë, trashëgimisë nuk mund ta përligjin cenimin e jetës, dinjitetit dhe integritetit të njeriut.

Vrasësit e grave dalin nga një kulturë që ka hedhur rrënjë mes nesh, nga bindja se gruaja duhet të nënshtrohet, se jeta dhe vendimet e saj mund të kontrollohen nga të tjerët dhe se kundërshtimi i këtij kontrolli meriton ndëshkim. Kjo kulturë ushqehet kur kërcënimi shpërfillet, dhuna arsyetohet, viktima fajësohet dhe denoncimi paraqitet si turp apo si cenim i familjes. Familja mbrohet duke garantuar sigurinë dhe të drejtat e secilit anëtar të saj.

Kuvendi ka miratuar ligjet që përcaktojnë detyrimet për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave, hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e kryerësve. Përgjegjësia e tij vijon me mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve dhe kërkimin e llogaridhënies, brenda kompetencave kushtetuese dhe ligjore. Kjo seancë duhet të shqyrtojë gjithë zinxhirin e përgjegjësisë institucionale në rastin e Arlinda Zekajt dhe mangësitë që mund të rrezikojnë jetën e grave të tjera. Shqyrtimi duhet të përfshijë pranimin dhe trajtimin e denoncimeve, vlerësimin e rrezikut,

kërkimin, caktimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse, ofrimin e shërbimeve sociale, hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe ekzekutimin e vendimeve. Për secilën hallkë duhet të sqarohet cili institucion ka pasur detyrimin të veprojë, çfarë ka ndërmarrë, nëse ka respektuar afatet ligjore dhe si është siguruar vazhdimësia e mbrojtjes së viktimës.

Përgjegjësia për mbrojtjen nuk mund t'i bartet gruas që denoncon dhunën. Çdo shkelje apo neglizhencë e konstatuar duhet të pasohet nga përgjegjësia përkatëse ligjore dhe disiplinore.

Kjo rezolutë synon që shqyrtimi parlamentar, duke respektuar ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e drejtësisë, të prodhojë masa konkrete, institucione përgjegjëse, afate zbatimi dhe raportim të rregullt para Kuvendit. Qëllimi është që ligjet e miratuara të sigurojnë mbrojtje reale, kryerësit të përballen me drejtësinë dhe secili institucion të japë llogari për përmbushjen e detyrimeve të veta.

Krahas kërkesës për zbatimin me besnikëri të plotë të të gjithë kuadrit ligjor dhe për përmbushjen e detyrimeve të secilit institucion përgjegjës, propozohen këto veprime dhe masa:

1. Themelimi i komisionit hetimor parlamentar. Kuvendi i Republikës së Kosovës të themelojë një komision hetimor parlamentar për zbardhjen e përgjegjësive institucionale, veprimeve dhe mosveprimeve që i paraprinë vrasjes së Arlinda Zekajt. Hetimi parlamentar të përfshijë gjithë zinxhirin institucional përgjegjës për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje, dhunës ndaj fëmijëve dhe grave, mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së tyre, si dhe hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e kryerësve. Komisioni të shqyrtojë trajtimin e denoncimeve, kërkesave për ndihmë dhe paralajmërimeve për rrezikun ndaj jetës së viktimës; vlerësimin e këtij rreziku; masat e kërkuara, të shqiptuara dhe të zbatuara; si dhe shkëmbimin e informacionit dhe bashkërendimin ndërinstitucional.
2. Themelimi i linjës këshilluese për çiftet dhe familjet. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë themelimin e linjës këshilluese falas që e mbulon gjithë vendin për çiftet dhe familjet që përballen me vështirësi ekonomike, sociale dhe psikologjike. Linja të ofrojë këshillim profesional, identifikim të hershëm të rrezikut dhe referim te shërbimet përkatëse, duke garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë e personave që kërkojnë ndihmë.
3. Sigurimi i shërbimeve të specializuara për parandalimin e sjelljes së dhunshme dhe përsëritjes së saj. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë sigurimin dhe zgjerimin e shërbimeve të këshillimit psikologjik dhe trajtimit psiko-social për djemtë dhe burrat që kanë histori të dhunës në familje, me synim marrjen e përgjegjësisë për sjelljen e tyre, ndryshimin e saj dhe parandalimin e përsëritjes së dhunës. Të ofrohen gjithashtu programe të posaçme të mbështetjes psikologjike për djemtë dhe burrat që janë rritur në familje ku kanë përjetuar ose dëshmuar dhunë, për trajtimin e pasojave të këtyre

përvojave dhe ndërtimin e marrëdhënieve pa dhunë. Shërbimet të përshtaten sipas moshës dhe nevojave individuale, duke garantuar sigurinë e viktimave dhe zbatimin e detyrimeve ligjore ndaj kryerësve të dhunës.

4. Këshillimi psikologjik dhe edukimi për parandalimin e dhunës në adoleshencën e hershme. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë organizimin e seancave të rregullta të këshillimit psikologjik dhe edukimit për djemtë në shkollat e mesme të ulëta, me synim njohjen dhe menaxhimin e emocioneve, zgjidhjen e konflikteve pa dhunë, respektimin e integritetit dhe kufijve personalë, barazinë gjinore dhe kundërshtimin e sjelljeve kontrolluese e të dhunshme. Seancat të zhvillohen nga psikologë dhe profesionistë të kualifikuar, me përmbajtje të përshtatur sipas moshës, duke siguruar edhe mundësi për këshillim individual konfidencial dhe referim për mbështetje të mëtejshme sipas nevojës.
5. Themelimi i qendrave shtetërore për strehim dhe mbrojtje. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë themelimin e një qendre shtetërore për strehimin dhe mbrojtjen e grave viktima të dhunës, si dhe të një qendre të veçantë për fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo rrethanave të rënda familjare. Qendrat të sigurojnë strehim të sigurt, përkujdesje profesionale, mbështetje psikologjike, shëndetësore dhe juridike, si dhe përkrahje për riintegrim. Organizimi i shërbimeve të respektojë interesin më të mirë të fëmijës dhe ruajtjen e lidhjes me prindin që nuk ushtron dhunë, kur kjo është në interesin e fëmijës.
6. Rishikimi i legjislacionit dhe transformimi i Qendrave për Punë Sociale. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë nisjen e një rishikimi të thelluar të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Qendrave për Punë Sociale në nivel komunal, me synim transformimin tërësor të tyre. Rishikimi të qartësojë përgjegjësitë komunale dhe qendrore, të garantojë personel të kualifikuar dhe financim të qëndrueshëm, si dhe të përcaktojë standarde të detyrueshme për ndërhyrjen, mbikëqyrjen profesionale dhe llogaridhënien.
7. Garantimi i zbatimit efektiv të ndihmës juridike falas për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë forcimin e kapaciteteve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe sigurimin e këshillimit e përfaqësimit juridik në kohë për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të sigurohen profesionistë të specializuar, referim i menjëhershëm ndërinstitucional dhe informim i qartë për këtë të drejtë, si dhe raportim para Kuvendit për zbatimin dhe pengesat në realizimin e saj.
8. Programi kombëtar edukues për parandalimin e dhunës në shkolla. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë hartimin dhe zbatimin e një programi kombëtar edukues në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar për parandalimin e dhunës, me theks të veçantë te dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore.

9. Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë ndërmarrjen e nismave ligjore për:

Ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-022 për armë, për revokimin e përhershëm të lejeve dhe ndalimin e pajisjes me leje për armë të personave të dënuar për dhunë në familje, dhunë ndaj grave dhe dhunë me bazë gjinore;
Ndryshimin e Ligjit nr. 08/L-185 për zgjerimin dhe saktësimin e përkufizimit të dhunës ekonomike;
Ndryshimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për përcaktimin e femicidit si vepër të veçantë penale;
Ndryshimin e Kodit Penal për përcaktimin dhe sanksionimin e veçantë të formave të dhunës në hapësirën digjitale.
10. Parandalimi dhe luftimi i dezinformimit me bazë gjinore. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë që përmes Agjencisë për Barazi Gjinore të hartojë masa konkrete për identifikimin, parandalimin dhe luftimin e dezinformimit me bazë gjinore, veçanërisht ndaj grave dhe vajzave të angazhuara në jetën publike.
11. Themelimi i një njësie të specializuar për dhunën digjitale. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë krijimin e një njësie të specializuar në kuadër të Policisë së Kosovës për hetimin dhe trajtimin e dhunës në hapësirën digjitale ndaj grave dhe vajzave.
12. Themelimi i qendrave referuese për viktimat e dhunës seksuale. Kuvendi i Republikës së Kosovës i rekomandon Qeverisë themelimin e qendrave të specializuara për viktimat e dhunës seksuale, në përputhje me nenin 25 të Konventës së Stambollit, për ekzaminime mjekësore dhe mjekoligjore, trajtim të traumës, këshillim dhe mbështetje profesionale.
13. Të ngarkojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme që nëpërmjet strukturave kompetente të Policisë të organizojë brenda 72 orëve rishikimin urgjent të rasteve aktive me rrezik të lartë. Për secilin rast të dokumentohen masat e sigurisë, zyrtari përgjegjës për ndjekjen e tyre dhe bashkërendimi me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale, përfshirë zbatimin policor të urdhrave mbrojtës dhe reagimin ndaj alarmeve të mbikëqyrjes elektronike.
14. Gjithashtu, brenda 72 orëve të ardhshme të ndahen të gjitha statistikat lidhur me rastet e dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore nga sistemi i drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë, ashtu që brenda një kohe të shkurtër të dalim me një udhëzues të përbashkët të trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me baza gjinore, nga lajmërimi i parë e deri te strehimi dhe mbrojtja. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci! Ju lutem që t'i zini vendet tuaja. Fillimisht votojmë për prezencë. Regjia, ju lutem na mundësoni votimin për prezencë.

Votojmë tash! 65 deputetë janë në sallë.

Të vish të flasësh, të hedhësh akuza e të mos qëndrosh në sallë për të votuar, kjo për mua s’e ka asnjë kuptim, por megjithatë secili deputet le ta ketë përgjegjësinë e vet.

Vazhdojmë me votimin e rezolutës që u lexua nga shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Përgatitemi për votim! Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi rezolutën në fjalë.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme. Shihemi, të enjten, në orën 10:00.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë